



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit / Kancelarija Premijera / Office of the Prime Minister
Zyra për Qeverisje të Mirë / Kancelarja za Dobro Upravljanje / Office of Good Governance

STRATEGJIA PËR PËRFSHIRJEN E
KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI NË
SHOQËRINË KOSOVARE
2017-2021

Prishtinë, prill 2017

Përmbajtja

FALËNDERIME	3
LISTA E SHKURTESAVE	4
PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	5
1. HYRJE	9
2. METODOLOGJIA	11
3. SFONDI	13
3.1. LEGJISLACIONI.....	14
3.2. POLITIKAT	15
3.3. MEKANIZMAT PËR MBROJTJEN E KOMUNITETEVE NË KOSOVË	15
3.4. ARSIMI	16
3.5. PUNËSIMI DHE MIRËQENIA SOCIALE	19
3.5.1. <i>Punësimi</i>	19
3.5.2. <i>Mirëqenia sociale</i>	20
3.6. SHËNDETËSIA.....	24
3.7. BANIMI.....	27
3.8. ÇËSHTJE TË NDËRLIDHURA	28
3.8.1. <i>Barazia gjinore</i>	28
3.8.2. <i>Siguria</i>	29
3.8.3. <i>Regjistrimi</i>	29
4. VIZIONI, MISIONI DHE PARIMET E STRATEGJISË	31
5. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË	32
5.1. ALTERNATIVAT E KONSIDERUARA	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
5.2. ARSIMI	37
5.3. PUNËSIMI DHE MIRËQENIA SOCIALE.....	43
5.4. SHËNDETËSIA.....	50
5.5. BANIMI	55
6. ZBATIMI I STRATEGJISË	60
6.1. MEKANIZMAT PËR ZBATIM	60
6.2. MONITORIMI DHE VLERËSIMI.....	61
7. BUXHETI	63
SHTOJCË: KORNIZA PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS	65

Falënderime

Hartimi i kësaj Strategjie është përpjekje e përbashkët e Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës/Zyrës për Qeverisje të Mirë, dhe të gjitha Ministrive përkatëse në Qeverinë e Republikës së Kosovës, përfaqësuesve të komuniteteve në Kuvendin e Republikës së Kosovës, përfaqësuesve të institucioneve komunale, përfaqësuesve të shoqërisë civile që punojnë me komunitetet në Kosovë.

Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit dëshiron të shpreh mirënjohje për projektin e financuar nga Bashkimi Evropian “Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim - KEEN” që zbatohet nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) dhe i cili ka mbështetur hartimin e këtij dokumenti; me kontributin përmbajtësor të organizatave të shoqërisë civile anëtarë të rrjetit “Platforma” që punojnë me komunitetet në Kosovë; anëtarëve të grupeve punuese, zyrtarëve përgjegjës nga ministrinë përkatëse, si dhe shumë palëve të tjera që i kushtuan kohë dhe energji zhvillimit të kësaj strategjie.

Qeveria e Republikës së Kosovës ju është shumë falënderuese për mbështetjen e madhe dhe të vazhdueshme të gjithë partnerëve zhvillimor ndërkombëtar, për mbështetjen e përfaqësuesve të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Këshillit të Evropës, OSBE-së, UNICEF-it, Ambasadës Norvegjeze, Ambasadës Zvicerane, Këshillit Britanik, Organizatave Humanitare Terre des Hommes dhe Eörd Vision.

Lista e shkurtesave

AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
AGTSH	Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë
AR	Akute Respiratore
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
EVSB	Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi
IAL	Institucionet e Arsimit të Lartë
IAR	Infeksione Akute Respiratore
KDN	Komiteti Drejtues Ndërministror
KKSB	Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
KKV	Komitetet Komunale Vepruese
KLSP	Komiteti Lokal për Siguri Publike
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MATP	Masat Aktive të Tregut të Punës
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPB/DRPR	MPB/Departamenti për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
ORT	Trajtim rehidratues përmes gojës
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
PK	Policia e Kosovës
QPS	Qendra për Punë Sociale
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit në Kosovë
SPV	Strategjia dhe Plani i Veprimit
SHFMU	Shkolla Filllore dhe e Mesme e Ulët
SHML	Shkolla e Mesme e Lartë
UA	Udhëzim Administrativ
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
UNICEF	Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
ZÇK	Zyra për Çështjet e Komuniteteve
ZKKK	Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZQM	Zyra për Qeverisje të Mirë

Përmbledhja ekzekutive

Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali paraqet një vazhdimësi të politikave të Qeverisë së Republikës së Kosovës për forcimin e karakterit multi-etnik dhe multi-kulturor të shoqërisë kosovare. Gjatë hartimit të këtij dokumenti janë marrë parasysh mësimet e nxjerra nga zbatimi i Strategjisë dhe planit të veprimit për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian 2009-2015^{1,2}, si dhe Korniza e BE-së për strategjitë kombëtare për integrimin e romëve deri në vitin 2020³. Në bazë të kornizës janë definuar katër fusha të veprimit të cilat duhet të adresohen nga strategjitë kombëtare: arsimi, punësimi dhe mirëqenia sociale, shëndetësia dhe banimi. Në vijim po japim një përmbledhje të shkurtër të sfidave sipas këtyre fushave:

Arsimi: Me gjithë progresin në rritjen e pjesëmarrjes në arsim të komuniteteve rom dhe ashkali dallimi me mesataren e Kosovës vazhdon të jetë domethënës. Po ashtu, fëmijët e komuniteteve rom dhe ashkali tregojnë performancë më të dobët në shkollë sesa mesatarja dhe një ndër shkaktarët kryesorë për këtë shihet pjesëmarrja e ulët në edukimin parashkollor. Një shkallë e lartë e ndërgjegjësimit për rëndësinë e shkollimit vërehet edhe tek pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali, por shpesh mungon ndërgjegjësimi i shumicës për rëndësinë shoqërore të shkollimit të grupeve të marginalizuara.

Punësimi dhe mirëqenia sociale: Gjendja e punësimit të komuniteteve rom dhe ashkali është më e vështirë në krahasim me komunitetet tjera, ndërsa vendet e punës në të cilat janë të angazhuar janë shpesh të përkohshme, të shumtën fizike, që nuk kërkojnë shkathtësi të larta dhe nuk paguhen mirë. Kur kësaj i shtohet përfshirja e ulët e komuniteteve në skemat e mirëqenies sociale dhe shfrytëzimi i pamjaftueshëm i shërbimeve sociale del se zbutja e varfërisë në mesin e këtyre komuniteteve paraqitet si sfidë shumë serioze.

Shëndetësia: Me një qasje të kufizuar në shërbimet parandaluese dhe kurative shëndetësore, komunitetet rom dhe ashkali vazhdojnë të vuajnë nga shëndeti i dobët. Ndër pengesat kryesore për qasje në shërbime shëndetësore janë: varfëria dhe pamundësinë për pagesën e trajtimit dhe blerjes së barnave, transporti, si dhe mungesa e dokumenteve të identifikimit. Komunitetet rom dhe ashkali vuajnë nga një prevalencë e lartë e të ushqyerit joadekuat dhe të pamjaftueshëm, gjë që kontribuon në shëndetin e dobët dhe jetëgjatësinë e shkurtër. Niveli i sëmundshmërisë është brengosës, veçanërisht prezenca e sëmundjeve kronike jo të transmetuesë, si të diabetit, hipertensionit, sëmundjeve kardiovaskulare dhe çrregullimeve të skeletit.

Banimi: Një sfidë e madhe për zgjidhjen e problemit të banimit është evidentimi i nevojave të familjeve të komuniteteve rom dhe ashkali, numri i të cilave llogaritet në rreth 6000. Ideja është që ky problem të adresohet në kuadër të procesit të vënies në funksion të bazës së të dhënave për nevojat e banimit nga MMPH. Po ashtu, duhet siguruar një shkallë më të lartë të përfshirjes së vet pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në zgjidhjen e problemit të banimit, duke filluar nga artikulli i nevojave për banim, e deri tek rregullimi i dokumentacionit pronësor. Nevoja për

¹ Strategjia për Integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptianë në Republikën e Kosovës 2009-2015, dhjetor 2008.

http://ëëë.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_per_integrimin_e_komuniteteve_RAE_2009-2015_shq.pdf

² Plan i Veprimit për zbatimin e Strategjisë së Republikës së Kosovës për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, 2009-2015. http://ëëë.kryeministri-ks.net/repository/docs/Plani_i_Veprimit_per_zbatimin_e_Strategjise_per_integrimin_e_Komunitetit_RAE_2009-2015.pdf

³ Korniza e BE-së për Strategjitë Kombëtare për Integrimin e Romëve deri në vitin 2020, Bruksel, 05.04.2011, COM(2011) 173. http://ec.europa.eu/justice/policies/discrimination/docs/com_2011_173_en.pdf

sigurimin e banimit vazhdon të jetë shumë më e madhe sesa mundësitë buxhetore, prandaj është e domosdoshme të përcaktohen prioritete me rastin e ofrimit të ndihmës.

Për secilën nga katër fushat e strategjisë është definuar një objektiv strategjik. Secili objektiv strategjik është zbërthyer në rezultate, ndërsa rezultatet në aktivitete. Tabela e mëposhtme jep një pasqyrë të objektivave strategjikë dhe rezultateve të ndërlidhura sipas katër fushave.

Fusha	Objektivi strategjik	Aktivitetet	Rezultatet e pritshme
Arsimi	1. Rritja e përfshirjes dhe ofrimi i mundësive për zhvillim, aftësim dhe arsimim cilësor për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali	<ul style="list-style-type: none"> • Stimulimi i vijimit të edukimit parashkollor. • Hartimi i planeve të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe të mosregjistrimit në të gjitha komunat. • Masa stimuluese për lehtësimin e regjistrimit dhe vijimit të fëmijëve rom dhe ashkali në arsimin e mesëm të lartë. • Hartimi i planeve individuale për nxënësit e ri-atdhesuar rom dhe ashkali. • Zhvillimi i masave të veçanta pozitive dhe i programeve përgatitore për regjistrimin dhe mbajtjen e studentëve në IAL nga radhët e komuniteteve rom dhe ashkali. • Mbështetja e programeve për arsimimin e të rriturve. • Përcaktimi i treguesve të ndjeshëm gjinor për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali për SMIA. • Eliminimi i segregacionit dhe diskriminimit ndaj fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali. • Mbështetja e qendrave mësimore me bazë në komunitet. • Ofrimi i mësimin plotësues për nxënësit që ngecin në mësim. • Promovimi i mësimin të gjuhës rome. • Zhvillimi i programeve për vetëdijësimin e prindërve lidhur me fëmijërinë e hershme. • Organizimi i aktiviteteve për vetëdijësimin e komuniteteve rom dhe ashkali për rëndësinë e regjistrimit me kohë dhe vijimin e shkollimit, me fokus të veçantë tek vajzat. • Vetëdijësimi i popullatës për arsimimin e komuniteteve rom dhe ashkali. 	<ul style="list-style-type: none"> • Përmirësohet pjesëmarrja në arsim e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali. • Përmirësohet performanca e nxënësve dhe studentëve të komuniteteve rom dhe ashkali. • Ndërgjegjësohen palët e interesit për të ndihmuar arsimimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali.
Punësimi dhe mirëqenia sociale	2. Përmirësimi i situatës ekonomike dhe sociale të komuniteteve rom dhe ashkali	<ul style="list-style-type: none"> • Hulumtimi, përcaktimi i treguesve të ndjeshëm gjinor dhe raportimi mbi gjendjen e tregut të punës të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali dhe mbi përfitimin e tyre nga shërbimet/masat e ofruara nga MPMS. • Përmirësimi i përfaqësimit të komuniteteve rom dhe ashkali në punësimin në institucione publike dhe ndërmarrje publike. • Hulumtimi dhe zbatimi i masave të aksionit afirmativ për punësimin e komuniteteve rom dhe ashkali. • Vlerësimi i nevojave dhe i efektivitetit të shërbimeve të punësimin dhe MATP. • Dizajnimi/modifikimi i shërbimeve (shtesë) të punësimin dhe MATP, përfshirë trajnimet profesionale, në përputhje me nevojat komuniteteve rom dhe ashkali. • Organizimi i fushatave të informimit për shërbimet e punësimin dhe MATP, përfshirë 	<ul style="list-style-type: none"> • Përmirësohet niveli i punësimin të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali. • Përmirësohet pjesëmarrja e familjeve të komuniteteve rom dhe ashkali në skemat e mbrojtjes dhe në shërbime sociale.

		<p>trajnimet profesionale.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Promovimi i rasteve të suksesit në tregun e punës të pjesëtarëve të komuniteteve rom, dhe ashkali. • Vlerësimi i mbështetjes shtesë për përfituesit e ndihmave sociale. • Identifikimi i fëmijëve dhe personave me nevoja të veçanta. • Fushata informative për skemat e mbrojtjes dhe shërbime sociale. • Analiza e cilësisë së shërbimeve sociale dhe identifikimi i shërbimeve të reja sociale. • Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve komunalë për përmirësimin e shërbimeve sociale. 	
Shëndetësia	3. Përmirësimi i gjendjes shëndetësore dhe cilësisë së jetës tek pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali	<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i aktiviteteve për skreningun e kancerit të gjirit. • Realizimi i vizitave shtëpiake për nëna dhe fëmijë si dhe grupe të tjera të ndjeshme. • Aktivitetet që arrijnë popullatën vulnerable. • Masat institucionale që përmirësojnë qasjen në shërbime shëndetësore. • Monitorimi i vazhdueshëm i qasjes në shërbimet e kujdesit shëndetësor. • Fushatat për imunizim. • Shpërndarja e materialit informues për planifikim familjar dhe shëndet riprodhues. • Edukimi për rëndësinë e kushteve higjiene-sanitare. • Avancimi i kapaciteteve preventive të stafit në kujdesin parësor. • Kontrolli periodik i nivelit të plumbit në vendbanimet e komuniteteve. • Pajisja me kontejnerë familjarë për mbeturina. 	<ul style="list-style-type: none"> • Përmirësohet qasja në shërbime shëndetësore për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali. • Përmirësohet sjellja dhe praktikat shëndetësore tek pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali. • Sigurohet një mjedis i shëndetshëm për popullsinë e komuniteteve rom dhe ashkali.
Banimi	4. Sigurimi i banimit adekuat të qëndrueshëm për komunitetet rom dhe ashkali në përputhje me legjisllacionin në fuqi	<ul style="list-style-type: none"> • Përfshirja e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në bazën e të dhënave për financimin e programeve të veçanta të banimit. • Caktimi i prioriteteve për familjet në nevojë për përfshirjen në programin e banimit social. • Organizimi i fushatës së vetëdijesimit për përfshirje në çështjen e banimit. • Mbështetja e komuniteteve rom dhe ashkali për pajisje me dokumentacion përkatës pronësor apo një të drejtë tjetër të tokës në të cilën mund të ndërtohet. • Hartimi i projekteve prioritare për renovim, rindërtim apo ndërtim të shtëpisë në parcelat vetanake. • Implementimi i programeve për trajtimin e vendbanimeve joformale. • Identifikimi i pronave për banim social. • Hartimi i projekteve prioritare për banim social. 	<ul style="list-style-type: none"> • Janë identifikuar nevojat e pjesëtarëve të komuniteteve për banim adekuat dhe banim social. • Është shtuar ndërgjegjësimi i pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali për pjesëmarrje aktive në zgjidhjen e problemeve të banimit. • Avancim i ndjeshëm drejt zgjidhjes së problemit të banimit për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali.

1. Hyrje

Në dhjetorin e vitit 2008, Qeveria e Republikës së Kosovës aprovoi Strategjinë për Integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës 2009-2015⁴, si dhe Planin e Veprimit për zbatimin e saj⁵, duke i identifikuar fushat e rëndësishme të veçantë për integrimin e të tri komuniteteve⁶. Secila nga fushat e identifikuar përmbante masa për arritjen e ndryshimit të kërkuar për arritjen e qëllimeve dhe objektivave specifike. Sidoqoftë, për shkak të burimeve të pamjaftueshme financiare dhe burimeve njerëzore për monitorimin e progresit, koordinimit jo të mirë në mesin e ministrive dhe institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, përfshirë shfrytëzimin e pamjaftueshëm të ekspertizës së organizatave relevante të shoqërisë civile, zbatimi i strategjisë ka pasur ngecje.

Zyra për Qeverisje të Mirë ka bërë raporte vjetore të progresit të zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit. Kështu, raporti i vitit 2013 ofron informacion për arritjen e 280 nga 388 treguesit e Strategjisë, ose 72%⁷. Kjo nuk do të thotë se 280 caqet e përcaktuara me tregues janë arritur, por se ka pasur informacion për arritjet; ndërkaq për 108 caqe (28%) nuk ka pasur fare informacion. Këtij raporti i është bashkëngjitur korniza e prioriteteve për vitet 2014-2015. Ndërkaq, raporti i progresit i vitit 2014 përqendrohet në kornizën e prioriteteve, ku numri i treguesve është reduktuar nga 288 në 228, ndërkohë që është raportuar progresi për 179 prej tyre ose 79% të numrit të përgjithshëm të treguesve⁸. Të dy raportet prezantojnë të dhëna të mangëta për shpenzime buxhetore, por edhe nga këto të dhëna mund të konstatohet që shpenzimi ka qenë dukshëm nën planifikimin që flet për probleme me zbatimin e Strategjisë dhe të Planit të Veprimit. Probleme të zbatimit janë vënë në pah edhe në raportet e njëpasnjëshme të progresit të Bashkimit Evropian⁹, si dhe në raportin e monitorimit të zbatimit të Konventës Kornizë për Pakicat Kombëtare.

Duke e pasur parasysh faktin se Plani i Veprimit përfundonte në fund të vitit 2015, Komiteti Drejtues ndërinstitucional¹⁰ i themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës për të bashkërenditur veprimet për zbatimin e Strategjisë, në vitin 2014 artikuloi nevojën për të pasur një dokument të ri politik për integrimin e dy komuniteteve, në përputhje me Kornizën e BE-së për strategjitë kombëtare për integrimin e romëve deri në vitin 2020¹¹. Korniza e BE-së përcakton katër fusha prioritare për integrimin e komuniteteve rom dhe ashkali:

1. Qasja në arsim: Të sigurohet se të gjithë fëmijët përfundojnë të paktën arsimin e obligueshëm.

⁴ Strategjia për Integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës 2009-2015, dhjetor 2008.

http://ëëë.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_per_integrimin_e_komuniteteve_RAE_2009-2015_shq.pdf

⁵ Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë së Republikës së Kosovës për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, 2009-2015. http://ëëë.kryeministri-ks.net/repository/docs/Plani_i_Veprimit_per_zbatimin_e_Strategjise_per_integrimin_e_Komunitetit_RAE_2009-2015.pdf

⁶ 1. Arsimi, 2. Punësimi dhe fuqizimi ekonomik, 3. Shëndetësia dhe çështjet sociale, 4. Strehimi dhe vendbanimet joformale, 5. Kthimi dhe ri integrimi, 6. Regjistrimi, 7. Kultura, mediat dhe informimi, 8. Pjesëmarrja dhe përfaqësimi, 9. Siguria, shërbimi policor, drejtësia, 10. Kundër-diskriminimi dhe 11. Barazia gjinore.

⁷ Zyra për Qeverisje të Mirë: Raporti i Progresit mbi Zbatimin e Planit të Veprimit dhe Strategjisë së Republikës së Kosovës për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, 2009 – 2015.

⁸ Zyra për Qeverisje të Mirë: Raporti i Vlerësimit Kornizës Se Prioriteteve për periudhën 2014 mbi Zbatimin e Planit të Veprimit dhe Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2014 -2015

⁹ Raporti i Progresit i BE-së 2014, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf (accessed 14-10-2016); Raporti i Progresit i BE-së 2015,

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf (qasur në 16-10-2016).

¹⁰ Komiteti drejtues ndërinstitucional është trup politik me pjesëmarrjen e shoqërisë civile i themeluar për të mbikëqyrë dhe koordinuar aktivitetet për zbatimin e kësaj strategjie.

¹¹ Korniza e BE-së për Strategjitë Kombëtare për Integrimin e Romëve deri në vitin 2020, Bruksel, 05.04.2011, COM(2011) 173. http://ec.europa.eu/justice/policies/discrimination/docs/com_2011_173_en.pdf

2. Qasja në punësim: Zvogëlimi i dallimit në punësim në mes të pjesëtarëve të komuniteteve dhe pjesës tjetër të popullsisë.
3. Qasja në përkujdesje shëndetësore: Zvogëlimi i dallimit në gjendje shëndetësore në mes të pjesëtarëve të komuniteteve dhe pjesës tjetër të popullsisë.
4. Banimi dhe qasja në shërbimet esenciale: Zvogëlimi i dallimit në mes të qasjes së pjesëtarëve të komuniteteve në banim dhe shërbime publike (uji, rryma elektrike, gazi) dhe pjesës tjetër të popullsisë.

Pikërisht këto katër fusha janë përfshirë në dokumentin e ri të Strategjisë, të zhvilluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Këtu duhet theksuar se nuk janë harruar edhe fushat e tjera me rëndësi për të siguruar përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në periudhën 2017-2021, siç janë: regjistrimi civil, kthimi dhe ri-integrimi dhe siguria.

Përkundër arritjeve të deritanishme, komunitetet rom dhe ashkali vazhdojnë të jenë në pozitë të pavolitshme në të gjitha sferat e jetës në Kosovë, e sidomos në katër fushat e përcaktuara më sipër. Pa një planifikim të mirë dhe ndihmë nga jashtë, këto komunitete nuk mund të dalin nga qarku vicioz i varfërisë dhe të integrohen në shoqëri. Nga ana tjetër, institucionet e Kosovës janë të përkushtuara që të sigurojnë pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve në shoqërinë kosovare. Këto janë arsytet e hartimit të këtij dokumenti të Strategjisë.

Përpyqje të konsiderueshme janë bërë për të siguruar që Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021 është në përputhje me politikat, iniciativat dhe strategjitë e tjera përkatëse. Në nivel kombëtar është konsideruar e domosdoshme për të harmonizuar këtë Strategji me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim, e cila është përgatitur nën udhëheqjen e Zyrës së Kryeministrit të Kosovës. Ndërlidhja kryesore e kësaj Strategjie dhe SKZh-së realizohet përmes kapitullit të parë - Zhvillimi i Kapitalit Njerëzor. Një iniciativë tjetër e rëndësishme që është marrë parasysh ishte Programi Kombëtar për adaptimin e ACQUIS-it.

2. Metodologjia

Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) në Zyrën e Kryeministrit, si institucion përgjegjës për udhëheqjen e punës për hartimin e këtij dokumenti strategjik, ka ndjekur një proces gjithëpërfshirës dhe me pjesëmarrje, duke u bazuar në përvojën e hartimit dhe zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian 2009-2015. Po ashtu, ZQM e ka bazuar punën e vet në Udhëzimin Administrativ 02/2012 që përcakton procesin e planifikimit dhe përmbajtjen e dokumentit¹². Me kërkesën e përfaqësuesve politikë të komunitetit egjiptian, ky komunitet nuk përfshihet në strategjinë e re, prandaj kjo strategji vlen për komunitetet rom dhe ashkali.

Sa herë ka qenë e mundur të dhënat për dy komunitetet, rom dhe ashkali, janë prezantuar të ndara. Megjithatë, ka raste kur ato nuk ekzistojnë si të tilla, por mbledhen dhe raportohen si të përmbledhura për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Në raste të tilla është sqaruar se të dhënat kanë të bëjnë me të tri komunitetet.

Katër janë themelet kryesore mbi të cilat mbështetet kjo strategji:

Së pari, në bazë të përvojës së fituar gjatë hartimit dhe zbatimit të Strategjisë së parë, objektivat dhe masat janë formuluar në mënyrë që të ndikohet sa më shumë në përmirësimin e gjendjes së komuniteteve të synuara.

Së dyti, përvoja e akumuluar e të punësuarve në institucionet e sistemit që ballafaqohen çdo ditë me probleme kur bëhet fjalë për përfshirjen e romëve dhe ashkalinjëve. Shkrimi të këtij dokumenti i kanë paraprirë konsultime intensive individuale dhe grupore me përfaqësues të të gjitha institucioneve relevante, ministritë dhe sektori joqeveritar/civil.

Së treti, nuk ka dyshim se në periudhën e kaluar, janë forcuar në mënyrë të konsiderueshme OJQ-të të cilat punojnë me komunitetet. Ndryshe nga viti 2008, sot në Kosovë ka disa organizata joqeveritare që në fokus kanë komunitetet rom dhe ashkali, dhe, të cilat, me përvojën dhe kapacitetin e tyre kanë kontribuar dhe mund të kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme, si në përcaktimin ashtu edhe në zbatimin e qëllimeve dhe masave të parapara.

Së katërti, gjatë hartimit të kësaj Strategjie janë konsultuar edhe dokumente që kanë të bëjnë me romët në vendet e tjera evropiane, në mënyrë që përvojat e këtyre vendeve të përdoren për këtë strategji, për të dhënë rezultatet më të mira të mundshme.

Gjatë hartimit të dokumentit, janë bërë përpjekje të pareshtura për të siguruar përfshirje sa më të gjerë të përfaqësuesve të komuniteteve rom dhe ashkali në procesin e konsultimeve. Përveç përfaqësuesve politikë të dy komuniteteve, në procesin e konsultimeve janë përfshirë organizatat joqeveritare që përfaqësojnë interesin e tyre, si dhe partnerët zhvillimorë që punojnë në avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali. Procesi është drejtuar nga Ekipi Punues¹³ në të cilin janë të përfshira institucionet e Kosovës, organizatat joqeveritare që punojnë me komunitetet rom dhe ashkali dhe organizatat ndërkombëtare në cilësinë e vëzhguesve. Vet procesi ka ngërthyer në vete punëtori për analizën e gjendjes, planifikimin e aktiviteteve dhe përcaktimin e buxhetit, takime

¹² Udhëzimi Administrativ nr. 02/2012 për Procedurat, Kriteret dhe Metodologjinë e Përgatitjes dhe Miratimit të Dokumenteve Strategjike dhe Planeve për Zbatimin e tyre. http://ëëë.kryeministri-ks.net/repository/docs/Draft_Udhezimi_Administrativ_Per_Strategjite_FINAL_2012_2_.pdf

¹³ Vendimin i Qeverisë së Republikës së Kosovës për formimin e Ekipit Punues për hartimin e Strategjisë së re për komunitetet rom dhe ashkali-aneksi 2.

konsultative me palët me interes, si dhe kërkimin e informatës kthyesë, të vërejtjeve dhe sugjerimeve në formë të shkruar.

3. Sfondi

Në tërë Evropën jetojnë rreth 10-12 milion pjesëtarë të komunitetit rom¹⁴. Sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në vitin 2011, në Kosovë jetojnë 1,739,825 banorë, prej të cilëve rom janë 8,824 ose 0.5% dhe ashkali – 15,436 ose 0.9%¹⁵. Në tabelën 1 janë prezantuar të dhënat e regjistrimit sipas komunave ku jetojnë pjesëtarë të komuniteteve rom dhe ashkali¹⁶. Këtu duhet theksuar se regjistrimi i popullsisë nuk është zhvilluar në të gjitha komunat me shumicë serbe, prandaj të dhënat nuk janë të plota.

Romët dhe komunitetet që konsiderohen si pjesë e kësaj shoqërie përballen me një problem të njëjtë në të gjitha vendet e Evropës, e ky është përjashtimi shoqëror. Zakonisht, ky lloj përjashtimi manifestohet në formë të jetës në varfëri, segregacionit, qasjes së vështirësuar në shërbime sociale, diskriminimit, e të ngjashme. Edhe Rajoni i Ballkanit Perëndimor përballlet me situata të ngjashme që, në kushte të ngecjes në zhvillim ekonomik, e bëjnë gjendjen e romëve edhe më të vështirë. Periudha e luftës dhe ajo e pasluftës në Kosovë kanë shkaktuar zhvendosje të një numri të konsiderueshëm të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali brenda territorit të Kosovës dhe drejt vendeve fqinje, ndërsa një pjesë e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve ka emigruar në vendet tjera evropiane. Kjo zhvendosje e popullsisë paraqet sfidë më vete pasi, shpesh, i zhvlerëson përpjekjet për integrim në fushën e arsimit, punësimit dhe përkujdesjes shëndetësore. Disa shtete të Rajonit si Serbia dhe Maqedonia kanë zhvilluar plane për integrimin e romëve para më shumë se një dekade dhe kanë marrë mbështetje domethënëse ndërkombëtare në këtë drejtim, duke shënuar progres të ndjeshëm, sidomos në fushën e arsimit.

Tabela 1. Pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali sipas komunave

Komuna	Rom	Ashkali	Gjithsej
Deçan	33	42	75
Gjakovë	738	613	1,351
Glllogoc	0	0	0
Gjilan	361	15	376
Dragash	3	4	7
Istog	39	111	150
Kaçanik	5	1	6
Klinë	78	85	163
Fushë Kosovë	436	3,230	3,666
Kamenicë	240	0	240
Mitrovicë	528	647	1,175
Lipjan	342	1,812	2,154
Novobërdë	63	3	66
Obiliq	661	578	1,239
Rahovec	84	404	488
Pejë	993	143	1,136
Podujevë	74	680	754
Prishtinë	56	557	613
Prizren	2,899	1,350	4,249

¹⁴ Gjendja e Romëve në 11 shtete anëtare të BE-së – Rezultatet e Anketës, Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, 2012. http://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/2099-FRA-2012-Roma-at-a-glance_EN.pdf

¹⁵ ASKDATA - <http://askdata.rks.gov.net/PXËeb/pxëeb/sq/askdata/?rxid=0b4e087e-8b00-47ba-b7cf-1ea158040712/>

¹⁶Po aty.

Skenderaj	0	10	10
Shtime	23	750	773
Shtërpçë	24	1	25
Suharekë	41	493	534
Ferizaj	204	3,629	3,833
Viti	12	14	26
Vushtrri	68	143	211
Malishevë	26	5	31
Mamushë	39	12	51
Graçanicë	745	104	849
Klllokot	9	0	9
Total	8,824	15,436	24,260

Strategjia për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian 2009-2015 i referohet të dhënave specifike që vënë në pah pozitën e pafavorshme të këtyre dy komuniteteve në të gjitha fushat e jetës në raport me komunitetet tjera, e që kanë rezultuar me shkallën e lartë të varfërisë në mesin e tyre¹⁷.

3.1. Legjislacioni

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton të drejtat themelore në kuadër të kapitullit II të Kushtetutës (të drejtat e njeriut) dhe ofron mbrojtje shtesë për të drejtat e komuniteteve në kuadër të kapitullit III të Kushtetutës (të drejtat e komuniteteve). Të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale të garantuara me marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare, garantohen edhe me Kushtetutë dhe janë drejtpërdrejt të aplikueshme në Republikën e Kosovës, ku, në rast konflikti, ato kanë prioritet në raport me normat ligjore dhe aktet tjera të institucioneve publike.¹⁸

- Sistemi ligjor i vendit përmban në vete pako ligjore që burojnë nga të drejtat e garantuara të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në fusha të ndryshme¹⁹.
- Nevoja për një përkushtim më të madh në lidhje me promovimin dhe sigurimin në praktikë të të drejtave të njeriut, nga këndvështrimi i parandalimit dhe eliminimit të diskriminimit, direkt ose indirekt, të disa grupeve, ka nxjerrë në pah nevojën për adoptimin e legjislacionit për mbrojtjen e këtyre grupeve²⁰.

¹⁷ Raporti i UNDP-së për Zhvillimin Njerëzor, 2010.

http://ëëë.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/KHDR/HDR_2010_English.pdf?doenload

¹⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 17.2; 2008: Deklarata universale për të drejtat e njeriut; Konventa evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe liritë fundamentale bashkë me protokollet e saj; Konventa ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike bashkë me protokollet e saj; Konventa kornizë e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave kombëtare; Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor; Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave; Konventa për të drejtat e fëmijës; Konventa kundër torturës dhe reformave të tjera të trajtimit ose ndëshkimit të egër, johuman dhe degradues.

¹⁹ Ligji për Lirinë Fetare në Kosovë, http://ëëë.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2006_02-L31_al.pdf (shkarkuar më 13.10.2016); Ligji për Trashëgiminë Kulturore, Ligji për Përdorimin e Gjuhëve, http://ëëë.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2006_02-L37_al.pdf (shkarkuar më 13.10.2016); http://ëëë.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2006_02-L88_al.pdf (shkarkuar më 13.10.2016); Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, http://ëëë.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L047_al.pdf (shkarkuar më 13.10.2016); Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, http://ëëë.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_al.pdf (shkarkuar më 13.10.2016); Ligji për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, http://ëëë.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L068_al.pdf (shkarkuar më 13.10.2016).

²⁰ Ligji për Mbrojtjen kundër Diskriminimit, <http://ëëë.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-021%20sh.pdf> (shkarkuar më 13.10.2016); Ligji për Barazi Gjinore, <http://ëëë.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-020%20sh.pdf> (shkarkuar më 13.10.2016); Ligji për Avokatin e Popullit, <http://ëëë.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-019%20sh.pdf> (shkarkuar më 13.10.2016).

Duke i kontribuar sigurimit të zbatimit të të drejtave për mbrojtjen e pakicave, të njohura ndërkombëtarisht dhe të zbatueshme drejtpërdrejt në Kosovë, si dhe ligjeve specifike të vendit²¹, Qeveria ka aprovuar rregullore të veçantë²² për formimin e zyrave për komunitete dhe kthim në të gjitha komunat. Mandati i këtyre zyrave është të identifikojnë, promovojnë, përkrahin, zbatojnë dhe mbikëqyrin politikat, aktivitetet dhe programet relevante për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve; qasjen e barabartë të komuniteteve në shërbime publike; krijimin e kushteve për kthimin e qëndrueshëm të refugjatëve, të të kthyerve, personave të zhvendosur dhe atyre të riatdhesuar.

3.2. Politikat

Kosova ka një kornizë të sofistikuar politike dhe, përveç strategjisë së skaduar dhe planit të veprimit, si dhe planeve lokale për zbatimin e strategjisë në nivelin lokal, ka edhe politika të tjera që janë relevante për përfshirjen e shtuar të komuniteteve rom dhe ashkali. Sidoqoftë, dy nga katër dokumentet e politikave që janë shfrytëzuar në procesin e zhvillimit të kësaj strategjie janë ende në fazën e hartimit ose të aprovimit. Janë aprovuar Strategjia për Komunitete dhe Kthim 2014-2018 dhe Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021 dhe është bërë ndërlidhja me këto dokumente strategjike.

3.3. Mekanizmat për mbrojtjen e komuniteteve në Kosovë

Në mesin e shteteve të Ballkanit Perëndimor, Kosova ka më së shumti mekanizma të përqendruara në të drejtat e komuniteteve jo shumicë, si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal. Përderisa, disa nga këto mekanizma kanë të bëjnë me mbrojtjen e tyre nga diskriminimi, të tjerat merren edhe me çështje që lidhen me pjesëmarrjen në vendimmarrje.

Këshilli Konsultativ për Komunitetet është themeluar në përputhje me Ligjin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë. Mandati i Këshillit përfshin përmbledhjen dhe artikullimin e pikëpamjeve të komuniteteve, koordinimin dhe konsultimin mes komuniteteve, komunikimin me institucionet shtetërore dhe dhënien e rekomandimeve për alokimin e burimeve për iniciativat përkatëse.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthimit, në kuadër të Kuvendit të Kosovës është përgjegjës për shqyrtimin e projektligjeve dhe formulimin e rekomandimeve për komunitete dhe kthim.

Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM), është përgjegjëse për të koordinuar çështjet e të drejtave të njeriut me të gjitha ministritë dhe komunat. Zyra ofron këshilla për qeverinë, harton politika, monitoron rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe zbatimin e strategjisë për të drejta të njeriut. ZQM ofron këshilla për Kryeministrin dhe njësitë përkatëse të ZKM-së, në sferat e qeverisjes së mirë, të të drejtave të njeriut, mundësive të barabarta dhe në çështjet kundër diskriminimit; harton politika në sferën e qeverisjes së mirë, në sferën e të drejtave të njeriut, në mundësitë e barabarta dhe në çështjet kundër diskriminimit, shqyrton politikat e veprimit, projekt legjislativonin të përgatitur nga organet qeveritare në pajtim me standardet e të drejtave të njeriut në fuqi dhe të praktikave të qeverisjes së mirë në bashkëpunim me Zyrën Ligjore, si dhe këshillon e i jep rekomandime kryeministrit dhe ministrive përkatëse në përputhje me

²¹ Ligji nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale; Ligji nr.03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

²² Rregullore nr. 02/2010 për zyrat komunale për komunitete dhe kthim. http://ëëë.kryeministri-ks.net/repository/docs/Rregullore_per_Zyrat_komunale_per_Komunitete_dhe_Kthim.pdf

rrethanat. Po ashtu, ZQM ndihmon në zhvillimin dhe zbatimin e fushatave të komunikimit me publikun dhe të projekteve të tjera promovuese për të nxitur vetëdijësimin e popullatës mbi standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, transparencës, etikës dhe llogaridhënies në administratën publike, qeverisjen e mirë, mundësitë e barabarta, kundër diskriminimi dhe parimet tjera të qeverisjes demokratike. Këto autorizime bëjnë që ZQM/ZKM të drejtojnë procesin e hartimit të Strategjinë dhe Planit të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021.

Zyra për Çështjet e Komuniteteve (ZÇK), në kuadër të ZKM, është themeluar në vitin 2008 për të kontribuar në koordinimin e përpjekjeve të Qeverisë për të zbatuar kornizën ligjore kombëtare për të drejtat e komuniteteve dhe për të siguruar që politikat qeveritare dhe veprimet adekuate të përmbushin nevojat dhe interesat e komuniteteve. Gjithashtu, ZÇK përdorë fondet e saj, në mënyrë strategjike, për të përmbushur nevojat e komuniteteve.

Zyra e Komisionarit për Gjuhët, në kuadër të ZKM, është përgjegjëse për ruajtjen, promovimin dhe mbrojtjen e gjuhëve, siç parashihet në Ligjin për përdorimin e gjuhëve.

Komunat, në të cilat pjesëtarët e komuniteteve përbejnë së paku dhjetë për qind të popullsisë lokale, kanë detyrime ligjore shtesë, siç janë krijimi i posteve të zëvendës kryesuesit të kuvendit komunal për komunitetet dhe nënkryetarit të komunës. Përderisa, roli i zëvendës kryesuesit është që të shërben si pikë kontakti për çështjet e komuniteteve përkatëse për punën e kuvendit, roli i nënkryetarit është të këshillojë kryetarin për çështjet që lidhen me komunitetet.

Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) kanë për qëllim për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e komuniteteve, për të siguruar qasjen e barabartë të komuniteteve në shërbimet publike, dhe për të krijuar kushte për kthim të qëndrueshëm dhe ri-integrim të refugjatëve, personave të zhvendosur dhe personave të riatdhesuar.

Komiteti komunal për komunitete është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së veprimit të autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti, gjithashtu, i rekomandon kuvendit të komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës. Komiteti i komuniteteve përfshinë në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga anëtarët e Kuvendit të komunës, ndërsa anëtarët tjerë janë përfaqësuesit e komuniteteve. Çdo komunitet që jeton në një komunë përfaqësohet nga, së paku një përfaqësues në komitetin për komunitete. Përfaqësuesit e komuniteteve jo shumice në komunë e përbëjnë shumicën e anëtarëve të komitetit të komuniteteve.

3.4. Arsimi

Me zbatimin e Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2009-2015 dhe me ndërmarrjen e masave nga Qeveria e Kosovës dhe autoritetet lokale është arritur një përmirësim i pjesëmarrjes së pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në sistemin arsimor. Megjithatë, përfshirja e komuniteteve rom dhe ashkali në sistemin arsimor, si dhe braktisja e shkollimit nga pjesëtarët e këtyre komuniteteve, ende mbeten sfida për shoqërinë. MASHT dhe MPB kanë nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi me qëllim të integritimit në sistemin arsimor publik të

Republikës së Kosovës të fëmijëve të riatdhesuar, prej së cilës pritet të përfitojë një numër i konsiderueshëm i fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali. Po ashtu, MASHT ka nxjerrë akte nënligjore të veçanta për ta lehtësuar integrimin e fëmijëve të ri-atdhesuar në sistemin e shkollimit në Kosovë. Është ofruar mundësia e mësimin të gjuhës rome si lëndë zgjedhore, ndërsa në arsimin e lartë MASHT ka nxjerr udhëzimin administrativ për përcaktimin e vendeve të rezervuara për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali²³.

Tabela 3 jep të dhëna për regjistrimin e fëmijëve/nxënësve të komuniteteve rom dhe ashkali në arsimin parauniversitar, ndërsa tabela 4 për braktisjen e tyre. Nga tabela 3 vërehet një trend i lehtë i zvogëlimit në regjistrime në periudhën 2012/13-2014/15 që mund të jetë rezultat i zvogëlimit të natalitetit, ndërkaq gjendja në vitin 2015/16 mund të jetë rezultat i valës së shpërnguljeve nga fundi i vitit 2014 dhe fillimi i vitit 2015 e cila përfshiu një numër të konsiderueshëm të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali.

Në favor të kësaj flet edhe rritja e braktisjes së shkollimit në vitet shkollore 2014/15 dhe 2015/16 e cila shihet nga tabela 4. Përveç varfërisë shkaqet e tjera të braktisjes duhet të kërkohen edhe tek vetëdijesimi i ulët për rëndësinë e shkollimit dhe martesat e hershme të vajzave.

Tabela 3. Regjistrimi i fëmijëve/nxënësve të komuniteteve rom dhe ashkali në arsimin parauniversitar në periudhën 2012/13-2015/16.

Përkatësia etnike	2012/2013	2013/2014	2014/2015	2015/2016
Rom	1,996	2,059	1,918	1,853
Ashkali	4,068	4,210	4,177	3,529
Gjithsej	6,064	6,269	6,095	5,382

(Burimi: Të dhëna nga statistikat vjetore të MASHT)

Tabela 3. Braktisja e nxënësve rom dhe ashkali në periudhën 2013/14-2015/16.

2013/14	Klasa	Rom			Ashkali			Rom dhe Ashkali		
		M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj
	Kl. 1-9	39	51	90	34	26	60	73	77	150
	Kl. 10-13	0	0	0	1	0	1	1	0	1
	Gjithsej	39	51	90	35	26	61	74	77	151
2014/15	Klasa	Rom			Ashkali			Rom dhe Ashkali		
		M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj
	Kl. 1-9	58	54	112	63	64	127	121	118	239
	Kl. 10-12	3		3			0	3		3
	Gjithsej	61	54	115	63	64	127	124	118	242
2015/16 Gjysmë vjetori i parë	Klasa	Rom			Ashkali			Rom dhe Ashkali		
		M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj
	Kl. 1-9	55	35	90	65	62	127	120	97	217
	Kl. 10-12			0	1	1	2	1	1	2
	Gjithsej	55	35	90	66	63	129	121	98	219

(Burimi: Të dhëna nga MASHT)

²³ UA NR.09.2016 Aplikimi i masave afirmative dhe vendeve të rezervuara për regjistrim të kandidatëve nga komunitetet joshumicë në institucionet publike të arsimit të lartë. <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/06/ua-masht-09-2016-aplikimi-i-masave-afirmative-dhe-vendeve-te-rez-al.pdf>

Është interesante se shifrat e braktisjes që japin OJQ-të janë më të mëdha dhe arsyeja mund të jetë tek metodologjia e mbledhjes dhe e përpunimit të të dhënave. Pavarësisht kësaj, braktisja mbetet dukuri tejet brengosëse kur bëhet fjalë të komunitetet rom dhe ashkali.

Megjithëse nuk ka të dhëna zyrtare për pjesëmarrjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e lartë ekziston një indikacion se numri i studentëve është të paktën 256²⁴.

Sipas një studimi të Agjencisë së Statistikave të Kosovës^{25 26} niveli i lexim-shkrimit te komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian është shume i ulët në krahasim me popullatën shumicë, dhe e njëjta gjë vlen për nivelin arsimor të komuniteteve. Të dhënat kryesore të këtij studimi që kanë të bëjnë me nivelin arsimor të komuniteteve janë prezantuar në vijim:

- Aftësia për lexim shkrim – Përqindja e të rinjve të moshës 15-24 vjeçare që janë në gjendje të lexojnë fjali të shkurta rreth jetës së përditshme ose që kanë vijuar arsimin e mesëm të lartë apo arsimin e lartë:
 - (a) Femra – 72.8 % (98% në nivel të Kosovës).
 - (b) Meshkuj – 86.5 % (97.6% në nivel të Kosovës).
- Vijueshmëria e arsimit në moshë të hershme - Përqindja e fëmijëve të moshës 36-59 muajsh që vijojnë ndonjë program të arsimit parashkollor : 16.1% (13.9% në nivel të Kosovës).
- Përgatitja për shkollë - Përqindja e fëmijëve në klasën e parë të shkollës fillore që kanë vijuar arsimin parafillor gjatë vitit shkollor paraprak: 53.9 % (75.5 % në nivel të Kosovës).
- Shkalla neto e regjistrimit në arsimin fillor: 68.1% (91.6% në nivel të Kosovës).
- Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës fillore që aktualisht vijojnë arsimin fillor ose të mesëm: 85.3 % (98% në nivel të Kosovës).
- Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës së mesme të ulët që aktualisht vijojnë shkollën e mesme të ulët ose më shumë: 65.0 % (95.9% në nivel të Kosovës).
- Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës së mesme të lartë, që aktualisht vijojnë shkollën e mesme të lartë ose më shumë: 30.3 % (82% në nivel të Kosovës).
- Fëmijët në punë - Përqindja e fëmijëve të moshës 5-17 vjeçare, të cilët janë të angazhuar në punë: 16.6 % (10.7% në nivel të Kosovës).

Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar Planin Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2021, ku parashihen masa për arritjen e disa treguesve specifikë për arsimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian deri në vitin 2021:

- Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në edukimin parafillor (Caku: 70%)
- Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin fillor (Caku: 95%)
- Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e mesëm të ulët (Caku: 85%)
- Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e mesëm të lartë (Caku: 50%)
- Shkalla e transicionit në arsimin e mesëm të lartë për fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian (Caku: 80%)
- Indeksi i paritetit gjinor për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian (Caku: SHFMU – 1, SHML – 0.90)

²⁴ Burimi: OJQ Advancing Together.

²⁵ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Komunitetet Rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës, Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë 2013-2014.

²⁶ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Monitorimi i gjendjes së fëmijëve dhe grave, Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë 2013-2014.

3.5. Punësimi dhe mirëqenia sociale

3.5.1. Punësimi

Niveli i ulët i punësimit mbetet problemi kyç ekonomik e shoqëror i Kosovës, në përgjithësi. Sipas anketës së Pulsit Publik²⁷, 78 për qind e kosovarëve e citojnë papunësinë si problemin më të madh të Kosovës. Kjo statistikë është e kuptueshme duke konsideruar se Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP) 2015 tregon se shkalla e papunësisë është në nivel tejet të lartë prej 32.9 për qind, ndërsa shkalla e punësimit (raporti në mes numrit të punësuarve ndaj popullsisë në moshë pune) është vetëm 25.2 për qind²⁸.

Statistikat e publikuara për gjendjen e punësimit të komuniteteve rom dhe ashkali janë të bazuara, kryesisht, në anketa që nuk e kanë tregun e punës si fokus të hulumtimit dhe nuk përdorin metodologji dhe definicione konvencionale, prandaj si të tilla ato duhet të konsiderohen vetëm indikative dhe nuk janë (plotësisht) të krahasueshme me indikatorët më lart, në nivel të vendit. Megjithatë, statistikat ekzistuese tregojnë se gjendja e punësimit të këtyre komuniteteve është dukshëm më e rëndë krahasuar me të gjitha komunitetet tjera. Për shembull, Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2010 raporton se shkalla e papunësisë në familjet rome, ashkali dhe egjiptiane në vitin 2009 ishte rreth 58 për qind, në krahasim me mesataren e popullatës prej 45 për qind²⁹. Por, duke qenë se në një vend si Kosova, me papunësi të lartë, numri i të papunëve të dekurajuar është i lartë (që pastaj ndikon që statistikat për pjesëmarrjen në tregun e punës dhe papunësinë të jenë më të ulëta), shkalla e punësimit është tregues më kuptimplotë i gjendjes. Megjithëse nuk ka të dhëna gjithëpërfshirëse, ky tregues shfaq dallime edhe më të mëdha në mes komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe komuniteteve të tjera. Kështu, në komunat e Obiliqit dhe Fushë Kosovës shkalla e punësimit për romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët llogaritet vetëm 7 për qind, krahasuar me 40 për qind për shqiptarët dhe 21 për qind për serbët³⁰. Gjendja e vështirë në tregun e punës konsiderohet të jetë faktor kyç që ka shtyrë një pjesë të konsiderueshme të individëve të këtyre komuniteteve të emigrojnë gjatë valës së fundit emigrimeve që mori hov në fund të vitit 2014 dhe në fillim të vitit 2015.

Nga pikëpamja e politikëbërjes mund të identifikohen dy lloj mekanizmash/masash kyçe për promovimin e punësimit të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve (si dhe komuniteteve të tjera pakicë):

- Korniza ligjore që rregullimin e përfaqësimit në punësim të pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë në shërbimin civil
- Masat aktive të tregut të punës të realizuara nga MPMS (në bashkëpunim me MPB dhe/ose donatorët)

Që nga viti 2010, Ligji 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përcakton përfaqësimin në shërbimin civil për komunitetet jo shumicë përmes kuotës minimale prej 10 për qind në nivel qendror dhe përfaqësimit proporcional me përbërjen demografike në nivel komunal. Më tej,

²⁷ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Pulsit Publik XI, Maj 2016.

²⁸ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore 2015 në Kosovë, 2016.

²⁹ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Raporti i Zhvillimit njerëzor 2010.

³⁰ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Community Vulnerability Assessment Report, 2013.

Këto statistika janë përllogaritur si raport në mes të të punësuarve (sipas vetë-raportimit) dhe numrit të individëve në moshë pune të llogaritur si shumë e tri kategorive të vetë-raportuara që supozohen të jenë në moshë pune (të punësuar, të papunësuar dhe individë që me orar të plotë kujdesen për shtëpinë) dhe duke i mos i përfshirë kategoritë që (supozohet që) nuk janë në moshë pune (ata që janë duke u shkolluar dhe pensionistët).

Rregullorja 04/2010 për Procedurat e përfaqësimit të drejtë dhe proporcional të komuniteteve jo shumice në shërbimin civil të Republikës së Kosovës parasheh që institucionet të zbatojnë së paku 6 nga 14 masat e parapara aty që përfshijnë: komunikimin; masat pozitive vepruese; praktikën në punë, bursat, dhe programet e trajnimit për aplikuesit; trajnimet për shërbyesit civil të komuniteteve jo shumicë; punëtoritë kundër diskriminimit; dhe bashkëpunimin ndër-institucional.

MPMS, për punëkërkesit e regjistruar në Zyrat e Punësimit, ofron shërbime këshillimi, ndërmjetësim në punë, trajnime profesionale dhe pjesëmarrje në skema të ndryshme të masave aktive të tregut të punës (p.sh. subvencionim page, praktikë në punë, projekte për punësim sezonal, grante për fillim biznesi, etj.), dhe informata për migrim me qëllim të punësimit të rregullt. Sigurimi i pjesëmarrjes në masat aktive të tregut të punës (MATP) për komunitetet jo shumicë zakonisht sigurohet përmes kuotës për këto komunitete, në kuadër të skemave të MATP. Në vitin 2014, numri i pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian ishte 247 dhe këta përbënin 10% të numrit të përgjithshëm të përfituesve nga MATP. Në gjysmën e parë të vitit 2016 numri i pjesëmarrësve të këtyre komuniteteve në MATP ishte 95 (28 romë, 67 ashkali), ndërkohë që aktualisht numri i punëkërkesve të komunitetit rom që janë të regjistruar në zyrat e punësimit është 2,262, nga të cilët 49.5 për qind janë gra³¹. Pjesa më e madhe të punëkërkesve të regjistruar janë të koncentruar në Prizren dhe Pejë (76 dhe 18 %, respektivisht), pasuar nga Prishtina dhe Mitrovica (me 3 dhe 2 %, respektivisht).

Disa MATP për këto komunitete ofrohen edhe në kuadër të aktiviteteve për riatdhesim. Që nga viti 2012 MPB, si financuese, në bashkëpunim me MPMS dhe UNDP si zbatuese, kanë zhvilluar aktivitete për mbështetjen e trajnimit dhe punësimit të personave të riatdhesuar në kuadër të Programit Aktiv të Tregut të Punës për Rininë në Kosovë. Në shkurt të vitit 2016, këto aktivitete janë zgjeruar për të gjithë personat e riatdhesuar, duke ju ofruar mundësi trajnimi dhe punësimi në kuadër të Programit Aktive të Tregut të Punës në Kosovë. Në kuadër të Programit të ri-integrimit, ofrohet financim i planeve të biznesit për personat e riatdhesuar të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara në Rregulloren QRK Nr. 04/2016 për Ri-integrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të ri-integrimit.

3.5.2. Mirëqenia sociale

Shumica e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali jetojnë në varfëri ekstreme³² dhe vazhdojnë të ndeshen me kushte të vështira të jetesës³³. Situata është posaçërisht e vështirë për 20% të më të varfërve të këtyre komuniteteve dhe familjeve që jetojnë në zonat rurale³⁴. Studimi i vitit 2013³⁵ në komunën e Fushë Kosovës dhe Obiliqit ka gjetur se dy të tretat e familjeve të komunitetit rom dhe afër gjysma e komunitetit ashkali hasin vështirësi në plotësimin e nevojave për ushqim dhe nevoja të tjera elementare.

³¹ Të dhënat nga MPMS, Sistemi i Informatave për Menaxhimin e Punësimit, Shtator 2016. Në këtë kohë numri i punëkërkesve të komunitetit ashkali ishte 0, mirëpo ishin 2805 të regjistruar në sistem si „Të tjerë“, prej të cilëve me gjasë një pjesë i përkasin këtyre komuniteteve. Gjithashtu, duhet pasur parasysh se jo të gjithë të papunët regjistrohen tek zyrat e punësimit, prandaj numri real i të papunëve është më i lartë.

³² Eorl Bank, Kosovo Country Snapshot, 2015.

³³ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Komunitetet Rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës, Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë 2013-2014; Komisioni Evropian, Raporti i Progresit për Kosovën, 2015; Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Raporti i Zhvillimit Njerëzor, 2010.

³⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës, Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë 2013-2014.

³⁵ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Community Vulnerability Assessment Report, 2013.

Për të zbutur nivelin e varfërisë në Kosovë ekzistojnë vetëm dy skema të ndihmës sociale. *Ndihmën sociale të kategorisë e parë* e realizon familja³⁶ në të cilën të gjithë anëtarët e familjes janë të varur dhe të paaftë për punë të paguar³⁷ dhe asnjëri prej tyre nuk është i punësuar (vlera bazë sillet nga 50 Euro për familjet me një anëtar deri në 150 Euro me 15 anëtarë)³⁸.

Ndihmën sociale të kategorisë së dytë e realizon familja me një anëtar të familjes të aftë për punë (i cili duhet të jetë i regjistruar si i papunësuar në Zyrën e Punësimit) dhe me të paktën një fëmijë nën moshën pesë vjeç apo që kanë në përkujdesje të përhershme një jetim nën moshën pesëmbëdhjetë vjeç (vlera bazë sillet nga 50 Euro për familjet me një anëtar deri në 150 Euro me 15 anëtarë). Familjet përfituese të ndihmës sociale, për çdo fëmijë të moshës deri 18 vjeç, realizojnë një përfitim financiar prej 5 euro në formën e shtesës për fëmijë, me qëllim të nxitjes së arsimimit dhe përmirësimit të shëndetit, si dhe kanë të drejtë të aplikojnë për lirim nga pagesa për rreth 20 Euro nga fatura mujore e energjisë elektrike (të cilën të drejtë e kanë edhe familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës dhe viktimat civile të luftës).

Sipas të dhënave të MPMS-së, 1,736 familje të komuniteteve rom dhe ashkali kanë pranuar ndihma sociale gjatë vitit 2015³⁹. Të dhënat tregojnë se numri i familjeve të komuniteteve rom dhe ashkali që kanë përfituar ndihma sociale ka shënuar rënie nga viti në vit ndërsa vlera e përfituar monetare ka shënuar rritje, si rezultat i rritjes së ndihmës sociale.

Tabela 4. Numri i familjeve përfituese nga skema e ndihmave sociale për të dy komunitetet

	Rom			Ashkali		
	Numri i familjeve	Numri i anëtarëve të familjeve	Vlera totale në Euro	Numri i familjeve	Numri i anëtarëve të familjeve	Vlera totale në Euro
Dhjetor 2013	929	4,273	61,185	1,223	6,340	84,940
Dhjetor 2014	905	4,188	71,405	1,069	5,473	90,000
Dhjetor 2015	718	3,133	57,540	1,018	4,962	86,083

Burimi: MPMS, 2016

Tabela 5. Numri i familjeve përfituese nga dy komunitetet dhe numri i përgjithshëm i përfituesve nga ndihmat sociale në Kosovë

	Të dy komunitetet			Të gjithë në Kosovë			Mesatarja ditore e ndihmës sociale për një anëtarë	
	Numri i familjeve	Numri i anëtarëve të familjeve	Vlera totale në Euro	Numri i familjeve	Numri i anëtarëve të familjeve	Vlera totale në Euro	Në Kosovë	Për komunitetet rom dhe ashkali
Dhjetor 2013	2,152	10,613	146,125 €	29,688	123,554	1,924,017 €	0.52 €	0.46 €

³⁶ Sipas ligjit për Skemën e Ndihmës Sociale (Neni 2, paragrafi 1) familja përbëhet prej atyre personave nevojat e të cilëve merren parasysh me rastin e vendosjes së përzgjedhshmërisë dhe shumës së ndihmës sociale, dhe përkufizohet si një bashkësi që përbëhet prej paraqitësit të kërkesës ose marrësi të ndihmës dhe të gjithë anëtarëve të tjerë të familjes, të cilët janë në bashkësi familjare.

³⁷ Person i/e varur – përkufizohet si individ i cili i takon njërit prej grupeve që vijojnë: personat që janë mbi moshën tetëmbëdhjetë vjeç (18 vjeç) dhe të cilët kanë të meta të rënda dhe aftësi përhër të kufizuara që e bëjnë atë të paftë për të punuar për punë shpërblyese, personat që janë gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç apo më të moshuar, kujdestarët e përhershëm të personave me aftësi të kufizuara apo të personave në moshën 65 vjeç ose më të vjetër të cilëve u nevojitet kujdes i përhershëm, apo fëmija nën moshën 5 vjeç, personat deri në moshën 14 vjeç, personat ndërmjet moshave 15 dhe 18 vjeç dhe të cilët janë në shkollim të rregullt të mesëm, prindërit vetushqyes me së paku një fëmijë nën moshën 15 vjeç.

³⁸ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e Mirëqenies Sociale 2015, 2016.

³⁹ MPMS, Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjare, Shtator 2016.

Dhjetor 2014	1,974	9,661	161,405 €	27,389	113,842	2,084,983 €	0.61 €	0.56 €
Dhjetor 2015	1,736	8,095	143,603 €	25,943	107,452	2,398,526 €	0.74 €	0.59 €

Burimi: MPMS, 2016

Përveç skemave të ndihmës sociale, aktualisht, në Kosovë zbatohet edhe skema të tjera të mbështetjes sociale, ku përfshihen pensionet dhe kompensimet/mbështetje financiare, të shënuara në vijim.

Pensionet

- Pensioni bazik i moshës i paguar për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, që kanë mbushur moshën 65 vjeç (në vlerë prej 75 Euro);
- Pension kontribut pagues i moshës, për qytetarët e punësuar në Republikës e Kosovës, të cilët i kanë paguar kontributet, në ish-Fondin Pensional të Kosovës para datës 01.01.1999 (158-230 Euro, bazuar në nivelin e arsimit);
- Pensionet e personave të moshës 18-65 vjeç me aftësi të kufizuar të përhershme (në vlerë prej 75 Euro);
- Pensionet e Trepçës, për të gjithë të punësuarit në kompleksin “Trepça” të cilët e kanë humbur vendin e punës deri në fund të vitit 2004;
- Pensionet e Trupave Mbrojtëse të Kosovës;
- Pensionet e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Në vitin 2016 vetëm 160 pjesëtarë të komunitetit rom dhe 146 të atij ashkali kanë pranuar pensionet bazë e që përbëjnë vetëm 0.2% të numri të përgjithshëm të përfituesve nga ky pension. Një sqarim i ofruar⁴⁰ për këtë numër të vogël është theksuar të jetë jetëgjatësia e shkurtër e këtyre komuniteteve, e cila llogaritet të jetë, mesatarisht, 60 vjet⁴¹. Numri i vogël i përfituesve nga pensioni kontribut dhënës mund të lidhet me faktin se punësimi tek këto komunitetet ka qenë, vazhdimisht, i ulët. Vetëm 1.1% e fëmijëve me aftësi të kufizuara për të cilët familjet marrin mbështetje financiare janë pjesëtarë të komuniteteve rom dhe ashkali (88 dhe 132 fëmijë respektivisht)⁴².

Tabela 6. Numri i përfituesve nga pensionet

	Pension Bazë	Pension Kontributiv	Pension për Personat me Aftësi të Kufizuara
Rom	160	66	88
Ashkali	146	52	132
Totali në Kosovë	127,643	41,789	19,396
% e dy komuniteteve në numrin e përgjithshëm të përfituesve	0.2%	0.3%	1.1%

⁴⁰ Ushtrues Detyre i Udhëheqësit të Departamentit të Pensioneve, MPMS, gusht 2016.

⁴¹ Sigurimi i ri shëndetësor do të shpëtojë jetë: Jetëgjatësia dhe shëndeti në komunitetet Rome, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë. Balkan Sunfloëers. 2016.

⁴² Të dhënat për komunitetin egjiptian, Ministria i përfshin tek grupi “të tjerët” andaj nuk ekziston e dhëna veçmas për këtë komunitet.

Kompensimet dhe format e tjera të mbështetjes financiare

- Kompensimet për personat e verbër dhe shoqëruesit e tyre (125 Euro secili);
- Familjet e dëshmorëve dhe Invalidët e luftës së UÇK-së;
- Veteranët e luftës së UÇK-së (170 Euro);
- Skema për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të përhershme të kufizuara (100 Euro për fëmijë).

Nga Tabela 7 vihet re se, mesatarisht, për 100 fëmijë me aftësi të kufizuara të këtyre komuniteteve, familjet kanë përfituar mbështetje financiare, e që përbën rreth 3.8% (104 nga 2,770) të numrit të përgjithshëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme që përfitojnë nga skema e familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara.

Tabela 7. Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme të komuniteteve rom dhe ashkali që përfitojnë nga skema e familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara

Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara të moshës 1-18 vjeçare për të cilët familjet pranojnë mbështetje financiare			
	Rom	Ashkali	Gjithsej të dy komunitetet
Dhjetor 2013	36	52	88
Dhjetor 2014	34	53	87
Dhjetor 2015	33	50	83

Burimi: MPMS, 2016

Shërbimet sociale

Përveç mbështetjes financiare, përmes qendrave për punë sociale në komuna, MPMS ofron edhe shërbime sociale duke përfshirë: shërbimet këshillëdhënëse familjare, shërbime për mbrojtjen e fëmijëve, shërbimin për fëmijët e braktisur, shërbimin e adoptimit të fëmijëve; strehim për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara pa përkujdesje familjare dhe shërbimet për rastet e dhunës në familje dhe shërbimet për integrimin e viktimave të trafikimit. Familjet në të cilat vendoset fëmija për përkujdesje familjare, gëzojnë mbështetje financiare deri në 150 Euro në muaj, ndërsa kur fëmija vendoset tek familjarët, familja pranuese mbështetet me 75 Euro në muaj.

Tabela në vijim tregon se mesatarisht në vit, 300 pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian janë shërbyer nga QPS, por që dy të tretat e shërbimeve kanë qenë të natyrës administrative (vërtetime, mbështetje me dokumentacione) dhe vetëm një e treta kanë qenë shërbime sociale.

Tabela 8. Numri i pjesëtarëve rom, ashkali dhe egjiptian që kanë shfrytëzuar shërbimet sociale nga QPS

Shërbimet dhe klientët	2013	2014	2015
Shërbimet për fëmijët			
Fëmijët e braktisur	12	8	8
Fëmijët e keqtrajtuar	2	5	5
Fëmijët e prindërve të penguar në kryerjen e detyrës prindërore	3	1	1
Fëmijët jetim	2	0	1
Fëmijët me sjellje asociale	5	12	8

Kërkesa për strehim familjar	2	1	0
Klientët me aftësi të kufizuara – Fëmijët	0	0	0
Puna e rrezikshme e fëmijëve	2	9	7
Rrëmbimi ndërkombëtarë i fëmijëve	0	0	0
Të miturit në konflikt me ligjin	7	24	15
Martesa e të miturve	5	16	11
Adaptimi ndërkombëtarë	0	0	0
Adaptimi vendor	1	2	1
Shërbimet këshillëdhënëse			
Këshilla martesore	31	33	24
Përdoruesit e substancave narkotike	0	0	0
Shërbimet për personat e moshuar dhe me aftësi të kufizuara			
Të rriturit me aftësi të kufizuara	0	0	0
Personat e moshuar	1	1	1
Shërbimet për rastet e dhunës në familje dhe trafikimit			
Viktimat e dhunës familjare	13	20	11
Viktimat e krimeve seksuale	1	1	1
Viktimat e trafikimit	0	0	1
Shërbime administrative	174	188	193
Total	261	321	288

Burimi: MPMS, 2016

Sa i përket shërbimit të strehimit, në vitin 2015, 13 persona me aftësi të kufizuara të këtyre komuniteteve janë strehuar në Institutin Special të Shtimes dhe në shtëpitë e komunitetit dhe 3 persona të moshuar janë vendosur në dy Shtëpitë për Persona të Moshuar.

3.6. Shëndetësia

Qasja në shërbime shëndetësore mbetet një prej sfidave kryesore të kësaj fushe. Raporte të ndryshme vënë në dukje faktorë financiarë edhe jo financiarë që ndikojnë në qasjen në shërbimet shëndetësore^{43 44 45}. Pengesat kryesore për shfrytëzimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor janë: 1) financiare, 2) largësia e madhe nga objektet e kujdesit shëndetësor, dhe 3) kohët e gjata të pritjes^{46 47}. Studimi⁴⁶ tregon se 79.5% e pjesëtarëve të komunitetit nuk e kanë vizituar mjekun më shpesh për shkak të pamundësisë për të paguar ilaçin apo trajtimin. Madje edhe në qendrat e mjekësisë familjare, ku supozohet se vizitat janë pa pagesë, nga pacientët kërkohet të sjellin ilaçet dhe furnizimet tjera. Këto shpenzime shpesh paraqesin një pengesë për shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore. Më tutje, 48.8% të familjeve raportojnë se nuk kanë vizituar mjekun më shpesh për shkak të “largësisë së madhe”, dhe 54.5% për shkak të “mungesës së transportit”, ndërkohë që 49.6% të anketuarve pajtohen se anëtarët e familjeve të tyre e kanë shmangur shfrytëzimin e

⁴³ Stanculescu et al., The Performance of Public Health-care Systems in South-East Europe - A comparative qualitative study. Friedrich Ebert Stiftung. 2014.

⁴⁴ Hoxha et al., Antenatal Care Services in Kosovo. UNICEF. 2008.

⁴⁵ Bloom et al., Ethnic segregation in Kosovo's post-war health care system. European Journal for Public Health. 2007.

⁴⁶ Policy Brief 4: Qasja dhe shfrytëzimi i shërbimeve shëndetësore nga Romët, Ashkalitë dhe Egjiptianët. Solidar Suisse. 2016.

⁴⁷ Stanculescu et al., The Performance of Public Health-care Systems in South-East Europe - A comparative qualitative study. Friedrich Ebert Stiftung. 2014.

shërbimeve shëndetësore për shkak të kohës shumë të gjatë të pritjes⁴⁸. Kjo përfshinë kohën e pritjes në zyrën e mjekut dhe kohën e pritjes për trajtim specialistik.

Shfrytëzimi i shërbimeve preventive shëndetësore është shumë i ulët. Vetëm 4% e komunitetit kanë pasur një apo më shumë nga testet (skriningu) në vijim: mamografinë, testin e diabetit, testin për kancerin e qafës së mitrës, kancerin e prostatës, apo për sëmundjet seksualisht të transmetueshme.⁴⁹ Procedura më e zakonshme e shfrytëzuar preventive e kujdesit shëndetësor mbi moshën 30 vjeç është mamografia në 4% (28 individë).⁵⁰ Mbi 95% të atyre që kanë vizituar mjekun gjatë 12 muajve të kaluara janë diagnostikuar me një sëmundje akute apo kronike gjatë periudhës së njëjtë.⁵¹ Ky konstatim jep prova të forta që pjesëtarët e komunitetit rom dhe ashkali e vizitojnë mjekun me qëllim të kurimit e jo për qëllim të parandalimit, që do të thotë, vetëm atëherë kur i kanë simptomat e ndonjë sëmundjeje. Përdorimi joadekuat i terapisë është një tjetër shqetësim. Shumë pacientë ndalojnë marrjen e medikamenteve të përshkruara sapo simptomat fillojnë të zhduken. Në situata të tilla, gjendja shpesh do të rishfaqet me simptoma më të rënda dhe më të gjata. Koha e pritjes para kërkimit të trajtimit ka tendencë të jetë e gjatë. Zakonisht, pacientët nga këto komunitete kërkojnë kujdes shëndetësor në stadi më të zhvilluar të sëmundjeve të tyre. Si rezultat, jo vetëm që trajtimi i sëmundjes është më i vështirë, por gjithashtu edhe më i shtrenjtë, si për individin ashtu edhe për shoqërinë⁵².

Sjellja e pjesëtareve të komuniteteve rom dhe ashkali karshi shëndetit ka qenë edhe mbetet një prej problemeve kryesore. Komunitetet rom dhe ashkali nuk e konsumojnë një dietë të balancuar apo plotësojnë marrjen e një bilanci të ushqimit ditor që rekomandohet nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Racionet tipike kanë tendencë të përfshijnë një kombinim të fasuleve, patateve dhe sallameve të kualitetit të dobët, ushqimeve të përgatitura që janë të pasura me yndyrë dhe përbërje të kripës⁵³. Të dhënat tregojnë se më pak se një e katërta e individëve (18.7%) konsumojnë mish apo prodhime mishi në baza ditore dhe vetëm rreth gjysma në një racion ditor i përfshijnë perimet (60.7%), frutat (49.8%) dhe qumështin (50%)⁵⁴. Një përqindje e konsiderueshme e familjeve i konsumon ushqimet themelore një here në javë apo më rrallë: perimet (15%), frutat (23.6%), qumështin (17.2%), vezët (25.1%)⁵⁵. Komunitetet kanë tendencë të konsumojnë më tepër patetat, bukën dhe ushqimet tjera me bazë brumi që, në përgjithësi, janë më të varfra me materie ushqyese⁵⁶. Pa ushqim të duhur, individët nuk i marrin vitaminat dhe mineralet e nevojshme, dhe janë në rrezik nga anemia, obeziteti, dhe sëmundjet kronike si hipertensioni dhe diabeti. Për një të tretën e fëmijëve (36%) me diarre nuk është kërkuar këshillim apo trajtim, me 25% të tyre që u është dhënë shumë më pak apo pothuaj asgjë për të ngrënë, duke rezultuar me vetëm një të tretën (34%) të fëmijëve që kanë marrë trajtim rehidratues përmes gojës (ORT) dhe në të njëjtën kohë kanë vazhduar të ushqyerit që është edhe veprim i rekomanduar. Derisa kërkimi i kujdesit shëndetësor për diarre është i ulët, 74% të fëmijëve të moshës 0-59 muajsh me simptoma të IAR-së janë dërguar tek ofruesit e kualifikuar, por prapë se prapë, vetëm 7% të femrave i dinë së paku një nga dy shenjat

⁴⁸ Po aty.

⁴⁹ Po aty.

⁵⁰ Po aty.

⁵¹ Po aty.

⁵² Policy Brief 4: Qasja dhe shfrytëzimi i shërbimeve shëndetësore nga Romët, Ashkalitë dhe Egjiptianët. Solidar Suisse. 2016.

⁵³ Policy Brief 3: Të ushqyerit dhe mënyra e jetesës në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Solidar Suisse. 2016.

⁵⁴ Po aty.

⁵⁵ Po aty.

⁵⁶ Po aty.

e rrezikut të pneumonisë (frymëmarrjen e shpejtuar dhe vështirësinë në frymëmarrje)⁵⁷. Vetëm 30% të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptianë i kanë marrë të gjitha vaksinat e rekomanduara deri në ditëlindjen e parë, ndërsa 79% të fëmijëve të moshës 24-36 muajsh i kanë kartelat e vaksinimit⁵⁸.

Higjiena tek komunitetet rom dhe ashkali është e dobët dhe, shpeshherë, e kufizuar nga kushtet e varfërisë ekstreme: mungesa e ujit, shpenzimet e ujit dhe materialeve të pastrimit, etj. Konsumimi i përditshëm i duhanit është i zakonshëm⁵⁹. Aktiviteti fizik është i ulët në mesin e komuniteteve, me të rinjtë që janë më aktivë dhe me popullatën e vjetër që është më pak aktive. Në përgjithësi, më pak se gjysma (41.1%) e njerëzve janë të angazhuar në më shumë se aktivitetet themelore fizike me vetëm një të katërtën (26.8%) të angazhuar në baza ditore⁶⁰. Lindjet e hershme vazhdojnë të persistojnë në komunitet përkundër një rënie të lehtë⁶¹. Kjo paraqet rrezik serioz për shëndetin e nënave edhe foshnjave por edhe mirëqenien afatgjatë të këtyre familjeve.

Sëmundshmëria e theksuar flet për një gjendje shëndetësore jo të mirë të popullatës^{62 63}. Nga vlerësimet në vitin 2014, 95.4% të popullatës janë prekur nga ndonjë sëmundje që ishte diagnostikuar nga ana e një mjeku⁶⁴. Sëmundjet që më së shpeshti paraqiten, janë: hipertensioni (26% të anketuarve janë të prekur nga sëmundja), sëmundjet kardiovaskulare (17%), çrregullimet skeletore (11%), diabeti (10%), dhe sëmundjet e veshkave, kryesisht gurë në veshka (8%)⁶⁵. Përhapja reale mund të jetë dukshëm më e lartë se sa sugjerohet nga anketa. Për shembull, studimi i vitit 2010 në komunitetet e romëve të Serbisë konstatoi se numrin e rasteve të pa diagnostikuara të diabetit është, pothuajse, aq sa edhe numri i rasteve të diagnostikuara⁶⁶. Më shumë se një në gjashtë (17%) fëmijë romë, ashkali dhe egjiptianë nën moshën 5 vjeçare janë raportuar të kenë pasur një episod të diarresë dhe simptoma të infeksioneve akute respiratore (IAR), kurse pothuaj një në tre (30%) kanë pasur temperature⁶⁷.

Rrethanat e sipërpërmendura rezultojnë me jetëgjatësi më të shkurtër të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, e cila është më e shkurtër se 60 vjet, në krahasim me mesataren e Kosovës prej 70.5 vjet⁶⁸. Nga ana tjetër, janë identifikuar ndryshime të konsiderueshme rajonale. Për shembull, romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët nga zonat rurale jetojnë, mesatarisht, gjashtë vite më pak se homologët e tyre në zonat urbane.⁶⁹ Trendi i vdekshmërisë së foshnjave mes romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve është, pothuajse, i pandryshuar në 15 vitet e fundit, me shkallë të vdekshmërisë së foshnjave, gjatë pesë viteve para anketës, në 41 për njëmijë lindje të gjalla, përderisa shkalla e vdekshmërisë nën moshën pesë vjeçare është 49 për njëmijë lindje të gjalla. Kur

⁵⁷ Komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptianë në Kosovë 2013-2014, Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë: Raporti përmbledhës. Agjencia e Statistikave të Kosovës. 2014.

⁵⁸ Po aty.

⁵⁹ Policy Brief 3: Të ushqyerit dhe mënyra e jetesës në komunitetet Rome, Ashkali dhe Egjiptase. Solidar Suisse. 2016.

⁶⁰ Po aty.

⁶¹ Sigurimi i ri shëndetësor do të shpëtojë jetë: Jetëgjatësia dhe shëndeti në komunitetet Rome, Ashkali, dhe Egjiptase të Kosovës. Balkan Sunfloëers. 2016.

⁶² Po aty.

⁶³ Komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptianë në Kosovë 2013-2014, Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë: Raporti përmbledhës. Agjencia e Statistikave të Kosovës. 2014.

⁶⁴ Policy Brief 2: Përhapja e sëmundjeve në komunitetet Rome, Ashkali dhe Egjiptase. Solidar Suisse. 2016.

⁶⁵ Po aty.

⁶⁶ Po aty.

⁶⁷ Komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptianë në Kosovë 2013-2014, Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë: Raporti përmbledhës. Agjencia e Statistikave të Kosovës. 2014.

⁶⁸ Sigurimi i ri shëndetësor do të shpëtojë jetë: Jetëgjatësia dhe shëndeti në komunitetet Rome, Ashkali, dhe Egjiptase të Kosovës. Balkan Sunfloëers. 2016.

⁶⁹ Po aty.

krahasohet me mesataren për Kosovën, këto vlera janë rreth tri herë më të larta dhe përputhen me trendin e të dhënave administrative të popullatës së përgjithshme të një dekade më herët⁷⁰.

3.7. Banimi

Bazuar në legjislacionin në fuqi, ndihma institucionale në Republikën e Kosovës për çështje të banimit është e mbuluar për këto kategori të qytetarëve të saj:

1. Personat që mund të dëshmojnë se kanë në emër të tyre truall (parcele toke) në të cilën është e ndërtuar shtëpia e tyre, por shtëpia nuk i plotëson kushtet për banim adekuat;
2. Personat që mund të dëshmojnë se kanë truall (parcelë toke) në emër të tyre, por nuk kanë mundësi materiale që të ndërtojnë shtëpi;
3. Personat që mund të dëshmojnë se kanë të ndërtuar shtëpi, por trualli (parcele e tokës) nuk është në emër të tyre, dhe
4. Personat që mund të dëshmojnë se nuk kanë as truall (parcele toke) e as shtëpi në emër të tyre.

Format e ndihmës konkretizohen në Ligjin Nr. 03L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit⁷¹. Qëllimi i këtij ligji është krijimi i kushteve për banim të qëndrueshëm për familjet ose individët të cilët nuk janë në gjendje ekonomike t'i përballojnë ofertat e tregut të lirë të banesave si dhe caktimi i mënyrës së sigurimit dhe shfrytëzimit të mjeteve financiare për zhvillimin e programeve të veçanta të banimit. Ligji parasheh instrumentet institucionale dhe financiare për trajtimin e problemit të banimit, programet e banimit me qira joprofitabile dhe programet me bonus banimi, si dhe përcakton procedurën e sigurimit të banesës së përshtatshme për familjet që kanë nevojë, e cila udhëhiqet nga Komuna. Procedura përfshin: administrimin e kërkesave për banim social, përzgjedhjen e familjeve përfituese, analizën e instrumenteve dhe burimeve financiare të nevojshme (përfshirë tokën me infrastrukturë për ndërtimin e banesave me qira joprofitabile) sigurimin e banesës dhe mbikëqyrjen e procesit të shpërndarjes përmes menaxhimit të kontratave. Për zbatimin e ligjit komunat duhet të hartojnë programet 3 vjeçare komunale të banimit. Tabela e mëposhtme paraqet gjendjen e programeve trevjeçare të banimit në komuna.

Tabela 10. Gjendja e programeve trevjeçare të banimit në komuna

Nr.	Veprimet e kryera	Numri i komunave
1.	Vendimet për hartimin e programeve tre vjeçare të banimit nga Kryetarët të Komunave	20
2.	Formimi i Grupeve Punues në nivel Komunal (Komisione)	20
3.	Draftet/Hartimi i Programeve tre vjeçare të banimit në Komuna	15
4.	Miratimi i Programeve tre vjeçare të banimit në Kuvendin Komunal	9
5.	Themelimi i sektorit për fushën e banimit	4

Në bazë të të dhënave në dispozicion, Qeveria e Kosovës, e mbështetur nga agjenci dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare, me anë të programeve dhe projekteve të ndryshme, kanë arritur të ndërtojnë shtëpia dhe të sigurojnë banim për një numër të familjeve dhe pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali. Në bazë të dhënave të MKK, rezulton se prej vitit 2005 deri në vitin

⁷⁰ Komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptianë në Kosovë 2013-2014, Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë: Raporti përmbledhës. Agjencia e Statistikave të Kosovës. 2014.

⁷¹ http://mmpk-rks.org/repository/docs/Ligji_Nr._03L-164_per_Financimin_e_programeve_te_vecanta_te_banimit-shqip.pdf

2015, për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian ka ndërtuar 510 shtëpi⁷², ndërsa nga programi i ri integritit në fushën e ndërtimit apo rinovimit, i menaxhuar nga MPB, nga viti 2014 kanë përfituar 24 familje rome, ashkali dhe egjiptiane. MMPH ka ndërtuar 9 ndërtesa të banimit social ku janë të integruara edhe familjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Gjithashtu, është mbyllur qendra e përkohshme kolektive në Plemetin, ku 36 familje janë akomoduar në banim kolektiv, si dhe janë ndërtuar 9 shtëpi individuale dhe 12 shtëpi janë rindërtuar. Në Magurë janë ndërtuar banesat sociale me 22 njësi banimi për rom, ashkali dhe egjiptianë⁷³. Po ashtu, për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, Qeveria e Republikës së Kosovës ka zhvilluar programe të veçanta të cilat kanë rezultuar me mbylljen e kampeve: Çesmin Llug, Osterode, dhe Kampi në Leposaviq, duke përmbyllur nevojat për banim të familjeve dhe personave të zhvendosur nga kampet brenda Kosovës.

Në kuadër të Programit të Ri-integritit, MPB/ Departamenti për Ri-integritin e Personave të Riatdhesuar (DRPR), si financuese, në bashkëpunim me MMPH, si zbatuese për të kthyerit dhe të riatdhesuarit ofron skemat për rindërtim shtëpie, renovim shtëpie, mobilim, orendi shtëpiake, mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në Rregulloren QRK Nr. 04/2016 për Ri-integritin e Personave të Riatdhesuar dhe Menaxhimin e Programit të Ri integritit⁷⁴.

Bazuar në politikat e ri-integritit për rindërtim/renovim, nga skemat për renovim, orendi shtëpiake mund përfitojnë personat e riatdhesuar që dëshmojnë se objekti ku kanë jetuar më herët është plotësisht apo pjesërisht i shkatërruar, si dhe posedojnë dokumente që dëshmojnë pronësinë. Pas shqyrtimit të kërkesave, përmes Komisionit Qendror të Ri integritit në fushën e banimit, komunitetet rom dhe ashkali, janë përkrahur për rindërtimin e shtëpive, renovimin e shtëpive si dhe me orendi të shtëpive. Po ashtu, bazuar në këtë program, të gjithë personat e riatdhesuar të cilët nuk kanë banesë apo shtëpi, mund të përfitojnë nga skema e qirasë me kohëzgjatje 6 muaj dhe mundësi të vazhdimit edhe për 6 muaj tjetër. Pas përfitimit të mbështetjes nga skemat e ofruara nga MPB/DRPR, është detyrë e komunave të sigurojnë banimin e qëndrueshëm, përmes programeve trevjeçare të banimit.

Problem mjaft i shfaqur tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian është edhe mungesa e dokumentacionit pronësor për ata që kanë shtëpi të ndërtuara në parcelën e evidentuar në emër të shitësit të saj apo në emër të paraardhësit e tyre.

Banimi në vendbanime joformale është një ndër problemet kyçe për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali. Sipas përkufizimit, “vendbanime joformale janë vendbanime njerëzore, të cilat nuk u mundësojnë banorëve të gëzojnë të drejtat e tyre për një standard të jetesës, në veçanti në banim të përshtatshëm”. Numri i përgjithshëm i vendbanimeve joformale në Kosovë është 174⁷⁵, ndërsa 32 vendbanime joformale janë të populluara me pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

3.8. Çështje të ndërlidhura

3.8.1. Barazia gjinore

Çështja e barazisë gjinore është ndërsektoriale dhe duhet të trajtohet si e tillë, duke pasur parasysh që femrat nga komunitetet rom dhe ashkali ballafaqohen me probleme sociale dhe ekonomike, si

⁷² Intervista me drejtorin për menaxhimin e projekteve të ndërtimit z. Albert Zeqa MKK.

⁷³ Informatë nga MMPH.

⁷⁴ [http://ëëë.kryeministri-ks.net/repository/docs/Rregullore_\(QRK\)_nr_042016_per_riintegritin_e_personave_te_riatdhesuar.pdf](http://ëëë.kryeministri-ks.net/repository/docs/Rregullore_(QRK)_nr_042016_per_riintegritin_e_personave_te_riatdhesuar.pdf)

⁷⁵ Raporti i gjendjes së vendbanimeve jo formale në Kosovë.

<http://mmpH.rks-gov.net/repository/docs/Raporti-29.12.2010-QERSHOR.pdf>

dhe përjetojnë diskriminim të dyfishtë: si femra në përgjithësi dhe si femra pjesëtare të komuniteteve rom dhe ashkali në veçanti. Niveli i ulët i arsimimit luan rol kyç për përmirësimin e gjendjes së tyre në punësim, shëndetësi etj. Parametrat relevantë për fushën e arsimit të prezantuara në seksionin 3.5 të këtij dokumenti flasin qartë për pozitën e pafavorshme të femrave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në këtë fushë në raport me meshkujt e po këtyre komuniteteve. Për shembull, derisa 86.5% të meshkujve të moshës 15-24 nga të këtyre komuniteteve dinë lexim-shkrim, kjo vlen vetëm për 72.8% të femrave të po kësaj grup-moshe. Po ashtu, përfshirja e femrave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në tregun e punës është tejet e ulët.

Në fushën e shëndetësisë shihet një përmirësim. Lindjet e hershme kanë rënë gradualisht gjatë 10 viteve të fundit, posaçërisht në vendbanimet urbane. Përqindja e lindjeve të kryera në institucionet e shëndetit publik janë rom- 96.1 %, ashkalinj-97.8%.

Masat e kësaj Strategjie janë planifikuar në atë mënyrë që t'i adresojnë çështjet gjinore, duke arritur përmirësimin e barazisë gjinore në mesin e dy komuniteteve, në të gjitha fushat e veprimtimit të Strategjisë.

3.8.2. Siguria

Në bazë të evidencave statistikore si dhe raporteve që dalin nga Standardet e perceptimit të lëvizjes së lirë si dhe sigurisë për minoritetet dhe pakicat etnike për vitin 2014 vlerësohet si shumë pozitive, në veçanti, te komunitetet rom dhe ashkali. Për të avancuar edhe më tutje nivelin e sigurisë për këto komunitete, Policia e Kosovës është duke zbatuar strategji të ndryshme të cilat kanë të bëjnë me sigurinë në bashkësi, parandalim të krimit, policim në bashkësi, pjesëmarrje në forumet e sigurisë (KKSB, KLSP-ë dhe EVSB-ë) me ç' rast pjesë të zbatimit të këtyre strategjive janë komunitetet, në këtë rast edhe komunitetet rom dhe ashkali.

Po ashtu, përmes botimit dhe shpërndarjes së fletushkave, fletëpalosjeve, takimeve me qytetarë dhe në bashkëpunim të ngushtë me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë zhvillohen aktivitete që kanë për qëllim, parandalimin e krimit, vetëdijësimin qytetar për mbrojtje nga krimi, zgjidhjen e problemeve që ndërlidhen me krimin dhe frikën nga krimi.

Gjatë viteve 2014 dhe 2015 është shfaqur dukuria e migrimit në shtetet e zonës së BE-së të këtyre dy komuniteteve, por edhe të tjerëve, me ç' rast PK-ja, bashkë me përfaqësues të Ambasadës së Hungarisë, MPB-së, komunave, OJQ-ve dhe përfaqësuesve të komuniteteve rom dhe ashkali, kanë mbajtur takime në komuna me qëllim të shpjegimit të pasojave që mund t'i sjellë migrimi ilegal jashtë vendit.

3.8.3. Regjistrimi

Mos-regjistrimi civil i pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian⁷⁶ është një pengesë për qasje në arsim, punësim, mbrojtje sociale, shërbime shëndetësore dhe në banim. Sipas Ligjit për Skemat e Ndihmave Sociale, për tu kualifikuar për ndihmë sociale, të gjithë anëtarët e familjes aplikuese duhet të janë të pajisur me dokumente të Kosovës. Edhe pse nuk ka të dhëna të sakta për numrin e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve që nuk janë të regjistruar⁷⁷, sipas vlerësimeve nga studimi i vitit 2015 vlerësohet se rreth 600 pjesëtarë të këtyre komuniteteve nuk janë të

⁷⁶ OSBE, 2012, Kontribut për shqyrtimin e progresit të planit të veprimtimit të Strategjisë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë 2009–2015.

⁷⁷ Komisioni Evropian, Raporti i Progresit për Kosovën, 2015.

regjistruar⁷⁸, ndërsa studimi i ASK⁷⁹ ka gjetur se 20% e fëmijëve nuk posedojnë certifikatë të lindjes. Arsyet për mos-regjistrim janë të ndryshme, duke përfshirë procedurat për rastet kur fëmijët nuk lindin në spital, varfëria dhe analfabetizmi, mungesa e regjistrimeve nëpër gjenerata, mungesa e vetëdijesimit për obligimin për regjistrim dhe të drejtat/përfitimet nga regjistrimi si dhe jeta në banesa jo-formale⁸⁰. Mungesa e informacionit për procedurat për regjistrim duket të jetë një tjetër arsye për mos-regjistrimin e fëmijëve, ngase 40% e nënave të fëmijëve të paregjistruar kanë theksuar se nuk janë në dijeni për procedurat e regjistrimit të fëmijëve të porsalindur⁸¹.

Për të stimuluar regjistrimin duhet vazhduar me organizimin e fushatave informuese dhe vetëdijesuese për përparësitë e regjistrimit civil dhe pasojat nga mos-regjistrimi, të aplikohet lirimi nga pagesa për regjistrim dhe pajisja me dokumente identifikues si dhe të informohen qartë për kriteret që duhet plotësuar për regjistrim. Duke qenë se televizioni është burimi kryesor i informimit tek këto komunitete⁸² fushatat duhet shfaqur në televizion dhe duhet organizuar komunikime direkte me komunitetet e synuara. Po ashtu, OJQ-të që punojnë me gra duhet informuar gratë për përparësitë dhe procedurat e regjistrimit të fëmijëve të porsalindur. Për pjesëtarët e këtyre komuniteteve që nuk posedojnë dokumente identifikuese të periudhës së para vitit 1999, trajnimi i zyrtarëve në regjistrimin civil për zbatimin e drejtë dhe unik të ligjeve është me rëndësi të veçantë.

⁷⁸ Studimi i financuar nga UNHCR dhe i realizuar nga Agjencia e Regjistrimit Civil për të identifikuar personat e paregjistruar me fokus të veçantë për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Informata e dërguara nga UNHCR, Milanka Bazdar, Durable Solutions Associate, 23 shtator 2016.

⁷⁹ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës, Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë 2013-2014.

⁸⁰ Shënuar në Strategjinë për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2009-2015.

⁸¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës, Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë 2013-2014.

⁸² Qendra Kosovare për Studime Gjinore dhe Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptiane të Kosovës, Pozita e Grave të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptiane në Kosovë, 2008; Agjencia e Statistikave të Kosovës, Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptianë në Republikën e Kosovës, Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë 2013-2014.

4. Vizioni, misioni dhe parimet e Strategjisë

Vizioni i Qeverisë së Republikës së Kosovës është që *Kosova të jetë një shoqëri që siguron të drejtat e të gjitha komuniteteve dhe i përmbushë standardet më të larta të respektimit të të drejtave të njeriut, siç janë përcaktuar në konventa ndërkombëtare relevante, në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në legjislacionin e Republikës së Kosovës.*

Për ta arritur këtë vizion, Qeveria e Republikës së Kosovës merr për obligim të *promovojë dhe të sigurojë realizimin efektiv të të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali, në veçanti qasjen në arsim, punësim, shërbime shëndetësore dhe banim, me qëllim të përfshirjes së tyre të plotë në të gjitha aspektet e jetës shoqërore në Kosovë.* Ky është misioni i kësaj strategjie.

Qeveria e Republikës së Kosovës është e vetëdijshme për situatën në të cilën ndodhen komunitetet rom dhe ashkali dhe është e vendosur të bëj përpjekje të shtuara për të krijuar kushte sa më të përshtatshme për to, në mënyrë që ata të mund të gëzojnë të drejta të barabarta me të gjitha komunitetet e tjera etnike në Kosovë pa asnjë formë të diskriminimit.

Ky angazhim dëshmohet dhe konkretizohet nëpërmjet miratimit të Strategjisë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian 2009-2015 dhe Planit të saj të veprimit dhe vazhdimin me strategji të re - Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021 dhe Plani i veprimit për zbatimin e saj (në tekstin e mëtejme Strategjia dhe Plani i veprimit ose SPV). Si Strategjia e parë ashtu edhe kjo e dyta paraqesin masa afirmative që synojnë të zvogëlojnë dallimet sociale në të gjitha fushat, ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në njërin anë dhe komuniteteve të tjera etnike në anën tjetër.

Strategjia për përfshirjen e romëve dhe ashkalinjve është e bazuar në tri parime kryesore, të harmonizuara me Kornizën evropiane për strategjitë nacionale për Integrimin e romëve:

- Parimi i të drejtave të barabarta dhe mundësive të barabarta. Ky parim njihet nevojën që anëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali të kenë mundësi të barabarta në të gjitha fushat e shoqërisë, siç është rasti me popullatën shumicë.
- Parimi i mosdiskriminimit - bazuar në këtë parim të gjitha masat e ndërmarra sigurojnë që, në mënyrë të konsiderueshme, të zvogëlohet shkallën e diskriminimit ndaj komuniteteve rom dhe ashkali në të gjitha aspektet e jetës shoqërore.
- Parimi i eliminimit të dallimeve - një nga arsyt kryesore të përjashtimit social të romëve dhe ashkalinjve është fakti që ata në shumicën e rasteve jetojnë në vendbanime të ndara dhe të izoluar nga të tjerët. Kështu mekanizmat dhe faktorët socialë riprodhojnë marginalizimin dhe pengojnë masat e veprimit që synojnë përfshirjen sociale.

5. Alternativat e konsideruara

Përfshirja e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare është interes afatgjatë i pjesëtarëve të këtyre komuniteteve, por edhe i gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Përmes përfshirjes zvogëlohet hendeku ekzistues në mes të pjesëtarëve të komuniteteve dhe qytetarëve të tjerë në të gjitha fushat e jetës shoqërore, duke ndikuar drejtpërdrejt në zvogëlimin e varfërisë që dominon tek këto komunitete. Korniza e BE-së për strategjitë kombëtare për integrimin e romëve deri në vitin 2020⁸³ përcakton katër fushat kyçe në të cilat është përqendruar edhe Strategjia: arsimit, punësimi dhe mirëqenia sociale, shëndetësia dhe banimi. Meqë strategjia e kaluar që u zbatua gjatë periudhës 2009-2015 përfshinte 11 fusha, dilema e parë që lindi ishte nëse me fokusimin në vetëm 4 fusha i bëhet padrejtësi pjesëtarëve të komuniteteve. Megjithatë, pas analizës së gjendjes u konstatua se disa fusha janë të ndërlidhura, për shembull regjistrimi dhe barazia gjinore dhe mund të trajtohen, në formë të përshtatshme në kuadër të katër fushave të përcaktuara nga BE. E dyta, në disa fusha ka pasur avancim të ndjeshëm (shembull: siguria, mediat dhe informimi), prandaj trajtimi i tyre në kuadër të kësaj strategjie do të zhvendoste fokusin nga problemet më madhore me të cilat përballen e pjesëtarët e këtyre komuniteteve. E treta, problemet e komuniteteve rom dhe ashkali trajtohen edhe në kuadër të dokumenteve të tjera strategjike, duke i adresuar nevojat specifike të komuniteteve. Dhe, e katërta, aspiratat e Kosovës për integrim në BE imponojnë nevojën që politikat shtetërore t'i përshtaten përcaktimeve të BE, duke mundësuar krahasimin e rezultateve me vendet e tjera të BE.

Te objektivi strategjik 1 ("Arsimi") jemi nisur nga fakti se ekziston Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021 (PSAK), i cili, në një masë të konsiderueshme, adreson edhe nevojat specifike të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Kjo ka bërë që PSAK të jetë pikënisje për zhvillimin e zgjidhjeve specifike që i përgjigjen të tri komuniteteve në fushën e arsimit. Fokus i këtij objektivi mbetet përfshirje sa më të madhe të pjesëtarëve të komuniteteve në sistemin e arsimit që kërkon aktivitete specifike për rritjen e pjesëmarrjes, siç janë përfshirja më e madhe në edukimin parashkollor, dhënia e bursave për nxënës dhe studentë, e të tjera. Megjithatë, është konsideruar se një aspekt i rëndësishëm i pjesëmarrjes është ngritja e rezultateve të të nxënësve, pasi ndërprerja e shkollimit është, shpesh, pasojë e drejtpërdrejtë e mungesës së suksesit në mësim. Për këtë qëllim, është afirmuar modeli i qendrave mësimore, të cilat i shërbejnë pjesëtarët e komuniteteve. Nevoja për ekzistimin e këtyre qendrave do të pushojë me ngritjen e përgjithshme të nivelit arsimor dhe standardit jetësor të popullatës, por është vlerësuar se ato duhet të gëzojnë një mbështetje të veçantë, të paktën në pesëvjeçarin vijues. Me gjithë se dominon bindja se një numër i pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali nuk e vlerësojnë sa duhet rëndësinë e shkollimit, ne kemi konsideruar se veprimet tona duhet të orientohen kah vetëdijësimi i popullatës shumicë për të ndihmuar që pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali të shënojnë rezultate më të mira në fushën e arsimit, duke besuar se kështu arrihet një efekt më afatgjatë dhe më i qëndrueshëm.

Objektivi strategjik 2 ("Punësimi dhe mirëqenia sociale") synon përmirësimin e pozitës së komuniteteve rom dhe ashkali në fushën e punësimit dhe të mirëqenies sociale. Meqenëse MPMS ka strategji sektoriale për periudhën 2014-2020 ajo është marrë për bazë me rastin e hartimit të këtij dokumenti strategjik dhe kjo ka imponuar ndarjen e fushës në dy nënfusha të veçanta: punësimi dhe mirëqenia sociale. Në fushën e punësimit synohet që të përmirësohet punësimi i komuniteteve rom

⁸³ Korniza e BE-së për Strategjitë Kombëtare për Integrimin e Romëve deri në vitin 2020, Bruksel, 05.04.2011, COM(2011) 173. http://ec.europa.eu/justice/policies/discrimination/docs/com_2011_173_en.pdf

dhe ashkali në institucione publike dhe në ndërmarrje publike, pasi shteti ka në dispozicion instrumente ligjore për ta bërë një gjë të tillë. Ndërkaq, pas diskutimeve kësaj i janë shtuar edhe masat aktive të tregut të punës që nënkuptojnë stimulimin e sektorit privat për të punësuar pjesëtarë të komuniteteve rom dhe ashkali, megjithëse masat e tilla nuk kanë dhënë gjithnjë rezultate të mira në vendet tjera, në kuptim të qëndrueshmërisë së punësimit. Gjithsesi, është arritur në përfundim se kuotat duhet të jenë të pranishme në rastin e MATP, duke përfshirë sa më shumë pjesëtarë të komuniteteve rom dhe ashkali në programe të aftësisë profesionale. Sa i përket mirëqenie sociale, mendohet se duhet të punohet më shumë në informimin e pjesëtarëve të komuniteteve për të drejtën e përfshirjes së tyre në skemat e mirëqenies sociale, por edhe se këto masa duhet të shoqërohen me ofrim të mundësive për aftësim profesional dhe përfshirje në MATP. Për shkak të situatës specifike të komuniteteve rom dhe ashkali, identifikimi i fëmijëve me nevoja të veçanta ka mbetur si detyrë primare e shërbimit të mirëqenies sociale. Po ashtu, janë shqyrtuar lloje të shërbimeve sociale që nuk ekzistojnë në sistemin tonë dhe është rekomanduar të punohet drejt zhvillimit të shërbimeve të reja, duke i deleguar disa prej tyre te organizatat e shoqërisë civile.

Pikënisja për planifikimin strategjik në fushën e shëndetësisë (Objektivi 3) ka qenë ekzistimi i dallimeve thelbësore në parametra shëndetësorë në mes të komuniteteve rom dhe ashkali nga njëra anë dhe popullatës shumicë nga ana tjetër. Për shembull, vetëm 30.2% të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian të moshës 24-35 muaj i kanë marrë të gjitha vaksinat e rekomanduara brenda orarit të vaksinimit, ndërsa në nivel të popullsisë së Kosovës kjo vlen për 78% të fëmijëve⁸⁴. Kjo ka bërë që një pjesë e madhe e Strategjisë t'i kushtohet edukimit dhe vetëdijesimit, ndërsa më pak cilësisë së shërbimeve, pasi kjo e fundit paraqet problem në gjithë sistemin shëndetësor të Kosovës. Po ashtu, kujdes i veçantë i është kushtuar përmirësimit të qasjes në shërbime shëndetësore, sidomos për qëllime preventive.

Banimi (Objektivi 4) vazhdon të mbetet problem i madh i komuniteteve rom dhe ashkali, për të cilin nuk ka zgjidhje të lehtë dhe të shpejtë. Gjatë procesit të hartimit të Strategjisë janë analizuar modele të ndryshme për zgjidhjen e problemit të banimit, përfshirë banimin social dhe akomodimin me qira në bazë të bonuseve. Është arritur në përfundim se duhet të punohet në evidentimin gjithëpërfshirës të nevojave të pjesëtarëve të komuniteteve për ndihmë në fushën e banimit që do të realizohet përmes bazës së të dhënave të MMPH që është në zhvillim e sipër. Pastaj, duhet vazhduar me trajtimin e vendbanimeve joformale, si dhe sigurimin e banimit, në kuadër të mundësive buxhetore dhe gatishmërisë së donatorëve për të ndihmuar në këtë fushë. Po ashtu, rëndësi do t'i kushtohet rregullimit të dokumentacionit pronësor, i cili shpesh paraqitet si pengesë për të ofruar ndihmë me banim, edhe në ato raste kur ka mundësi.

⁸⁴ Multiple Indicator Cluster Survey 2013-2014. UNICEF. 2016

6. Objektivat strategjike

Për secilën nga katër fushat e strategjisë është definuar një objektivi strategjik. Në vijim secili objektivi strategjik është zbërthyer në rezultate, ndërsa rezultatet në aktivitete. Tabela e mëposhtme jep një pasqyrë të objektivave strategjike dhe rezultateve të ndërlidhura sipas katër fushave:

- **Objektivi strategjik 1: Rritja e përfshirjes dhe ofrimi i mundësive për zhvillim, aftësim dhe arsimim cilësor për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe Ashkali**
- **Objektivi strategjik 2 Përmirësimi i situatës ekonomike dhe sociale të komuniteteve rom dhe Ashkali**
- **Objektivi strategjik 3 - Përmirësimi i gjendjes shëndetësore edhe cilësisë së jetës për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe Ashkali**
- **Objektivi 4 – Sigurimi i banimit të qëndrueshëm për komunitetet Rom dhe Ashkali në përputhje me legjislacionin në fuqi**

Fusha	Objektivi strategjik	Aktivitetet	Rezultatet e pritshme
Arsimi	Rritja e përfshirjes dhe ofrimi i mundësive për zhvillim, aftësim dhe arsimim cilësor për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali	<ul style="list-style-type: none"> • Stimulimi i vijimit të edukimit parashkollor. • Hartimi i planeve të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe të mosregjistrimit në të gjitha komunat. • Masa stimuluese për lehtësimin e regjistrimit dhe vijimit të fëmijëve rom dhe ashkali në arsimin e mesëm të lartë. • Hartimi i planeve individuale për nxënësit e ri-atdhesuar rom dhe ashkali. • Zhvillimi i masave të veçanta pozitive dhe i programeve përgatitore për regjistrimin dhe mbajtjen e studentëve në IAL nga radhët e komuniteteve rom dhe ashkali. • Mbështetja e programeve për arsimimin e të rriturve. • Përcaktimi i treguesve të ndjeshëm gjinor për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali për SMIA. • Eliminimi i segregacionit dhe diskriminimit ndaj fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali. • Mbështetja e qendrave mësimore me bazë në komunitet. • Ofrimi i mësimin plotësues për nxënësit që ngecin në mësim. • Promovimi i mësimin të gjuhës rome. • Zhvillimi i programeve për vetëdijësimin e prindërve lidhur me fëmijërinë e hershme. • Organizimi i aktiviteteve për vetëdijësimin e komuniteteve rom dhe ashkali për rëndësinë e regjistrimit me kohë dhe vijimin e shkollimit, me fokus të veçantë tek vajzat. 	<ul style="list-style-type: none"> • Përmirësohet pjesëmarrja në arsimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali. • Përmirësohet performanca e nxënësve dhe studentëve të komuniteteve rom dhe ashkali. • Ndërgjegjësohen palët e interesit për të ndihmuar arsimimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali.

Punësimi dhe mirëqenia sociale	Përmirësimi i situatës ekonomike dhe sociale të komuniteteve rom dhe ashkali	<ul style="list-style-type: none"> • Vetëdijesimi i popullatës për arsimimin e komuniteteve rom dhe ashkali. • Hulumtimi, përcaktimi i treguesve të ndjeshëm gjinor dhe raportimi mbi gjendjen e tregut të punës të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali dhe mbi përfitimin e tyre nga shërbimet/masat e ofruara nga MPMS. • Përmirësimi i përfaqësimit të komuniteteve rom dhe ashkali në punësimin në institucione publike dhe ndërmarrje publike. • Hulumtimi dhe zbatimi i masave të aksionit afirmativ për punësimin e komuniteteve rom dhe ashkali. • Vlerësimi i nevojave dhe i efektivitetit të shërbimeve të punësimin dhe MATP. • Dizajnimi/modifikimi i shërbimeve (shitesë) të punësimin dhe MATP, përfshirë trajnimet profesionale, në përputhje me nevojat komuniteteve rom dhe ashkali. • Organizimi i fushatave të informimit për shërbimet e punësimin dhe MATP, përfshirë trajnimet profesionale. • Promovimi i rasteve të suksesit në tregun e punës të pjesëtarëve të komuniteteve rom, dhe ashkali. • Vlerësimi i mbështetjes shitesë për përfituesit e ndihmave sociale. • Identifikimi i fëmijëve dhe personave me nevoja të veçanta. • Fushata informative për skemat e mbrojtjes dhe shërbime sociale. • Analiza e cilësisë së shërbimeve sociale dhe identifikimi i shërbimeve të reja sociale. • Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve komunalë për përmirësimin e shërbimeve sociale. 	<ul style="list-style-type: none"> • Përmirësohet niveli i punësimin të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali. • Përmirësohet pjesëmarrja e familjeve të komuniteteve rom dhe ashkali në skemat e mbrojtjes dhe në shërbime sociale.
Shëndetësia	Përmirësimi i gjendjes shëndetësore dhe cilësisë së jetës tek pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali	<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i aktiviteteve për skreningun e kancerit të gjirit. • Realizimi i vizitave shtëpiake për nëna dhe fëmijë si dhe grupe të tjera të ndjeshme. • Aktivitetet që arrijnë popullatën vulnerable. • Masat institucionale që përmirësojnë qasjen në shërbime shëndetësore. • Monitorimi i vazhdueshëm i qasjes në shërbimet e kujdesit shëndetësor. • Fushatat për imunizim. • Shpërndarja e materialit informues për planifikim familjar dhe shëndet riprodhues. • Edukimi për rëndësinë e kushteve higjienë-sanitare. • Avancimi i kapaciteteve preventive të stafit në kujdesin parësor. • Kontrolli periodik i nivelit të plumbit në vendbanimet e komuniteteve. • Pajisja me kontejnerë familjarë për mbeturina. 	<ul style="list-style-type: none"> • Përmirësohet qasja në shërbime shëndetësore për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali. • Përmirësohet sjellja dhe praktikat shëndetësore tek pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali. • Sigurohet një mjedis i shëndetshëm për popullsinë e komuniteteve rom dhe ashkali.
Banimi	Sigurimi i banimit adekuat të	<ul style="list-style-type: none"> • Përfshirja e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në bazën e të dhënave për financimin e programeve të veçanta të banimit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Janë identifikuar nevojat e pjesëtarëve të komuniteteve për banim adekuat dhe banim social.

	<p>qëndrueshëm për komunitetet rom dhe ashkali në përputhje me legjislacionin në fuqi</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Caktimi i prioriteteve për familjet në nevojë për përfshirjen në programin e banimit social. • Organizimi i fushatës së vetëdijesimit për përfshirje në çështjen e banimit. • Mbështetja e komuniteteve rom dhe ashkali për pajisje me dokumentacion përkatës pronësor apo një të drejtë tjetër të tokës në të cilën mund të ndërtohet. • Hartimi i projekteve prioritare për renovim, rindërtim apo ndërtim të shtëpisë në parcelat vetanake. • Implementimi i programeve për trajtimin e vendbanimeve joformale. • Identifikimi i pronave për banim social. • Hartimi i projekteve prioritare për banim social. 	<ul style="list-style-type: none"> • Është shtuar ndërgjegjësimi i pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali për pjesëmarrje aktive në zgjidhjen e problemeve të banimit. • Avancim i ndjeshëm drejt zgjidhjes së problemit të banimit për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali.
--	---	---	---

6.1. Arsimi

Me gjithë faktin se nuk është rrugëdalja më e shpejtë nga varfëria, arsimi është faktori më i rëndësishëm dhe më i qëndrueshëm për parandalimin e varfërisë dhe integrimin në shoqëri. Është mirë e njohur se personat e paarsimuar, ose që fillojnë vonë arsimimin e tyre, ose që e braktisin herët arsimin, kanë vështirësi në punësim dhe, në përgjithësi, mundësitë e tyre në jetë janë më të kufizuara. Programet për arsimimin e të rriturve mund ta kompensojnë deri në një masë mungesën e arsimit formal, por ato nuk duhet të jenë alternativa e parë për të siguruar arsimimin e një komuniteti.

Plani Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2021 përfshin një varg masash që kanë të bëjnë me arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, por edhe të grupeve të tjera të margjinalizuara. Disa nga ato masa janë dhënë më poshtë, në formë të përshtatur, ndërsa disa masa tjera janë specifike për këtë Strategji.

Sfidat

Pjesëmarrja në sistemin e arsimit

Pjesëmarrja e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sistemin e arsimit ka shënuar përparim të dukshëm në 17 vitet e fundit, në veçanti si rezultat i zbatimit të Strategjisë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian 2009-2015. Kjo, sidomos, vërehet në arsimin fillor (klasat 1-5) ku pjesëmarrja ka tejkaluar 85%⁸⁵. Megjithatë, dallimi me mesataren e Kosovës është ende i dukshëm, ndërsa pjesëmarrja shkon duke u zvogëluar në mënyrë rapide në nivelet më të larta të sistemit të arsimit. Kështu, në arsimin e mesëm të ulët marrin pjesë vetëm 65%⁸⁶ të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian të grup-moshës 11-14, ndërsa në arsimin e mesëm të lartë zvogëlohet në 30.3%⁸⁷. Të dhënat flasin për një përfaqësim të barabartë të vajzave në nivelin fillor, por gjendja shkon duke u përkeqësuar në nivelet më të larta të sistemit të arsimit. Për fat të keq, të dhëna plotësisht të sakta për arsimin e lartë nuk ka edhe pse vërehet një rritje e vazhdueshme e numrit të studentëve nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Shkaqet e pjesëmarrjes së ulët dallojnë sipas niveleve. Në edukimin parashkollor mundësitë janë të kufizuara, pasi vijimi në institucione parashkollore të specializuara ka kosto, ndërkohë që numri i qendrave me bazë në komunitet është i kufizuar dhe nuk kanë mbështetje institucionale. Edukimi parafillor ofrohet falas, në shkolla publike, por, përsëri shkalla e regjistrimit e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është më e ulët sesa në nivel të Kosovës, e që mund të jetë çështje e vetëdijesimit. Ndërkaq, zvogëlimi i pjesëmarrjes në arsimin e mesëm të ulët, e sidomos në arsimin e mesëm të lartë, mund të lidhet me faktorët ekonomikë, pikërisht me pamundësinë e familjeve që t'i mbulojnë shpenzimet e ndërlidhura me shkollimin e fëmijëve të tyre, duke hequr dorë nga të ardhurat që ata mund t'i sjellin familjes në këtë periudhë të jetës së tyre. Numër i madh i familjeve rom dhe ashkalinje që kanë emigruar jashtë vendit, sidomos gjatë viteve 2014 dhe 2015. Disa fëmijë rom dhe ashkali nuk regjistrohen ose e braktisin shkollën sepse familjet e tyre migrojnë gjatë vitit shkollor, apo largohen nga vendi dhe, pas kthimit, është e vështirë t'i rikthehen arsimit. Ndonjëherë, arsye për këtë është mungesa e dokumenteve nga shkollat në vendet evropiane, si dhe vështirësitë me njohjen e tyre.

⁸⁵ Anketa e grupimeve të treguesve të shumëfishitë 2013-2014 – Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian (MICS), Raporti final, ASK, Prishtinë 2014, f. VII. <https://ask.rks-gov.net/images/files/Komunitetet%20Rome,%20Ashkali%20dhe%20Egjiptiane%20ne%20Kosove.pdf>

⁸⁶ Po aty.

⁸⁷ Po aty.

Cilësia e rezultateve të të nxënit

Përqendrimi në rritjen e përfshirjes nuk është shoqëruar gjithnjë edhe me aktivitete që ndikojnë në ngritjen e cilësisë së rezultateve të të nxënit. Megjithëse nuk ka të dhëna të sakta, fëmijët e komuniteteve rom dhe ashkali tregojnë performancë më të dobët në shkollë sesa mesatarja. Përfshirja e pamjaftueshme në edukimin parashkollor është një nga shkaqet, pasi në këtë fazë fitohen shkathtësitë e para-leximit dhe të para-numeracionit që janë me rëndësi për fillim të mbarë të shkollimit të obligueshëm. Shkak tjetër është niveli arsimor i familjeve që nuk krijon një mjedis të përshtatshëm për të nxënë në shtëpi. Ndërkaq, tek fëmijët romë, shpesh, paraqitet problemi i mosnjohjes së gjuhës së shkollimit në masë të mjaftueshme për të treguar performancë të mirë. Performanca e dobët në shkollë ndikon në mënyrë dekurajuese tek fëmijët dhe, shpesh, i demotivon ata për vazhdimin e shkollimit.

Ndërgjegjësimi për rëndësinë e shkollimit

Në kohën e sotme nuk mund të thuhet se pjesëtarët e ndonjë grupi shoqëror nuk janë të ndërgjegjshëm për rëndësinë që ka arsimi për fëmijët e tyre. Një shkallë e lartë e ndërgjegjësimit vërehet edhe tek pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali, të cilët bëjnë përpjekje që fëmijët e tyre të vijojnë shkollën, me gjithë faktin se janë shpesh të demotivuar për shkak se ata që mbarojnë shkollën përsëri mbeten të papunë. Mungesë informacioni, pra edhe ndërgjegjësimi, mund të ketë për rëndësinë e nivelit parashkollor, por jo edhe për nivelet e tjera. Ndërkaq, shpesh mungon ndërgjegjësimi i shumicës për rëndësinë shoqërore të shkollimit të grupeve të marginalizuara. Përveç që, me shkollim, romët dhe ashkalinjtë realizojnë një të drejtë të tyre elementare, ata i krijojnë kushtet për t'u shkëputur nga varfëria dhe për të kontribuar në zhvillimin shoqëror. Për këtë arsye është e domosdoshme që autoritetet qendrore dhe lokale, si dhe shkollat dhe komuniteti shumicë të sensibilizohen për t'i ndihmuar këto komunitete në ngritjen e nivelit arsimor të tyre.

Objektivi

Rritja e përfshirjes dhe ofrimi i mundësive për zhvillim, aftësim dhe arsimim cilësor për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali

Zbatimi i politikave dhe praktikave shkollore që synojnë procese gjithëpërfshirëse është parakusht që mundëson rritjen e përfshirjes dhe parandalimin e braktisjes së shkollës nga fëmijët. Rritja e përfshirjes dhe parandalimi i braktisjes në arsim merr kohë dhe nuk mund të arrihet pa zbatim të plotë të kornizës ligjore. Po ashtu, kjo është çështje komplekse dhe kërkon mobilizimin e shkollave, si dhe të nivelit lokal e atij qendror. Ndërkaq, ofrimi i mundësive për realizimin e potencialit për pjesëtarët e dy komuniteteve të synuara është elementi kryesor i këtij objekti. Të gjithë qytetarët kanë të drejtë në arsimim cilësor dhe është obligim i shtetit t'ua ofrojë një arsimim të tillë. Tek grupet e marginalizuara kjo është e një rëndësie të veçantë sepse krijon mundësi të reja për zhvillim personal dhe punësim.

Rezultatet e pritshme:

- 1.1. Përmirësohet pjesëmarrja në arsim e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali;
- 1.2. Përmirësohet performanca e nxënësve dhe studentëve të komuniteteve rom dhe ashkali;
- 1.3. Ndërgjegjësohen palët e interesit për të ndihmuar arsimimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali.

Aktivitetet

Rezultati 1.1: Përmirësohet pjesëmarrja në arsim e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali

1.1.1. Aktiviteti: Stimulimi i vijimit të edukimit parashkollor.

Mbështetja e programeve parashkollore me bazë në komunitet dhe subvencionimi i pagesave për regjistrim në institucione parashkollore publike për fëmijët rom dhe ashkali janë dy masa që ndihmojnë vijimin e edukimit parashkollor. Sipas nevojës, duhet hapur klasa parafillore në shkollat ku gravitojnë fëmijët e komuniteteve rom dhe ashkali, në mënyrë që të zhvillohen përgatitjet e duhura për përfshirjen e tyre në arsimin e obligueshëm. Sa herë që është e përshtatshme duhet kërkuar mundësi për përfshirjen e edukatorëve rom dhe ashkali që do ta lehtësonin punën me fëmijë të këtyre komuniteteve.

1.1.2. Aktiviteti: Hartimi i planeve të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe të mosregjistrimit në të gjitha komunat.

Shkollat, në bashkëpunim me komunat dhe OSHC-të, si dhe me pjesëmarrjen aktive të komuniteteve përfituese, duhet të hartojnë plane të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe të mosregjistrimit për fëmijët e komuniteteve rom dhe ashkali. Këto plane duhet të përfshinë aktivitete të veçanta të ekipeve shkollore për parandalimin e braktisjes që janë themeluar në të gjitha shkollat, e që nënkupton edhe bashkëpunimin e afërt me përfaqësuesit e komunitetit, por edhe me organet shtetërore. Një aspekt i veçantë i këtyre planeve duhet të jetë integrimi i fëmijëve të kthyer nga vendet evropiane, përmes organizimit të mësimin intensiv dhe formave të tjera të mbështetjes. Një bashkëpunim i tillë duhet të ekzistojë edhe me rastin e regjistrimit të fëmijëve në arsimin e detyrueshëm, duke mos lejuar që fëmijët e moshës shkollore të mbeten në shtëpi.

1.1.3. Aktiviteti: Masa stimuluese për lehtësimin e regjistrimit dhe vijimit të fëmijëve rom dhe ashkali në arsimin e mesëm të lartë.

Fëmijët e komuniteteve rom dhe ashkali duhet të ndihmohen me rastin e regjistrimit në arsimin e mesëm të lartë, si përmes këshillimit dhe orientimit në karrierë, ashtu edhe përmes bursave që ua bëjnë të mundur vijimin e shkollimit. Një program i veçantë i bursave do të institucionalizohet në nivel shtetëror duke synuar dhënien e 600 bursave brenda një viti shkollor, por edhe komunave do t'u sugjerohet që të japin bursa për nxënësit e shkollave të mesme nga këto dy komunitete.

1.1.4. Aktiviteti: Hartimi i planeve individuale për nxënësit e ri-atdhesuar rom dhe ashkali.

Nxënësit e ri-atdhesuar, sapo të përfshihen në sistem arsimor, duhet të kenë plane individuale për t'u integruar sa më shpejtë dhe më lehtë në procesin mësimor. Këto plane duhet të hartohen nga shkollat, në bashkëpunim me prindërit dhe shërbimet e tjera sociale, duke pasur parasysh nevojat specifike të nxënësve rom dhe ashkali.

1.1.5. Aktiviteti: Zhvillimi i masave të veçanta pozitive dhe i programeve përgatitore për regjistrimin dhe mbajtjen e studentëve në IAL nga radhët e komuniteteve rom dhe ashkali.

Me qëllim të pranimit të studentëve të kategorive të cënueshme sociale në IAL do të mbështetet zhvillimi i programeve të veçanta përgatitore. Shembuj praktikë të masave të tilla janë sigurimi i kurseve intensive për kandidatët nga komunitetet për t'i përgatitur ata për provimin pranues dhe një politikë e vendeve të rezervuara në IAL derisa të arrihet pjesëmarrja e barabartë. Njëlloj, programet për mbështetjen e studentëve duhet të zhvillohen për t'i

mbajtur në arsimin e lartë studentët nga komunitetet dhe grupet e marginalizuara përmes programeve të mentorimit, sigurimit të transportit dhe konvikteve. Mbështetje shtesë për studentët duhet të ofrohet përmes programit të bursave për arsimin e lartë.

1.1.6. Aktiviteti: Mbështetja e programeve për arsimimin e të rriturve.

Personat e rritur nga radhët e komuniteteve rom dhe ashkali do të mund të regjistrohen në programe të veçanta për përfundimin e arsimit formal, përfshirë edhe arsimin profesional (në bazë të hulumtimit të nevojave), si dhe në programet e përsheptuara. Në bashkëpunim me përfaqësuesit e komunave dhe organizatat joqeveritare do të organizohen fushata informimi, duke shpjeguar mundësitë që ofrojnë këto programe. Po ashtu, do të mbështetet realizimi i programeve të aftësisimit për lexim-shkrim, në veçanti për prindërit që kanë fëmijë në shkollë.

Rezultati 1.2: Përmirësohet performanca e nxënësve dhe studentëve të komuniteteve rom dhe ashkali

1.2.1. Aktiviteti: Përcaktimi i treguesve të ndjeshëm gjinor për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali për SMIA.

MASHT duhet t'i definojë treguesit që japin të dhëna për regjistrimin dhe performancën e fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali në arsimin parauniversitar. Nga SMIA duhet të dalin informata të qarta mbi shkallën e regjistrimit të secilit nga këto komunitete dhe për performancën e tyre në testet kombëtare, në raport me mesataren e vendit dhe komunën përkatëse.

1.2.2. Aktiviteti: Eliminimi i segregacionit dhe diskriminimit ndaj fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali.

Rastet e segregacionit dhe të diskriminimit ndaj fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali nuk janë të rralla dhe kanë ndikim negativ në performancën e nxënësve nga këto komunitete. Të gjitha rastet e tilla do të adresohen në përputhje me ligjin, duke marrë masa adekuate ndaj shkelësve. MASHT do të zhvillojë udhëzime pedagogjike për shmangien e rasteve të segregacionit dhe të diskriminimit, duke ua shpërndarë ato komunave dhe shkollave.

Edhe pse një numër i konsiderueshëm i mësimdhënësve ka kaluar nëpër programe të ndryshme të trajnimit për gjithëpërfshirje, drejtësi shoqërore, diversitet etnik, kulturor, fetar, gjuhësor, etj. kjo nuk mjafton që shkollat të kenë qasje gjithëpërfshirëse. Prandaj, që shkollat të jenë të hapura dhe të trajtojnë secilin nxënës në mënyrë të barabartë, duhet që çdo mësimdhënës të ketë njohuri dhe shkathtësi për të siguruar përfshirjen e të gjithë nxënësve në procesin e të mësuarit. Kjo veçanërisht vlen për shkollat ku mësimin vijojnë nxënësit e komuniteteve rom dhe ashkali.

1.2.3. Aktiviteti: Mbështetja e qendrave mësimore me bazë në komunitet.

Për momentin, në Kosovë operojnë 40 qendra mësimore me bazë në komunitet që i shërbejnë pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Përmes aktiviteteve specifike këto qendra kanë pasur ndikim pozitiv në përmirësimin e performancës së fëmijëve të këtyre komuniteteve dhe në inkurajimin e tyre për të vazhduar shkollimin. MASHT-i dhe komunat do të ofrojnë mbështetje për këto qendra në forma të ndryshme, qoftë në formë të përkrahjes financiare përmes OJQ-ve që përkujdesen për to, ose përmes ofrimit të hapësirave për punë në objekte publike, sidomos në shkolla. Po ashtu, MASHT do të punojë drejt zhvillimit të bazës

juridike për institucionalizimin e këtyre qendrave që nënkupton: zhvillimin e standardeve minimale për veprimin e tyre, të kurrikulës dhe të stafit që angazhohet në ato qendra.

1.2.4. Aktiviteti: Ofrimi i mësimit plotësues për nxënësit që ngecin në mësim.

Në shkollat ku vijojnë mësimin fëmijët rom dhe ashkali do të organizohet mësim plotësues për t'u ndihmuar nxënësve që ngecin në mësim. Po ashtu, do të ishte e dëshirueshme të organizohet mentorim për fëmijët e komuniteteve rom dhe ashkali.

1.2.5. Aktiviteti: Promovimi i mësimit të gjuhës rome.

Është e drejtë kushtetuese e fëmijëve të komunitetit rom që të aftësohen për përdorimin e gjuhës dhe alfabetit të tyre. Për këtë qëllim, do të ofrohet mësimi plotësues i gjuhës rome në të gjitha mjediset ku ekziston interesimi, sipas plan-programit dhe teksteve mësimore tanimë të aprovuara nga MASHT. Nëse numri i nxënësve rom në një shkollë është i vogël, do të bëhen përpjekje për organizimin e mësimit të gjuhës rome në nivel të grupit të shkollave ose të komunës. Po ashtu, do të organizohen trajnime për mësime të gjuhës rome.

Rezultati 1.3: Ndërgjegjësohen palët e interesit për të ndihmuar arsimimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali

1.3.1. Aktiviteti: Zhvillimi i programeve për vetëdijesimin e prindërve lidhur me fëmijërinë e hershme.

Në shumë raste prindërit duhen edukuar për të kuptuar rëndësinë e zhvillimit në fëmijërinë e hershme. Kjo do të realizohet në zonat ku jetojnë pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali, me qëllim të nxitjes për t'i regjistruar fëmijët në edukimin parashkollor, në veçanti atë parafillor.

1.3.2. Aktiviteti: Organizimi i aktiviteteve për vetëdijesimin e komuniteteve rom dhe ashkali për rëndësinë e regjistrimit me kohë dhe vijimin e shkollimit, me fokus të veçantë tek vajzat.

DKA-të, në bashkëpunim me organizatat joqeveritare, duhet të njoftojnë prindërit për rëndësinë e regjistrimit dhe vijimit të shkollimit. Aktivitetet duhet të pasqyrojnë saktë nevojat, shqetësimet dhe sfidat e ndryshme me të cilat përballen djemtë dhe vajzat e që ndikojnë në regjistrimin dhe vijimin e shkollës, dhe nëse vajzat ballafaqohen me ndonjë pengesë të posaçme përkitazi me regjistrimin fillestar.

1.3.3. Aktiviteti: Vetëdijesimi i popullatës për arsimimin e komuniteteve rom dhe ashkali.

Fushatat avokuese, debatet, klipet në TV janë disa forma për të sensibilizuar publikun e gjerë që ta mbështesë arsimimin e komuniteteve rom dhe ashkali. Këto aktivitete zhvillohen nga institucionet shtetërore, si dhe OSHC-të.

Çështje të ndërlidhura

Rritja e pjesëmarrjes në arsim dhe përmirësimi i performancës së nxënësve të komuniteteve rom dhe ashkali lidhet ngushtë me arritjet në tri fushat tjera të kësaj Strategjie. Kështu, gjendja ekonomike në familje është faktor që ka ndikim të konsiderueshëm në marrjen e vendimeve për vazhdimin e shkollimit, dhe, pa dyshim, ndikon edhe në performancën e nxënësit. Ndikim në performancë kanë edhe kushtet e banimit, por edhe gjendja shëndetësore e vet nxënësit dhe e familjarëve të tij/saj. Nga ana tjetër, arsimimi më i mirë dhe më cilësor ndikon në shtimin e mundësive për punësim dhe zgjidhjen e problemit të banimit, si edhe në shkallë më të lartë të vetëdijesimit për përkujdesje shëndetësore.

Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e objektivit të lartshënuar janë:

- Shkollat hartojnë dhe ofrojnë programe për përkrahje të nxënësve të cilët kanë ngecje në mësim.
- Shkollat hartojnë plane për përfshirjen e nxënësve të ri-atdhesuar.

Ndërkaq, faktorët që vënë në pyetje suksesin e jetësimit të asaj që është planifikuar janë:

- Qendrat mësimore rrezikohen të mbyllen për shkak të mos sigurimit të qëndrueshmërisë.
- Mungesa e gatishmërisë së komunave për lehtësimin e kushteve të regjistrimit dhe vijimit të fëmijëve rom dhe ashkali në nivelin parashkollor dhe të mesëm.
- Mosangazhimi i ekipeve në nivel shkolle dhe komune për të parandaluar braktisjen.
- Dështimi për të mbledhur në mënyrë sistematike të dhënat e ndara sipas përkatësisë etnike dhe për të mbështetur përdorimin e tyre në arritjen e objektivave të përcaktuara.

6.2. Punësimi dhe mirëqenia sociale

Qasja në punësim, skemat e mbrojtjes sociale dhe shërbimet sociale kontribuojnë në përmirësimin e mirëqenies ekonomike dhe sociale të individit dhe komunitetit. Aktualisht, niveli i punësimit i komuniteteve rom dhe ashkali është shumë i ulët (edhe në krahasim me komunitetet tjera), ndërsa përfshirja në skema e shërbimeve sociale mbetet e kufizuar. Qasja e këtyre komuniteteve në punësim, në shërbime të punësimit, në mundësi për zhvillim profesional, dhe në skemat e shërbimeve sociale duhet përmirësuar, si dhe duhet siguruar që këto të reflektojnë nevojat specifike të këtyre dy komuniteteve të synuara. Aktivizimi në treg të punës dhe krijimi i mundësive të reja për zhvillim profesional, dhe jo varësia nga skemat e ndihmave sociale, mbeten synim kryesor në drejtim të përmirësimit të mirëqenies ekonomike dhe sociale të këtyre komuniteteve.

Sfidat

Niveli i punësimit dhe qëndrueshmëria dhe cilësia e punës

Gjendja e punësimit të komuniteteve rom dhe ashkali është më e vështirë në krahasim me komunitetet tjera. Vendet e punës në të cilat janë të angazhuar janë shpesh të përkohshme, të shumtën fizike, që nuk kërkojnë shkathtësi të larta dhe nuk paguhen mirë⁸⁸. Këto komunitete janë të nën përfaqësuara edhe në punësimin në institucione publike⁸⁹.

Disa prej shkaqeve për gjendjen e punësimit janë specifike për këto komunitete ose i prekin këto komunitete më shumë se të tjerët: niveli mesatarisht më i ulët i shkollimit/shkathtësive tek këto komunitete (megjithëse kjo për përmirësohet), diskriminimi në treg të punës dhe qasja më të ulët në lidhje/rrjete joformale që do të ju mundësonin punësimin⁹⁰. Situata në tregun e punës është edhe më e rëndë për gratë e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, vetëm 9 për qind e të cilave janë të punësuar⁹¹. Shkaqet për dallimet gjinore janë të ndërlidhura në mes vete dhe përfshijnë martesat e hershme, nivelin më të ulët të shkollimit (në krahasim me meshkujt), dhe stereotipet gjinore ku gruaja konsiderohet si përgjegjëse për kujdesin ndaj shtëpisë dhe familjes⁹². Në sektorin publik, mos-respektimi i përfaqësimit proporcional në nivel komunal dhe kuota e përgjithshme për të gjitha komunitetet jo shumice (dhe jo për secilin komunitet veç e veç) shkojnë në dëm të komuniteteve rom dhe ashkali. Raportohet se ka edhe raste kur pjesëtarët e komunitetit shqiptar vetë-raportohen si pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë për të përfituar nga masat e aksionit afirmativ (në punësim dhe në MATP).⁹³

⁸⁸ Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS), Gjendja e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas në Kosovë, 2010, dhe Organizata Botërore e Punës, Tranzicioni i të Rinjve në Punë të Mirë: Dëshmitë nga Kosova, Dokumenti i Politikave të Punësimit i OBP 2007/4.

⁸⁹ Punësimi në i komuniteteve jo shumicë në institucionet publike (në nivelin qendror dhe lokal, (përveç ndërmarrjeve publike) është vetëm 7.7 për qind, dhe komunitetet ashkali, egjiptian dhe rom janë të nënperfaqësuar krahasuar me përqindjen e tyre në popullatën e përgjithshme. Zyra e Kryeministrit/Zyra për Çështje të Komuniteteve, Vlerësim i Punësimit të Pjesëtarëve të Komuniteteve jo-shumicë në Shërbimin Civil dhe Ndërmarrjet Publike në Kosovë, 2013. Statistika më të freskëta të disagreguara sipas etnisë ka në dispozicion vetëm për nivelin qendror dhe ato tregojnë pasqyrë të ngjashme: në vitin 2015 përqindja e komuniteteve jo-shumicë ishte 6.24% (ashkali 0.07%, rom 0.13%, egjiptian 0.03%). Sh.Berisha për Institutin Demokratik i Kosovës (KDI), Hulumtim Parlamentar: Përfaqësimi i komuniteteve jo-shumicë në shërbim civil, Maj 2016.

⁹⁰ Organizata Botërore e Punës, Tranzicioni i të Rinjve në Punë të Mirë: Dëshmitë nga Kosova, Dokumenti i Politikave të Punësimit i OBP 2007/4. Megjithëse situata sa i përket nivelit të shkollimit po ndryshon, dallimet me komunitetet tjera ekzistojnë, dhe atë sidomos në pjesën e popullatës që tanimë janë moshë të punës.

⁹¹ Fondacioni CREATE dhe Qendra për Dokumentim Romë dhe Ashkali (RADC). Gratë Rome, Ashklike dhe Egjiptase në Qeverisje dhe Ekonomi.

⁹² Qendra Kosovare për Studime Gjinore dhe Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptase të Kosovës, Pozita e Grave të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas në Kosovë, 2008.

⁹³ Raportim nga organizatat e shoqërisë civile gjatë intervistave dhe punëtorisë së mbajtur me datë 20 shtator 2016.

Qasja në trajnime profesionale dhe shërbime të punësimit

Përgjithësisht, qasja në shërbime të punësimit dhe trajnime profesionale të ofruara nga MPMS (dhe organizata të tjera) është e kufizuar nga niveli i informimit të punëkërkuarve dhe kapaciteti i MPMS për t'i ofruar shërbime një numri aq të madh të punëkërkuarve. Në rastin e komuniteteve rom dhe ashkali, specifikisht, niveli i informimit është më i ulët, por edhe nevojat dhe/ose pengesat e tyre për pjesëmarrje në MATP mund të jenë të ndryshme: për shembull, në rast të disa skemave, kriteret përjashtuese për një pjesë të tyre (p.sh. niveli i shkollimit/njohurive paraprake, etj.). Gjithashtu, ka raste kur pjesëtarët e këtyre komuniteteve nuk mund të marrin pjesë në trajnime ose punësim të ndërmjetësuar nga MPMS për shkak se duhet të përkujdesen për shtëpinë/familjen, ose nuk dëshirojnë ta bëjnë këtë për shkak se me punë informale mund të realizojnë të ardhura më të larta.

Qasja në skemat e mbrojtjes sociale

Bazuar në të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë të vitit 2011 ku numri i popullsisë së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është llogaritur të jetë 35,784⁹⁴ dhe nga e dhëna e AGTSH që ka nxjerrë familjen mesatare 6 anëtarëshe, numri familjeve të këtyre komuniteteve llogaritet të jetë rreth 6,000. Bazuar në të dhënat se 60% (3,600 familje) e këtyre pjesëtarëve nuk kanë mundësi të sigurojnë të mirat esenciale për jetë i bie që me këto skema mbulohen vetëm 54% e familjeve të varfra. Arsyet kryesore për qasjen e kufizuar në skemat e ndihmës sociale janë: targetimi i dobët i sistemit të ndihmave sociale (që do të thotë se nga këto skema përfitojnë edhe familjet jo të varfra përderisa ndihma sociale është e dizajnuar për të mbështetur vetëm familjet e varfra); kriteret për të drejtën e përfitimit nga ndihmat sociale (definimi ligjor për familjen si bashkësi familjare)⁹⁵, mungesa e regjistrimit civil të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve dhe informimi i pamjaftueshëm rreth skemave të mbrojtjes sociale. Në mungesë të informacioneve, shumica e familjeve të këtyre komuniteteve aplikojnë për kategorinë e dytë të ndihmës sociale në të cilën kriter kyç është që familja të ketë një fëmijë nën moshën 5 vjeçare. Plotësimi i këtij kushti, rrit shkallën e lindshmërisë, duke thëlluar edhe më tej varfërinë⁹⁶.

Lartësia e ndihmave sociale

Edhe përkundër shtesës për fëmijë (5 Euro për secilin fëmijë) ndihma sociale vlerësohet e ulët dhe e pamjaftueshme për të nxjerrë familjet nga varfëria, si dhe për të plotësuar nevojat elementare⁹⁷. Në mesatare, një anëtar i familjes pranuese të ndihmës sociale në Kosovë i takon 0.75 Euro në ditë në krahasim me 0.59 Euro që pranon një anëtar i familjeve përfituese të komuniteteve rom dhe ashkali (Tabela 5) e që i bie për 21% më pak për këto komunitete, e që është nën pragun e varfërisë ekstreme, të llogaritur për herë të fundit në vitin 2011 në vlerë prej 1.20 Euro). Si rezultat, familjet përfituese përdorin tërë shumën për të mbuluar vetëm shpenzimet elementare për jetë, duke përfshirë këtu dhe shtesën e fëmijëve të destinuar për mirëqenien dhe arsimimin e fëmijëve⁹⁸.

Shfrytëzimi i shërbimeve sociale

Të dhënat nga AGTSH, 2013-2014 ka gjetur se 71.4% e fëmijëve të moshës 1-14 vjeçare kanë përjetuar dhunë psikologjike ose dënim fizik dhe afër dy të tretat e grave kanë raportuar se ka dhunë në komunitetin e tyre, respektivisht.

⁹⁴ Përfaqësuesit e shoqërisë civile gjatë punëtorisë së mbajtur me datë 20 shtator 2016.

⁹⁵ Përfaqësuesit e shoqërisë civile gjatë punëtorisë së mbajtur me datë 20 shtator 2016.

⁹⁶ Përfaqësuesit e shoqërisë civile gjatë punëtorisë së mbajtur me datë 20 shtator 2016.

⁹⁷ UNDP: The Real Value of Social Assistance: An Assessment of Social Assistance Benefit Adequacy, 2014.

⁹⁸ Intervistë me Drejtorin Ekzekutiv të OJQ-së Balkan Sunfloëers.

Përkundër pranisë së dhunës në familjet e këtyre dy komuniteteve, statistikave nga MPMS tregojnë se një numër shumë i vogël i tyre kanë shfrytëzuar shërbimet sociale. Shfrytëzimi i pakët i shërbimeve mund jetë rezultat i mungesës së njohurisë për shërbimet që ofrohen nga QPS ose i vështirësive të këtyre komuniteteve për t'iu qasur QPS-ve.

Objektivi

Përmirësimi i situatës ekonomike dhe sociale të komuniteteve rom dhe ashkali

Qasja në mundësi punësimi, zhvillim profesional dhe në skema të shërbimeve sociale është kyçe për përmirësimin e situatës ekonomike dhe sociale të komuniteteve rom dhe ashkali. Për të ngritur punësimin dhe punësueshmërinë, elemente kryesore janë zhvillimi i shkathtësive dhe lidhjeve me tregun e punës të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve, në njërin anë, dhe në anën tjetër zbatimi i masave të aksionit afirmativ për të ju kundërvënë efekteve të diskriminimit në tregun e punës. Po ashtu, pjesëtarëve të këtyre komuniteteve duhet t'iu sigurohet qasje në skemat e mbrojtjes sociale dhe shërbime cilësore sociale, të përshtatura me kushtet dhe nevojat e tyre konkrete.

Rezultatet e pritshme:

- 2.1. Përmirësohet niveli i punësimin të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali;
- 2.2. Përmirësohet pjesëmarrja e familjeve të komuniteteve rom dhe ashkali në skemat e mbrojtjes dhe në shërbime sociale.

Aktivitetet

Rezultati 2.1: Përmirësohet niveli i punësimin të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali

2.1.1. Aktiviteti: Hulumtimi, përcaktimi i treguesve të ndjeshëm gjinor dhe raportimi mbi gjendjen e tregut të punës të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali dhe mbi përfitimin e tyre nga shërbimet/masat e ofruara nga MPMS.

Duhet të analizohen mundësitë e shfrytëzimit të informatave ekzistuese të tregut të punës për komunitetet rom dhe ashkali, dhe mundësitë e rritjes së nivelit, cilësisë dhe raportimit të këtyre informatave në të ardhmen. Kjo analizë duhet të ketë në fokus të veçantë burimet e të dhënave periodike (siç janë AFP dhe Sistemi i Informatave të Tregut të Punës të MPMS) të cilat mundësojnë monitorimin e gjendjes përgjatë kohës dhe krahasimin e performancës në tregun e punës të këtyre komuniteteve në raport me mesataren e vendit. Këto informata duhet të tregojnë: nivelin/shkallën e punësimin të këtyre komuniteteve në përgjithësi dhe sipas sektorëve/karakteristikave të punës (punë e rregullt ose e përkohshme, punë formale ose joformale, aktiviteti ekonomik, sektori publik/privat); dhe treguesit tjerë bazikë të tregut të punës (shkalla e papunësisë, shkalla e pjesëmarrjes në tregun e punës).

Ndërkohë, statistikave të rregullta të MPMS duhet të raportohen në nivel të komuniteteve specifike. Për secilin nga këto komunitete nga Sistemi i Informatave për Menaxhimin e Punësimin duhet të raportohen informatat bazike për numrin dhe përqindjen e punëkërkuesve të regjistruar, numrin dhe përqindjen e punëkërkuesve për të cilën është ndërmjetësuar punësimi, numrin e pjesëmarrësve në trajnime profesionale dhe masa aktive të tregut të punës.

2.1.2. Aktiviteti: Përmirësimi i përfaqësimit të komuniteteve rom dhe ashkali në punësimin në institucione publike dhe ndërmarrje publike.

Monitorimi dhe raportimi i rregullt mbi zbatimin e kornizës ligjore ekzistuese për sigurimin e përfaqësimit të komuniteteve jo shumice në institucione publike është hapi i parë drejt përmirësimit të përfaqësimit të komuniteteve rom dhe ashkali në sektorin publik. Fokus i veçantë në këtë aspekt duhet t'i jepet përfaqësimit në përputhje me përbërjen e popullatës në nivel komunal siç parashihet me ligj, por monitorimi dhe raportimi duhet të bëhet edhe për nivelin qendror, megjithëse nuk ka kuota për specifike për komunitetet veç e veç. Në rast të ngecjeve, duhen hulumtuar shkaqet dhe duhet marrë masa sipas nevojës.

Në disa raste, vendet e punës në sektorin publik mund të targetojnë specifikisht këto komunitete. Për shembull, angazhimi i pjesëtarëve të këtyre komuniteteve si këshilltarë të punësimit do të ndihmonte në forcimin e qasjes së institucioneve ndaj këtyre komuniteteve, në një rënë anë, dhe forcimin e besimit të këtyre ndaj institucioneve, në anën tjetër.

2.1.3. Aktiviteti: Hulumtimi dhe zbatimi i masave të aksionit afirmativ për punësimin e komuniteteve rom dhe ashkali.

Do të analizohen masat potenciale të aksionit afirmativ për punësimin e komuniteteve rom, dhe ashkali për bizneset dhe organizatat jofitimprurëse që punësojnë pjesëtarë të këtyre komuniteteve, me fokus të veçantë në realizueshmërinë e tyre në mënyrë të drejtë (definimi i masës; kriteret për përfitim; procedurat e vlerësimit të kriterëve, përfshirë verifikimin e etnisë së të punësuarit). Kuotat si masë e aksionit afirmativ duhet të vazhdojnë të përdoren për skemat e MATP (përfshirë në trajnimet profesionale), dhe këto duhet të përcaktohen për këto komunitete në mënyrë specifike. Ligji mbi Ndërmarrjet sociale, i cili garanton pjesëmarrje prej së paku 30 për qind të komuniteteve të cënueshme në ndërmarrje sociale gjithashtu mund të shfrytëzohet për të promovuar punësimin e këtyre komuniteteve.

2.1.4. Aktiviteti: Vlerësimi i nevojave dhe i efektivitetit të shërbimeve të punësimit dhe MATP.

Vlerësimi i nevojave dhe sfidave specifike të komuniteteve rom dhe ashkali, dhe i efektivitetit të shërbimeve të punësimit dhe MATP (përfshirë trajnimin profesional) të realizuara në të kaluarën duhet të jetë bazë e dizajnit/modifikimit të shërbimeve dhe MATP reflektojnë nevojat e këtyre komuniteteve. Kjo analizë do të përfshijë perceptimet e këtyre komuniteteve dhe vlerësimin e tyre për qasjen dhe efektivitetin e këtyre shërbimeve/masave dhe matës objektivë të efektivitetit të tyre siç janë statusi i punësimit i përfituesve dhe qëndrueshmëria e punësimit.

2.1.5. Aktiviteti: Dizajnimi/modifikimi i shërbimeve (shtesë) të punësimit dhe MATP, përfshirë trajnimet profesionale, në përputhje me nevojat komuniteteve rom dhe ashkali.

Në përputhje me gjetjet e vlerësimit të nevojave dhe efektivitetit të shërbimeve dhe MATP të mëhershme, do të dizajnohen/modifikohen shërbimet dhe MATP ose në rast nevojë të ofrohen shërbime shtesë (p.sh. kurse të gjuhës ose mbulimi i kostos së transportit) në mënyrë që të sigurohet përfshirja e komuniteteve rom dhe ashkali. Dizajnimi dhe monitorimi i shërbimeve dhe MATP do të bëhet me pjesëmarrjen aktive të OJQ-ve të komuniteteve rom dhe ashkali. MATP do të përfshijnë, në mes tjerash, trajnimin dhe punën praktike (të subvencionuara) në sektorin privat dhe subvencionimin e pagës për një kohë të caktuar, për të mundësuar njëkohësisht zhvillimin e shkathtësive, përvojën e një vendi real të punës dhe promovimin e lidhjes së pjesëtarëve të këtyre komuniteteve me punëdhënësit. MATP do të

përfshijnë edhe masa për zhvillimin e vetë-punësimit, përfshirë edhe grantet për fillimin e biznesit. Në fokus të veçantë të këtyre masave duhet të jenë përfituesit e skemave të ndihmës sociale, në mënyrë këto familje të fuqizohen ekonomikisht dhe të eliminohet varësia ekonomike e tyre.

2.1.6. Aktiviteti: Organizimi i fushatave të informimit për shërbimet e punësimit dhe MATP, përfshirë trajnimet profesionale.

Fushatat informuese do të dizajnohen në mënyrë që të sigurohet qasja tek komunitetet rom dhe ashkali, duke pasur parasysh mediat dhe mënyrat e komunikimit që shfrytëzohen nga këto komunitete, dhe duke përfshirë vizitat e zyrtarëve në terren. Fushatat e informimit duhet të shfrytëzojnë kapacitetet ekzistuese të qendrave për mësim-nxënie dhe OJQ-ve të këtyre komuniteteve.

2.1.7. Aktiviteti: Promovimi i rasteve të suksesit në tregun e punës të pjesëtarëve të komuniteteve rom, dhe ashkali.

Do të promovohen rastet e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali që kanë arritur sukses në punësim ose vetëpunësim/biznes, me fokus të veçantë tek gratë.

Rezultati 2.2: Përmirësohet pjesëmarrja e familjeve të komuniteteve rom dhe ashkali në skemat e mbrojtjes dhe shërbime sociale

2.2.1 Aktiviteti: Vlerësimi i mbështetjes shtesë për përfituesit e ndihmave sociale.

Për të përmirësuar mirëqenien ekonomike dhe sociale të këtyre komuniteteve, skema e ndihmës sociale duhet plotësuar me shërbime shtesë. Përveç vlerësimit për plotësimin e kriterëve për të pranuar ndihmën sociale, për të cilën kanë aplikuar kandidatët, zyrtarët e QPS-ve po ashtu duhet të vlerësojnë se cila kategori e ndihmës sociale është më e përshtatshme dhe adekuate për familjen aplikuese. Për më tepër, zyrtarët e QPS-ve duhet t'i informojnë këto familje lidhur me programet e aftësimin profesional dhe skemat e punësimit që ofrohen nga Ministria edhe institucionet e organizatat e tjera.

2.2.2 Aktiviteti: Identifikimi i fëmijëve dhe personave me nevoja të veçanta.

Për të përfituar nga skema e mbështetjes për familjet me fëmijë me nevoja të veçanta dhe pranuar pensionin për persona me aftësi të kufizuara (mosha 18-65 vjeçare), është parakusht identifikimi i këtyre rasteve. Për të arritur këtë, janë të domosdoshme fushatat informuese dhe vetëdijesuese me pjesëtarët e këtyre komuniteteve. Gjatë punës në terren, punëtorët social të QPS dhe OJQ-të që punojnë me këto komunitete, duhet të angazhohen për identifikimin e këtyre rasteve.

2.2.3. Aktiviteti: Fushata informative për skemat e mbrojtjes dhe shërbime sociale.

Duhet organizuar fushata informuese për llojet e skemave të mbrojtjes sociale dhe kriteret për qasje në këto skema. Siç u theksua më lartë këto fushata duhet të realizohen, kryesisht, përmes televizionit dhe kontakteve direkte me pjesëtarët e këtyre komuniteteve. Po ashtu, përmes fushatave pjesëtarët e këtyre komuniteteve duhet të informohen qartë për shërbimet sociale të ofruara nga Qendrat për Punë Sociale. OJQ-të duhet të informojnë gratë dhe fëmijët e këtyre komuniteteve për të drejtat e tyre dhe shërbimet në rastet e dhunës familjare (shërbimet e rehabilitimit, strehimit në strehimore, shërbimet psiko-sociale), shërbimet për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, si dhe shërbimet për rastet e martesës së hershme dhe për mbështetjen e fëmijëve që punojnë punë të rënda.

2.2.4 Aktiviteti: Analiza e cilësisë së shërbimeve sociale dhe identifikimi i shërbimeve të reja sociale.

Për të rritur pjesëmarrjen e pjesëtarëve rom dhe ashkali në shërbimet ekzistuese sociale, duhet analizuar nëse shërbimet janë në përputhje me nevojat e këtyre komuniteteve dhe nëse kriteret i përgjigjen gjendjes së këtyre komuniteteve. Bazuar në analizën, shërbime të reja duhet identifikuar në harmoni me nevojat e komuniteteve të synuara. Duke qenë se kapacitetet e QPS janë të kufizuara, mund të synohet rritja e numrit të OJQ-ve të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali.

2.2.5 Aktiviteti: Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve komunalë për përmirësimin e shërbimeve sociale.

Duhet ngritur kapacitetet e zyrtarëve të QPS-ve për vlerësimin e duhur të gjendjes dhe të nevojave të këtyre komuniteteve, si dhe për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe në kohë. Është me rëndësi që zyrtarët të aftësohen për të regjistruar të dhënat për shërbimet e ofruara, regjistrimin dhe arsyetimin për shërbimet e reja që duhet ofruar dhe për ato që nuk tregojnë efekt në mirëqenien e këtyre komuniteteve. Po ashtu, zyrtarët e QPS-ve duhet të trajnohen për të informuar familjet përfituese të ndihmave sociale lidhur me masat aktive të tregut të punës të ofruara nga MPMS dhe institucionet e tjera.

Çështje të ndërlidhura

Suksesi në tregun e punës është i ndërlidhur ngushtë me nivelin e shkollimit të individëve. Nga njëra anë, niveli i shkollimit është faktor kyç për sigurimin e një vendi (të mirë) të punës. Nga ana tjetër, kur individët e shkolluar nuk mund të gjejnë punë, kjo i dekurajon të rinjtë që të përfundojnë shkollimin dhe i shtyn individët e shkolluar të emigrojnë. Rrjedhimisht, çështja e performancës e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali, në tregun e punës është e ndërlidhur ngushtë me përmirësimin e nivelit të arsimit të tyre.

Ngjashëm, ngritja e mirëqenies sociale të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali lidhet ngushtë me arritjet në tri fushat tjera të kësaj Strategjie. Shfrytëzimi i shërbimeve sociale varet nga niveli arsimor, gjendja shëndetësore e këtyre komuniteteve dhe kushtet e banimit. Shkalla e efektit të skemave të ndihmave sociale varet nga kushtet e banimit dhe gjendja shëndetësore e këtyre komuniteteve. Regjistrimi i të porsalindurve ndikohet nga cilësia e shërbimeve cilësore që ofrohen nga institucionet shëndetësore, e që pastaj ndikojnë në qasje në skemat dhe shërbimet sociale. Në anën tjetër shfrytëzimi i skemave të mbrojtjes dhe shërbimeve sociale dhe masave aktive të tregut të punës ndikon në rritjen e nivelit arsimor, përmirësimin e kushteve të banimit dhe përkujdesjes shëndetësore të këtyre komuniteteve.

Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e objektivit të lartshënuar janë:

- Do të ketë bashkëpunim nga ana komunave ku jetojnë komunitetet rom dhe ashkali, dhe i OJQ-ve dhe qendrave mësimore.
- Ekziston interesimi i komuniteteve rom dhe ashkali, përfshirë gratë, për të shfrytëzuar mundësitë e zhvillimit të shkathtësive dhe pjesëmarrjes në MATP.
- Fonde të mjaftueshme për ndihma sociale dhe shërbime të reja sociale.

Ndërkaq, faktorët që vënë në pyetje suksesin e jetësimit të asaj që është planifikuar janë:

- Niveli i krijimit të vendeve të reja të punës në nivel të vendit dhe/ose komunave ku jetojnë komunitetet rom dhe ashkali.
- Buxheti i pamjaftueshëm për masa aktive të tregut të punës.
- Procedurat e rekrutimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore në institucionet publike mund ta ngadalësojnë procesin e përmirësimit të përfaqësimit të komuniteteve brenda periudhës së kësaj strategjie.
- Mungesa e kapaciteteve në Qendrat e Punës Sociale në komuna.
- Mungesa e buxhetit shtesë për shërbimet e reja për tu ofruar nga QPS-të.
- Mos-regjistrimi civil i të gjithë pjesëtarëve të këtyre komuniteteve.
- Mungesa e besimit të komuniteteve rom dhe në institucionet publike.

6.3. Shëndetësia

Sikur në vendet e tjera të Evropës Qendrore dhe Juglindore, një numër i madh i familjeve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian jetojnë nën kufirin e varfërisë, me më shumë se 36% në varfëri të skajshme^{99 100}. Shumë studime kanë treguar ndikimin negativ të varfërisë në shëndetin dhe jetëgjatësinë. Njerëzit me nivele të ulëta të të ardhurave janë veçanërisht të pambrojtur nga sëmundjet e përshpejtuara nga kualiteti i dobët si dhe mënyrat jo adekuate e të ushqyerit¹⁰¹.

Disa dokumente strategjike, si edhe aktorë kombëtarë edhe ndërkombëtarë, janë munduar të adresojnë pjesërisht aspektet shëndetësore të komuniteteve. Ministria e Shëndetësisë ka lansuar dhe mundohet t'i përmbahet Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë si dhe Strategjisë për Shëndetin Reproductiv, ndërsa Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit zbatuar për disa vite Planin e Veprimit për Rininë. Instituti Kombëtar për Shëndet Publik, Organizata Botërore e Shëndetësisë, UNICEF, dhe UNFPA kanë qenë po ashtu aktiv në përkrahjen e këtyre strategjive edhe zhvillimin e programeve që kanë adresuar problemet e komuniteteve. Së fundi, Zyra Zvicëranë për Zhvillim ka lansuar një projekt për përkrahjen e sektorit primar shëndetësor, duke pasur si fokus, ndër tjerash, edhe përkrahjen e komuniteteve të marginalizuara.

Sfidat

Qasja dhe shfrytëzimi i shërbimeve shëndetësore nga romët dhe ashkalinjtë

Me një qasje të kufizuar në shërbimet parandaluese dhe kurative shëndetësore, këto komunitete vazhdojnë të vuajnë nga shëndeti i dobët. Një analizë kritike e bën të ditur se ekzistojnë pengesa të shumëfishta në qasjen dhe shfrytëzimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor nga ana e komuniteteve rom dhe ashkali. Ndër to numërojmë varfërinë dhe pamundësinë për pagesën e trajtimit dhe blerjes së barnave, transportit, apo pagesat joformale për punëtorët shëndetësorë; mungesën e dokumenteve të identifikimit dhe, si rezultat i kësaj, pamundësinë e shfrytëzimit të shërbimeve të ofruesve të kujdesit shëndetësor publik; largësinë nga objektet e kujdesit shëndetësor; diskriminimi mbi baza etnike; si dhe, mungesën e besimit në mjekët dhe personelin tjetër mjekësor¹⁰². Qasja është posaçërisht problematike për shërbimet për parandalimin e sëmundjeve, si edhe trajtim mjekësor sekondar dhe terciar.

Sjella karshi shëndetit dhe mënyra e jetesës të komunitet rom dhe ashkali

Komunitetet rom dhe ashkali vuajnë nga një prevalencë e lartë e të ushqyerit joadekuat dhe të pamjaftueshëm, gjë që kontribuon në shëndetin e dobët dhe jetëgjatësinë të shkurtër. Një dietë e pa balancuar, me lloje të pamjaftueshme të ushqimeve, dhe vlera ushqyese joadekuate paraqet rrezik shëndetësor për pjesëtarët e komuniteteve. Mungesa e higjienës së përgjithshme edhe individuale, kultura e konsumimit masiv të duhanit, së bashku me një aktivitet fizik rekreacional të ulët në mesin e komuniteteve rom dhe ashkali, i shtojnë këtij problemi edhe elemente tjera¹⁰³. Paraqitja e vonshme tek mjeku edhe shfrytëzimi i ulët i shërbimeve preventive e përmbyllin trendin negativ të sjelljes karshi shëndetit¹⁰⁴.

⁹⁹ Sigurimi i ri shëndetësor do të shpëtojë jetë: Jetëgjatësia dhe shëndeti në komunitetet Rome, Ashkali, dhe Egjiptase të Kosovës. Balkan Sunfloëers. 2016.

¹⁰⁰ Stubbs and Nestić, Child Poverty in Kosovo: Policy Options Paper & Synthesis Report. UNICEF. 2010.

¹⁰¹ Sigurimi i ri shëndetësor do të shpëtojë jetë: Jetëgjatësia dhe shëndeti në komunitetet Rome, Ashkali, dhe Egjiptase të Kosovës. Balkan Sunfloëers. 2016.

¹⁰² Policy Brief 4: Qasja dhe shfrytëzimi i shërbimeve shëndetësore nga Romët, Ashkalinjtë dhe Egjiptasit. Solidar Suisse. 2016.

¹⁰³ Policy Brief 3: Të ushqyerit dhe mënyra e jetesës në komunitetet Rome, Ashkali dhe Egjiptase. Solidar Suisse. 2016.

¹⁰⁴ Po aty.

Niveli i sëmundshmërisë edhe vdekshmërisë

Niveli i sëmundshmërisë është brengosësh, veçanërisht prezenca e sëmundjeve kronike jo të transmetuese, si të diabetit, hipertensionit, sëmundjeve kardiovaskulare dhe çrregullimeve të skeletit¹⁰⁵. Këto sëmundje dhe kufizimet që pasojnë janë duke shkaktuar probleme të konsiderueshme për mirëqenien personale dhe të bashkësisë¹⁰⁶. Përveç humbjes së kënaqësisë për një jetë të shëndoshë, dhe barrën e mundshme për familjen e dikujt, trajtimi i sëmundjeve paraqet një barrë të rëndë financiare edhe për shoqërinë. Ndikimi financiar është veçanërisht i rëndë nëse e kemi parasysh se familjet rome dhe ashkali jetojnë nën vijën kombëtare të varfërisë. Numri i madh i popullsisë të moshës punuese me kufizime në aktivitetet e përditshme do të thotë kapacitetin e zvogëluar të punës dhe varësi të rritur nga asistencë sociale dhe burimet e të ardhurave joformale¹⁰⁷.

Objektivi

Përmirësimi i gjendjes shëndetësore dhe cilësisë së jetës tek pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali.

Shëndeti është një gjendje e plotë fizike, mendore dhe e mirëqenies sociale e jo, thjeshtë, mungesa e sëmundjes apo dobësisë. Synimi i kësaj strategjie është përmirësimi i gjendjes shëndetësore edhe kualitetit të jetesës në mesin e pjesëmarrësve të komuniteteve rom dhe ashkali duke e pasur parasysh këtë definicion më të gjerë të shëndetit. Sëmundja është e njohur të ketë ndikim në aktivitetin njerëzor, duke shkaktuar kufizime në aktivitetet e përditshme të njerëzve. Kufizimet e tilla nënkuptojnë se njerëzit e prekur nuk janë në gjendje të gëzojnë mirëqenien e plotë fizike, mendore dhe sociale. Kufizimet e tilla, gjithashtu, nënkuptojnë kapacitetin e zvogëluar të punës, që do të thotë varësi më të madhe nga ndihma sociale dhe financiare nga anëtarët tjerë të familjes. Andaj janë të rëndësishme masat që përmirësojnë këtë situatë në të mirën e përgjithshme të qytetarëve.

Rezultatet e pritshme:

- 3.1. Përmirësohet qasja në shërbime shëndetësore për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali;
- 3.2. Përmirësohet sjellja dhe praktikat shëndetësore tek pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali;
- 3.3. Sigurohet një mjedis i shëndetshëm për popullsinë e komuniteteve rom dhe ashkali.

Aktivitetet

Rezultati 3.1: Përmirësohet qasja në shërbime shëndetësore për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali

3.1.1. Aktiviteti: Zhvillimi i aktiviteteve për skreningun e kancerit të gjirit.

Aktivitetet në fjalë do të synojnë qasjen e nënave nga komunitetet që janë në rrezik nga kanceri i gjirit. Aktivitetet do të organizohen nga institucionet relevante edhe do të angazhojnë ekipet e profesionistëve me qëllim të zbulimit të shenjave të hershme të kancerit te popullata e shënjestruar si dhe triazhimin e rasteve të identifikuara në institucionet relevante shëndetësore.

¹⁰⁵ Policy Brief 2: Përhapja e sëmundjeve në komunitetet Rome, Ashkali dhe Egjiptase. Solidar Suisse. 2016.

¹⁰⁶ Po aty.

¹⁰⁷ Po aty.

3.1.2. Aktiviteti: Realizimi i vizitave shtëpiake për nëna dhe fëmijë si dhe grupe të tjera të ndjeshme.

Vizitat shtëpiake do të kenë qëllimin e rritjes së qasjes në shërbimet edukative edhe konsultative që lidhen me kujdesin shëndetësorë të nënave edhe fëmijëve. Krijimi i ekipeve mobile shëndetësore do të mundësojë arritjen e banorëve nga këto dy kategori si edhe kategoritë tjera të popullatës (pleqtë, invalid).

3.1.3. Aktiviteti: Aktivitetet që arrijnë popullatën vulnerable.

Aktorët e ndryshëm duhet të angazhohen kohë pas kohe, në promovimin dhe sigurimin e ekzaminimeve tjera shëndetësore të subvencionuara për popullatën e rrezikuar (sipas moshës, gjendjes shoqërore-ekonomike, etj.). Aktorët e komunitetit (duke përfshirë organizatat e ndryshme, përfaqësuesit e komunitetit, etj.) duhet të konsultohen me komunitetet e tyre në lidhje me nevojat dhe pritjet në lidhje me mjekësinë preventive dhe sistemet e paralajmërimit të hershëm. Ato duhet po ashtu inkurajojnë dhe mbështesin familjet e komuniteteve që në mënyrë periodike të bëjnë ekzaminimin e sëmundjeve më të zakonshme ku trajtimi mund të jetë i dobishëm.

3.1.4. Aktiviteti: Masat institucionale që përmirësojnë qasjen në shërbime shëndetësore.

Varësisht nga nevoja, institucionet shëndetësore duhet të përgatiten për të siguruar një qasje adekuate në shërbimet shëndetësore të popullatës nga komunitetet rom dhe ashkali. Në këto masa mund të përfshihen angazhimi i stafit adekuat në punë me komunitete, me preferencë për ata që vijnë nga vet komunitetet, kujdesi nga diskriminimi e të ngjashme.

3.1.5. Aktiviteti: Monitorimi i vazhdueshëm i qasjes në shërbimet e kujdesit shëndetësor.

Autoritetet lokale, si dhe organizatat e shoqërisë civile, duhet të monitorojnë dhe vlerësojnë në vazhdimësi qasjen në shërbimet e kujdesit shëndetësor të komuniteteve rom dhe ashkali që të sigurohen që qytetarët e këtyre komuniteteve marrin shërbimet e nevojshme shëndetësore.

Rezultati 3.2. Përmirësohet sjellja dhe praktikat shëndetësore tek pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali

3.2.1. Aktiviteti: Fushatat për imunizim.

Fushata për imunizim synon adresimin e problemit të vaksinimit të ulët në mesin e fëmijëve të komuniteteve që është raportuar që disa vjet me radhë. Fushatat në fjalë kanë qëllim që përmes materialeve edukative edhe promovuese të arrihen familjarët me qëllim të informimit edhe ndryshimit të qasjes së tyre sa i përket imunizimit të fëmijëve. Ekipet e imunizimit nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik duhet të bashkohen në aktivitete të tilla në mënyrë që të ndihmojnë me kapacitetet e tyre profesionale.

3.2.2. Aktiviteti: Shpërndarja e materialit informues për planifikim familjar dhe shëndet riprodhues.

Caku i programeve të tilla është edukimi i grave, burrave dhe të rinjve duke u ofruar atyre shkathtësi dhe njohuri për jetën mbi shëndetin riprodhues, përfshirë planifikimin familjar përmes organizimit të sesioneve në komunitete dhe sesioneve trajnuese në shkolla, dhe po ashtu përmes financimit të iniciativave për ngritjen e ndërgjegjes rreth çështjeve të ndryshme të popullsisë përmes fushatave, mediave dhe tryezave të rrumbullakëta.

3.2.3. Aktiviteti: Edukimi për rëndësinë e kushteve higjiene-sanitare.

Edukimi për rëndësinë e kushteve higjiene-sanitare nënkupton trajnime dhe shpërndarje të materialeve edukative. Temat do të ishin në lidhje me rëndësinë e ujit të pijshëm, higjienës personale dhe shtëpiake, përdorimi i ujit të pijshëm, menaxhimi i mbeturinave, kujdesi ndaj ushqimit, etj. Aktorë të ndryshëm, duke filluar nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, pastaj niveli komunal dhe organizatat e shoqërisë civile duhet të bashkojnë forcat që të promovojnë një sjellje pozitive shëndetësore. Këta aktorë duhet të zhvillojnë, planifikojnë dhe mbajnë sesione të edukimit të komunitetit; zhvillojnë dhe shpërndajnë materiale edukative shëndetësore. Për këtë qëllim qeveria duhet të ndajë, në baza të rregullta, fonde për programet e edukimit shëndetësor të komuniteteve që mund të shfrytëzohen nga organizatat e shoqërisë civile si dhe institucioneve tjera shëndetësore të nivelit sekondar edhe terciar.

3.2.4. Aktiviteti: Avancimi i kapaciteteve preventive të stafit në kujdesin parësor.

Organet lokale duhet të angazhohen në mënyrë aktive në zhvillimin e kapaciteteve të stafit shëndetësor për zbatimin e programeve të edukimit të komuniteteve. Ky avancim i kapaciteteve duhet të plotësohet me angazhimin e stafit në programet promovuese, në baza të rregullta, nga institucionet shëndetësore, si dhe fuqizimin e angazhimit preventiv edhe promovues të shëndetit në kuadër të shërbimeve ditore shëndetësore, ku edukimi shëndetësor arrihet të jetë një aspekt i aktiviteteve të përditshme profesionale.

Rezultati 3.3. Sigurohet një mjedis i shëndetshëm për popullsinë e komuniteteve rom dhe ashkali

3.3.1 Aktiviteti: Kontrolli periodik i nivelit të plumbit në vendbanimet e komuniteteve.

Kontrolli periodik i nivelit të plumbit në vendbanimet e komuniteteve rom dhe ashkali është si vazhdimësi e adresimit të çështjes së kontaminimit që ka qenë prezent në disa vendbanime të komuniteteve. Duke pasur parasysh që pasojat janë kronike me efekte serioze në shëndetin e komuniteteve aktivitetet monitoruese duhet të vazhdojnë deri sa të kemi një siguri të plotë që kontaminimi nuk paraqet rrezik për komunitetet në fjalë.

3.3.2. Aktiviteti: Pajisja me kontejnerë familjarë për mbeturina.

Pajisja me kontejnerë familjar për mbeturina dhe menaxhimi në mënyrë korrekte i mbledhjes së mbeturinave dhe eliminimin e deponive të egra do të siguronte kushte më të mira higjienike po edhe reduktimin e ekspozimit në materie tjera kimike edhe fizike që janë të dëmshme për shëndetin.

Çështje të ndërlidhura

Ndryshimet në situatën e shëndetit janë të qëndrueshme vetëm nëse aplikohen me masa tjera që adresojnë çështjet sociale, ekonomike edhe arsimore të komuniteteve në fjalë. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Financave, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duhet të koordinohen dhe pajtohen në mënyrë që të ketë zbatueshmëri në praktikë.

Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e objektivit të lartshënuar janë:

- Ka një interesim të shtuar të aktorëve nga komuniteti ndërkombëtar për të ndihmuar çështjen dhe qeveria është e hapur ndaj një përkrahjeje të tillë.

Ndërkaq, faktorët që vënë në pyetje suksesin e jetësimit të asaj që është planifikuar janë:

- Interesimi i pamjaftueshëm i autoriteteve qendrore dhe lokale për çështjen, duket pasur në fokus çështjet politike edhe ekonomike;
- Interesimi i ulët në mesin e pjesëtarëve të komuniteteve për aktivitetet në suaza të kësaj strategjie;
- Mungesa e motivimit për punë shtesë nga stafi mjekësor i institucioneve shëndetësore;
- Kapacitetet e limituara të organizatave që përfaqësojnë interesat e komuniteteve;
- Mungesa e harmonizimit të aktiviteteve nga subjektet e niveleve të ndryshme;
- Mungesa e fondeve.

6.4. Banimi

Çështja e banimit në Kosovën e pasluftës ka qenë dhe mbetet sfidë e shoqërisë sonë. Në veçanti, këtë sfidë e hasim tek komunitetet rom dhe ashkali, të cilët janë ballafaquar me probleme të kësaj natyre edhe para vitit 1999. Mungesa e numrit të mjaftueshëm e shtëpive/banesave është e evidente dhe duhen të ndërmerren masa përmirësuese në drejtim të reduktimit të numrit të atyre pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali që nuk kanë banim adekuat.

Sfidat

Mungesa e të dhënave të sakta për nevojat e banimit

Komunat kanë përgjegjësinë kryesore për sigurimin e banimit¹⁰⁸ për të gjithë qytetarët që jetojnë në territorin tyre. Sfidë kryesore për ta adresuar këtë çështje, në mënyrë efektive, është mungesa e të dhënave në nivelin komunal ku do të evidentoheshin nevojat e qytetarëve për banim. Për shkak të kësaj anomalie, shpesh hasim në iniciativa të ndryshme nga donatorë të jashtëm të cilët, për të siguruar banim adekuat për familjet specifike të komuniteteve rom dhe ashkali nuk i koordinojnë plan veprimet e veta me përfaqësuesit e komuniteteve dhe përfaqësuesit e komunës në të cilën ndërtojnë. Nga ana tjetër, mungesa e të dhënave të sistemuara bën që vet komunat të jenë joefektive në planifikim të investimeve të kësaj natyre. Në këtë fazë është duke u hartuar baza e të dhënave e nivelit qendror, në të cilën do të kenë qasje të gjitha komunat, për t'i evidentuar në të nevojat e qytetarëve për banim adekuat dhe për banim social. Pritet që baza e të dhënave të jetë funksionale në vitin 2017 dhe të operojë nën mbikëqyrjen e MMPH.

Përfshirja e pamjaftueshme e pjesëtarëve të komuniteteve në zgjidhjen e problemit të banimit

Megjithëse janë ata që vuajnë pasojat e moszgjidhjes së problemit të banimit, një numër i konsiderueshëm i pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali nuk janë të përfshirë sa duhet në zgjidhjen e këtij problemi kompleks. Aspekti i parë i mospërfshirjes ka të bëjë me artikullimin e nevojave për banim, që, shpesh, nuk bëhet në masën dhe në mënyrën e duhur, qoftë për shkak të humbjes së besimit për mundësinë e gjetjes së zgjidhjes, ose për shkaqe të tjera. Aspekti tjetër është mosrregullimi i dokumentacionit pronësor që rezulton me faktin se pronat në të cilat ndodhet objekti i banimit ose mund të ndërtohet akoma figurojnë në emër të shitësit ose të ndonjë paraardhësi, pasi nuk janë zhvilluar procedurat ligjore për bartjen e tyre tek pronarët aktualë. Kjo kufizon dukshëm mundësinë për ofrimin e ndihmës së nevojshme.

Mungesa e fondeve për mbështetjen e banimit të komuniteteve rom dhe ashkali

Buxheti i Qeverisë së Kosovës, i cili ndahet për të siguruar banim është i vogël. Deri më tani nuk ka pasur një vijë buxhetore të veçantë për fondin e banimit në nivel komunal apo qendror për komunitetet rom dhe ashkali. Në këtë fazë të strategjisë kur nuk kemi të dhëna të përafërta se cili është numri i atyre familjeve të cilat kanë nevojë për banim qoftë privat apo banim social, vështirë të konstatohet shuma e mjeteve financiare të cilat nevojiten për këtë qëllim. Mirëpo, pasi që komunat të kenë aprovuar planet e trevjeçare të banimit dhe të kemi funksionale bazën e të dhënave, Qeveria e Kosovës, me kërkesën e komunave, e në përputhje me nenin 25 të Ligjit Nr.03/L-164¹⁰⁹), duhet të ndajë mjete për ngritjen e numrit të shtëpive ose banesave.

¹⁰⁸ http://ëëë.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=147&Itemid=56&lang=sq

¹⁰⁹ Ligji për financimin e programeve të veçanta të banimit.

Objektivi

Sigurimi i banimit adekuat të qëndrueshëm për komunitetet rom dhe ashkali në përputhje me legjislacionin në fuqi

Banimi është çështje vendimtare për stabilitet social, shëndet dhe zhvillim kualitativ të mirëqenies njerëzore. Banimi si shfrytëzues më i madh i hapësirës, ndikon në rrjedhën e zhvillimit të gjithmbarshëm të shoqërisë dhe është komponent e rëndësishme e zhvillimit social-ekonomik, gjegjësisht të standardit jetësor. Banimi është e drejtë sociale e qytetareve në shumicën e vendeve të zhvilluara. E drejta në banim gjithnjë e më shume është e pranishme në kuadër të politikave globale dhe në luftë për të drejtat njerëzore, e sanksionuar edhe me konventa ndërkombëtare.

Rezultatet e pritshme:

- 4.1. Janë identifikuar nevojat e pjesëtarëve të komuniteteve për banim adekuat dhe banim social;
- 4.2. Është shtuar ndërgjegjësimi i pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali për pjesëmarrje aktive në zgjidhjen e problemeve të banimit;
- 4.3. Avancim i ndjeshëm drejt zgjidhjes së problemit të banimit për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali.

Aktivitetet

Rezultati 4.1. Janë identifikuar nevojat e pjesëtarëve të komuniteteve për banim adekuat dhe banim social

4.1.1. Aktiviteti: Përfshirja e pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në bazën e të dhënave për financimin e programeve të veçanta të banimit.

Identifikimi i nevojave për banim, si parakusht për evidentim në bazën e të dhënave, do të bëhet veç e veç për familjet që posedojnë pronë private dhe ato që kanë nevojë për banim social.

Identifikimi i familjeve nevojtare që posedojnë pronë private, por nuk kanë kushte të përshtatshme për banim, do të bëhet nga komisione të kombinuara, të cilët në përbërjen e tyre kanë zyrtarë komunal, pjesëtarë të OJQ-ve dhe përfaqësues të komuniteteve që jetojnë në vendbanimet përkatëse. Këto komisione komunale, të ngarkuara me detyra specifike për zbatimin e strategjisë, duhet të evidentojnë të gjitha pronat private të komunitetit rom dhe ashkali në të cilat nuk ekzistojnë kushtet adekuate për banim. Pastaj, këto të dhëna do të evidentohen nga komuna në bazën qendrore të të dhënave.

Në bazë të neneve 24 dhe 25 të Ligjit të Banimit, të gjitha kërkesat për banim social do të evidentohen në bazën përkatëse të të dhënave në secilën komunë. Grumbullimi i të dhënave nga terreni do të bëhet nga komisionet komunale për banim në përputhje me nenin 5 të Udhëzimit Administrativ nr.22/2010 të cilët duhet të bashkëpunojnë ngushtë me përfaqësuesit e komuniteteve si burim plotësues i informacionit për verifikimin e gjendjes reale të banimit.

4.1.2. Aktiviteti: Caktimi i prioriteteve për familjet në nevojë për përfshirjen në programin e banimit social.

Të gjitha komisionet e formuara për këtë qëllim duhet t'u përmbahen kriterëve¹¹⁰ të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ të MMPH - UA-21/2010. Duke marrë parasysh obligimet që do të dalin nga kjo Strategji do të bëhen listat prioritare për banim social. Listat prioritare do të grumbullohen dhe do tu ju prezantohen donatorëve të mundshëm për konsideratë.

Rezultati 4.2: Është shtuar ndërgjegjësimi i pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali për pjesëmarrje aktive në zgjidhjen e problemeve të banimit

4.2.1. Aktiviteti: Organizimi i fushatës së vetëdijesimit për përfshirje në çështjen e banimit.

Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me organizatat joqeveritare, do të angazhohen në fushata sensibilizuese për gjithëpërfshirje në çështjen e banimit. Kjo fushatë do të bëhet për dy arsye kryesore: për të siguruar kushte të barabarta për aplikim, dhe për arsye se meshkujt dhe femrat kanë kërkesa të ndryshme në banim. Me këtë rast, do të insistohet që në takimet me qytetarë të komuniteteve të jenë të përfaqësuara edhe femrat.

Fushatat do të zhvillohen në lokacionet ku koncentrimi i komuniteteve rom dhe ashkali është më i lartë. Aty do të ketë informacione të mjaftueshme për të drejtat e popullatës për banim adekuat (qoftë në pronë private apo në banim social). Gjatë fushatës do të ketë broshura të mjaftueshme për pjesëmarrësit me informata të mjaftueshme për çështjen e banimit si dhe do të ketë trajnime ku do t'u prezantohen shembuj konkretë se cilët janë hapat të cilët duhet ndjekur për të rregulluar dokumentacionin pronësor.

4.2.2. Aktiviteti: Mbështetja e komuniteteve rom dhe ashkali për pajisje me dokumentacion përkatës pronësor apo një të drejtë tjetër të tokës në të cilën mund të ndërtohet.

Mënyra tradicionale e të banuarit të komuniteteve rom dhe ashkali ndryshon, në masë të madhe, nga komunitetet tjera, prandaj nevojitet një qasje më specifike për identifikimin e personave që kanë të drejtën e pronësisë në tokën ku ka qenë apo ku është e ndërtuar shtëpia. Për këtë arsye, gjatë periudhës së zbatimit të strategjisë, duhet të angazhohen organizata të specializuara, jo qeveritare apo qeveritare, që, përmes projekteve të veçanta, të ndihmojnë komunitetet rom dhe ashkali për të drejtat e tyre pronësore.

Projektet duhet të kenë disa komponente bazë: gjithëpërfshirjen e komunitetit, trajnimin dhe elaborimin e ligjeve të pronës të cilat janë të zbatueshme në Kosovë, grumbullimin e dokumentacionit në dispozicion, këshillimin ligjor dhe autorizimin për përfaqësim ligjor para organeve komunale apo gjyqësore, varësisht prej rasteve. Të dhënat e grumbulluara në komunitet duhet të ndahen në tri grupe: personat apo familjet që mund të dëshmojnë të drejtën e pronësisë¹¹¹, personat apo familjet që mund të dëshmojnë të drejtën e shfrytëzimit¹¹² dhe personat apo familjet që mund të dëshmojnë të drejtën e posedimit¹¹³ në pronën në të cilën e kanë apo e kanë pasur shtëpinë, apo dhomën në kuadër të një shtëpie të

¹¹⁰ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=7947>

¹¹¹ E drejta e pronësisë në një pronë të paluajtshme dëshmohet me certifikatë kadastrale dhe është e drejta më e lartë e njohur në vendin tonë.

¹¹² E drejta e shfrytëzimit në një pronë të paluajtshme dëshmohet me dokumentacion të lëshuar nga institucionet përkatëse, prona mund të shfrytëzohet por jo edhe të tjetërsohet apo shitet pasi që pronar është institucioni i cili ka mundësuar shfrytëzimin e pronës nga shfrytëzuesi.

¹¹³ E drejta e posedimit në një pronë të paluajtshme dëshmohet me posedimin edhe pushtimin e pronës si dhe me dokumentacion alternativ sikurse që janë adresa në dokumente personale, faturat e ndryshme për pagesën e rrymës, ujit, etj.

përbashkët. Për të gjitha këto kategori duhet të sigurohet dokumentacioni përkatës pronësor ose dokumentacioni që e njeh të drejtën e shfrytëzimit të pronës.

Rezultati 4.3: Avancim i ndjeshëm drejt zgjidhjes së problemit të banimit për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali.

4.3.1. Aktiviteti: Hartimi i projekteve prioritare për renovim, rindërtim apo ndërtim të shtëpisë në parcelat vetanake.

Nga përvoja e deritanishme, projektet e tilla nuk kanë një kosto të lartë financiare. Prandaj në këtë fazë të strategjisë duhet të kërkohet edhe më tutje mbështetje financiare të donatorëve ndërkombëtarë për projekte të kësaj natyre. Po ashtu, qeveria lokale duhet të ketë vijë të veçantë buxhetore për të bërë renovimin e shtëpive ekzistuese. Po ashtu, duhet të adresohen rastet kur familjet e caktuara nuk kanë shtëpi të veten në parcelën ku ata janë pronarë, qoftë për shkak të rrënimit të qëllimshëm apo për shkaqe kur nuk ka mundur t'i rezistoj kohës.

4.3.2 Aktiviteti: Implementimi i programeve për trajtimin e vendbanimeve joformale.

Pasi të jenë identifikuar familjet dhe vendbanimet me kushte të vështira të banimit, qeveria lokale dhe ajo qendrore do të bëjnë përgatitjen e pilot projekteve të cilat janë të realizueshme në disa nga komunat ku koncentrimi i këtyre komuniteteve është i madh.

4.3.3. Aktiviteti: Identifikimi i pronave për banim social.

Kuvendet komunale, gjatë periudhës së hartimit të planeve trevjeçare, do të bëjnë identifikimin e pronave publike për ndërtim të ndërtesave për banim social. Në rastin konkret, pronat publike dhe private (në rastet e caktuara me kornizën ligjore) të cilat janë në afërsi të vendbanimeve me komunitetet rom dhe ashkali do të shfrytëzohen për ndërtimin e ndërtesave, dhënien e tokës me koncesion investitorëve privat dhe marrjen me qira nga pronarë privat të pronave për banim social të këtyre komuniteteve.

4.3.4. Aktiviteti: Hartimi i projekteve prioritare për banim social.

Hartimi dhe përgatitja e projekteve për banim social, si dhe aprovimi i tyre, bëhet nga kuvendet komunale. Komuna harton programet trevjeçare të banimit bazuar në burimet financiare, siguron tokën për ndërtim dhe infrastrukturën. Komuna e bën paraqitjen e kërkesave për financimin e investimeve të reja dhe subvencioneve në MMPH. Për të gjitha planet trevjeçare komunale duhet, paraprakisht, të merret pëlqimi nga MMPH.

Po ashtu, komunat do t'u mundësojnë investitorëve privatë, që, përmes Ligjit për partneritetin publiko privat, të japin tokën publike me qëllim të ndërtimit të lartë, ku komuna do të përfitonte numër të caktuar të banesave të cilat do të ndahen për banim social. Ky model do t'i kontribuojë në masë të madhe integritet më të shpejtë të pjesëtareve të komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë Kosovare. Bazuar në kriteret e parapara në UA Nr. 19/2010, komuna, në mungesë të fondit banesor, do të kontraktoj banesa me qira prej sektorit privat dhe do të ndajë bonusin e banimit familjeve që kanë nevojë për banim social.

Çështje të ndërlidhura

Çështja e banimit është ngushtë e lidhur me të gjitha komponentet tjera, pasi banimi adekuat është pjesë e mirëqenies personale, si dhe parakusht për sukses në arsim dhe shëndet të mirë. Po ashtu, punësimi është ngushtë i lidhur me zgjidhjen e problemit të banimit, pasi sjell mjete financiare të nevojshme për këtë qëllim.

Supozimet dhe rreziqet

Supozimet kryesore për të siguruar arritjen e objektivit të lartshënuar janë:

- Përfundon puna në bazën e të dhënave për evidentimin e nevojave të banimit;
- Komunitetet identifikojnë nevojat për banim të komunitetit dhe hartojnë programet tre vjeçare për banim social;

Ndërkaq, faktorët që vënë në pyetje suksesin e jetësimit të asaj që është planifikuar janë:

- Buxheti i vogël i ndarë nga niveli lokal dhe qendror për banim;
- Organizimi i dobët i përfaqësuesve të komuniteteve për të parashtruar kërkesat para institucioneve;
- Ndihma e pamjaftueshme nga niveli lokal dhe ai qendror që të realizohen aktivitetet e parapara me strategji.

7. Zbatimi i Strategjisë

Kjo Strategji mbulon një periudhë 5-vjeçare dhe shoqërohet me një plan veprimi i cili, po ashtu, i nënshtrohet aprovimit nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Strategjia dhe Planit i Veprimit janë dokumente komplementare dhe duhet të trajtohen si një tërësi me rastin e jetësimit të tyre.

7.1. Mekanizmat për zbatim

Roli koordinues për zbatimin e kësaj Strategjie i takon Zyrës për Qeverisje të Mirë (ZQM) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Mekanizmat që do të sigurojnë mbarëvajtjen e zbatimit të Strategjisë janë:

- Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe koordinimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit.
- Pikat e kontaktit për koordinimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit,
- Komitetet Komunale Vepruese (KKV) për secilën komunë.

ZQM bën mbikëqyrjen dhe koordinimin e zbatimit të Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë për integrimin e komuniteteve rom dhe ashkali. ZQM do të adresojë çështjet që ndërlidhen me zbatimin e Planit të Veprimit në Grupin Koordinues Ndërmintor për të Drejtat e Njeriut, që udhëhiqet nga Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe në përbërje të saj ka anëtarë ministrat nga ministritë përkatëse, Avokatin e Popullit dhe përfaqësues nga shoqëria civile. Po ashtu, ZQM mund të adresojë çështjet që ndërlidhen me zbatimin e Planit të Veprimit në Kolegjiumin e Sekretarëve të Përgjithshëm të Ministrive, i cili mblidhet në baza të rregullta javore.

ZQM do të koordinojë zbatimin e Strategjisë në fjale më pikat e kontaktit siç vijon: 1) Pika e kontaktit për arsim; 2) Pika e kontaktit për punësim dhe mirëqenie sociale; 3) Pika e kontaktit për shëndetësi dhe 4) Pika e kontaktit për banim. Detyrë e tyre është që të përcjellin zbatimin e aktiviteteve në fushën përkatëse, të nxjerrin rekomandime për përmirësim dhe t'ia përcjellin informatat relevante ZQM-së. Secili grup i punës do të udhëhiqet nga sekretari i përgjithshëm i ministrisë përkatëse (MASHT, MPMS, MSH dhe MMPH përkatësisht), apo në mungesë të tij/saj nga bashkëkryesuesi/ja i/e grupit, dhe do të ketë në përbërje të vet zyrtarë të ministrive dhe agjencive të pavarura, ekspertë dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile.


Për secilën komunë është paraparë formimi i Komitetit Komunal Veprues (KKV) për monitorimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit në nivel lokal. KKV do përbëhet nga drejtorët komunalë të drejtorive të linjave, përfaqësuesit e ZKKK-ve, zyrtarët komunalë për të drejtat e njeriut, zyrtarët për barazi gjinore, përfaqësues të OJQ-ve lokale dhe ndërkombëtare të cilat, në komunën përkatëse, veprojnë për çështjet e komuniteteve rom dhe ashkali. KKV do të udhëhiqet nga kryetari (ose nënkryetari) i komunës i/e cili/a për komunën e përkatëse do të emërojnë një koordinator të KKV nga radhët e stafit civil.

ZQM, do t'i përgatis termat e referencës për punën e grupeve të punës dhe të komiteteve komunale vepruese, me të cilat do të saktësohen përgjegjësitë dhe procedurat e punës të secilit prej këtyre mekanizmave. Po ashtu, ZQM do t'i emërojë anëtarët e grupeve të punës sipas propozimeve nga ministritë përkatëse, ndërsa, përmes MAPL do të komunikojë me kryetarët e komunave rreth formimit sa më të shpejtë të KKV-ve.

ZQM do të shërbejë si sekretariat i katër grupeve punuese, duke ndihmuar procesin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit. Detyrë e këtij Sekretariati do të jetë kryerja e të gjitha punëve

teknike dhe ofrimi i mbështetjes profesionale për grupet e punës, duke filluar nga përgatitja e takimeve deri tek hartimi i dokumenteve që do të aprovohen nga këto trupa, përfshirë raportet për zbatimin e Strategjisë dhe të Planit të Veprimit. Po ashtu, Sekretariati do ta zhvillojë komunikimin me KKV-të, duke mbledhur informata për progresin nga komunat. Anëtarë të Sekretariatit do të jenë edhe tre pjesëtarë të komuniteteve rom dhe ashkali, përkatësisht.

Struktura e plotë e mekanizmit për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit është prezantuar në diagramin vijues.



7.2. Monitorimi dhe vlerësimi

Për të lehtësuar monitorimin dhe vlerësimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit janë hartuar treguesit për të katër fushat e Strategjisë që janë dhënë në shtojcë të këtij dokumenti. Me rastin e hartimit të treguesve janë marrë parasysh informatat që janë në dispozicion, si dhe mundësia për të bërë krahasimin në mes të gjendjes së komuniteteve rom dhe ashkali me popullsinë e Kosovës në përgjithësi. Disa tregues mund të llogariten nga të dhënat dhe statistikave të agjencive qeveritare, ndërsa disa të tjerë bazohen në studime periodike. Kjo listë e treguesve duhet të shihet si listë fillestare dhe mund të pasurohet me tregues të rinj gjatë procesit të zbatimit të Strategjisë. Po ashtu, varësisht nga informatat në dispozicion, mund të jenë të nevojshme korrigjimet në vlerat fillestare.

Monitorimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit do të bëhet në dy nivele:

Monitorimi i aktiviteteve, i cili ka të bëjë me progresin e realizimit të aktiviteteve të Strategjisë në përputhje me përshkrimin e dhënë në dokumentin e Strategjisë dhe dinamikën e përcaktuar me Planin e Veprimit. Ky lloj monitorimi tregon nëse aktivitetet janë duke u zhvilluar ashtu si janë planifikuar dhe jep sugjerime për ndryshime eventuale në qasje.

Monitorimi i arritjeve (rezultateve) që bazohet në treguesit e definuar në shtojcën e këtij dokumenti. Në fakt, monitorimi i këtij tipi nënkupton mbledhjen e informatave për të krahasuar situatën aktuale me atë fillestare dhe të dëshiruar.

Për të siguruar një monitorim efektiv, duhet të hartohet një kornizë për monitorimin e Strategjisë, e cila përcakton metodologjinë e mbledhjes dhe qarkullimit të informacionit, linjat dhe dinamikën e raportimit, si dhe mënyrën e shfrytëzimit të raporteve. Ky është rol i ZQM, ndërsa është e arsyeshme që, për qëllime monitorimi të shfrytëzohen edhe resurset nga organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët zhvillimorë.

Parashihet që, në vitin e tretë të zbatimit të Strategjisë (2019) të organizohet një vlerësim gjithëpërfshirës i Strategjisë dhe Planit të Veprimit me qëllim që të ofrohet informacion relevant për progresin e zbatimit të këtyre dokumenteve dhe bazën për ri-planifikim eventual të aktiviteteve në dy vitet e fundit të zbatimit – 2020 dhe 2021. Një vlerësim tjetër, final, do të bëhet në vitin 2021, kur përfundon afati i Strategjisë dhe do të shërbejë për hartimin e politikave të tjera në këtë fushë. KDN do t'i aprovojë termat e referencës për këto vlerësime, por fokuset kryesore të tyre janë:

Efektiviteti: Në ç'masë janë arritur objektivat e Strategjisë dhe cilët janë faktorët kryesorë që ndikojnë në arritje ose mungesë të arritjeve?

Relevanca: Në ç'masë ka arritur Strategjia t'i adresojë nevojat reale të komuniteteve rom dhe ashkali dhe cilat kanë qenë kufizimet e saj?

Qëndrueshmëria: A do të mbeten të qëndrueshme efektet e Strategjisë edhe pas përfundimit të zbatimit të saj dhe në ç'masë është arritur që praktikatat e reja të bëhen pjesë e punës së përditshme të institucioneve?

Proceset: Sa jemi të kënaqur me realizimin e aktiviteteve dhe proceseve që janë pjesë e tyre, dhe si mund të përmirësohemi në këtë drejtim?

8. Buxheti

Buxheti i nevojshëm për zbatimin e kësaj Strategjie është llogaritur si pjesë e zhvillimit të planit të veprimit të Strategjisë, ndërsa llogaritja është bërë për tërë periudhën pesëvjeçare të zbatimit të Strategjisë. Me këtë rast janë marrë parasysh edhe shpenzimet e planifikuara në kuadër të dokumenteve të tjera strategjike, si dhe shpenzimet operative, duke shmangur dyfishimin e tyre. Vlerësimi i buxhetit total për zbatimin e Strategjisë ka shumën prej 8,684,758 EUR. Tabela 11 paraqet një përmbledhje të shpenzimeve buxhetore sipas viteve dhe fushave të Strategjisë.

Tabela 11. Përmbledhja e buxhetit të Strategjisë sipas viteve

Fusha prioritare	2017	2018	2019	Gjithsej
Arsimi	€ 912,875	€ 1,221,875	€ 1,250,900	€ 3,385,650
Punësimi dhe mirëqenia sociale	€ 400,133	€ 798,905	€ 943,650	€ 2,142,688
Shëndetësia	€ 95,000	€ 95,000	€ 75,000	€ 265,000
Banimi	€ 380,730	€ 1,263,390	€ 1,247,300	€ 2,891,420
	€ 1,788,738	€ 3,378,420	€ 3,516,100	€ 8,684,758

Vërehet se shpenzimet për arsim janë më të mëdha, kryesisht për shkak të bursave për nxënës dhe studentë, si dhe për shkak të mbështetjes së qendrave mësimore që i shërbejnë nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Ndërkaq, pjesa më e madhe e shpenzimeve në fushën e punësimit dhe të mirëqenies sociale ka të bëjë me përfshirjen e shtuar të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali në skema sociale. Në fushën e shëndetësisë shpenzimet e planifikuara janë diç më të vogla pasi shërbimet shëndetësore ofrohen përmes kapaciteteve ekzistuese të sistemit shëndetësor. Ndërkaq, në fushën e banimit, pjesa më e madhe e shpenzimeve ka të bëjë me ndërtimin dhe renovimin e shtëpive, si dhe banesa sociale për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali.

Tabela 12 jep një përmbledhje të buxhetit sipas kategorive ekonomike, prej së cilës vërehet një dominim i theksuar i subvencioneve dhe shpenzimeve kapitale në buxhet, ndërkohë që kemi një ngarkesë tejet të moderuar në linjën e pagave dhe mëditjeve.

Tabela 12. Përmbledhja e buxhetit të Strategjisë sipas kategorive ekonomike

Fusha prioritare	Pagat dhe mëditjet	Mallra dhe shërbime	Subvencione dhe transfere	Shpenzime kapitale	Gjithsej
Arsimi	€ 38,400	€ 134,750	€ 3,200,500	€ 12,000	€ 3,385,650
Punësimi dhe mirëqenia sociale	€ 18,900	€ 80,288	€ 2,043,500		€ 2,142,688
Shëndetësia		€ 140,000	€ 125,000		€ 265,000
Banimi		€ 79,920	€ 231,000	€ 2,580,500	€ 2,891,420
	€ 57,300	€ 434,958	€ 5,600,000	€ 2,592,500	€ 8,684,758

Ndërkaq, kur bëhet fjalë për burimet e financimit, nga tabela 13 vërehet se 64.4% e buxhetit është planifikuar të mbulohet nga burimet e donatorëve, ndërsa vetëm 2.3% nga buxhetet komunale.

Tabela 13. Përmbledhja e buxhetit të Strategjisë sipas burimeve të financimit

Burimi i financimit	2017	2018	2019	Gjithsej
Buxheti i Kosovës	€ 513,880	€ 1,113,490	€ 1,262,300	€ 2,889,670
Buxheti Komunal	€ 20,000	€ 91,500	€ 91,500	€ 203,000
Donatorët	€ 1,254,858	€ 2,174,180	€ 2,163,050	€ 5,592,088
	€ 1,788,738	€ 3,379,170	€ 3,516,850	€ 8,684,758

Shtojcë: Korniza për vlerësimin e performancës

Objektivi 1: Rritja e përfshirjes dhe ofrimi i mundësive për zhvillim, aftësim dhe arsimim cilësor për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali		
Treguesi	Gjendja fillestare	Sqarimi
Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në edukimin parafillor (Caku: 70%)	53.9% ¹¹⁴	<i>Përqindja e fëmijëve në klasën e parë të shkollës fillore që kanë vijuar arsimin parashkollor në vitin paraprak</i>
Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin fillor (Caku: 95%)	85.3% ¹¹⁵	<i>Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës fillore që aktualisht vijnë në arsimin fillor ose të mesëm.</i>
Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e mesëm të ulët (Caku: 85%)	65% ¹¹⁶	<i>Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës së mesme të ulët që aktualisht vijnë në shkollimin e mesëm të ulët ose më shumë</i>
Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e mesëm të lartë (Caku: 50%)	30.3% ¹¹⁷	<i>Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës së mesme të lartë që aktualisht vijnë në shkollën e mesme të lartë ose më shumë</i>
Shkalla e transicionit në arsimin e mesëm të lartë për fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian (Caku: 80%)	69.9% ¹¹⁸	<i>Numri i nxënësve të regjistruar në klasën e 10-të në vitin shkollor aktual, si përqindje e numrit të nxënësve të regjistruar në klasën e 9-të në vitin paraprak.</i>
Indeksi i paritetit gjinor për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian Niveli: Fillor (Caku: 1)	1.01 ¹¹⁹	<i>Numri i vajzave i pjesëtuar me numrin e djemve.</i> <i>Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, në Kosovë jetojnë 35,784 rom, ashkali dhe egjiptian ndërsa indeksi i paritetit gjinor është 0.99.</i>
Indeksi i paritetit gjinor për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian Niveli: I mesëm i ulët (Caku: 1)	0.94 ¹²⁰	
Indeksi i paritetit gjinor për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian Niveli: I mesëm i lartë (Caku: 0.90)	0.80 ¹²¹	

¹¹⁴ Anketa e grupeve të treguesve të shumëfishtë 2013-2014 – Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian (MICS), Raporti final, ASK, Prishtinë 2014, f. VII. <https://ask.rks-gov.net/images/files/Komunitetet%20Rom,%20Ashkali%20dhe%20Egjiptiane%20ne%20Kosove.pdf>

¹¹⁵ Po aty.

¹¹⁶ Po aty.

¹¹⁷ Po aty.

¹¹⁸ Po aty.

¹¹⁹ Po aty.

¹²⁰ Po aty.

¹²¹ Po aty.

Përfshirja e fëmijëve të ri-atdhesuar në sistemin arsimor (Caku: 100%)	Mungojnë të dhënat	<i>Është e nevojshme përcjellja individuale. MPB mban bazën e të dhënave për të kthyerit.</i>
Ulja e shkallës së braktisjes së shkollimit të obligueshëm (Caku: < 0.1%)	0.20% ¹²²	<i>Numri i fëmijëve që kanë braktisur shkollimin e obligueshëm si përqindje e numrit të përgjithshëm të fëmijëve që vijojnë këtë nivel shkollimi</i>
Ulja e shkallës së braktisjes së shkollimit të mesëm të lartë (Caku: < 1%)	1.70% ¹²³	<i>Numri i fëmijëve që kanë braktisur shkollimin e mesëm të lartë si përqindje e numrit të përgjithshëm të fëmijëve që vijojnë këtë nivel shkollimi</i>

¹²² Raport Statistikor me tregues arsimorë 2014/15, MASHT f.27. <http://MASHt.rks-gov.net/uploads/2015/12/raport-statistikor-me-tregues-arsimor-2014-15.pdf>

¹²³ Po aty, f.28.

Objektivi 2: Përmirësimi i situatës ekonomike dhe sociale të komuniteteve rom dhe ashkali		
Treguesi	Gjendja fillestare	Sqarimi
Norma e punësimit (Caku: 17%) ¹²⁴	Mungojnë të dhënat	<i>Përqindja e individëve në moshë pune që janë të punësuar</i>
Norma e punësimit të grave (Caku: 12%) ¹²⁵	9% ¹²⁶	<i>Përqindja e grave në moshë pune që janë të punësuar</i>
Përfshirja në MATP (Caku: 10%)	6% ¹²⁷	<i>Përqindja e përfituesve të MATP që i përkasin këtyre dy komuniteteve</i>
Përfshirja e grave në MATP (Caku: 25%)	12% ¹²⁸	<i>Përqindja e grave në mesin e përfituesve të MATP që i përkasin këtyre dy komuniteteve</i>
Përfshirja në punësim në sektorin publik (Caku: 1%) ¹²⁹	0.5% ¹³⁰	<i>Përqindja e të punësuarve në sektorin publik që i përkasin këtyre dy komuniteteve</i>
Përfshirja e familjeve të varfra në skemat e ndihmës sociale (Caku: 80%)	54% ¹³¹	<i>Përqindja e familjeve të varfra që marrin ndihmën sociale (Kategorinë I dhe II të ndihmës sociale)</i>
Përfshirja e familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara permanente në skemën e mbështetjes financiare (Caku: 100%)	Mungojnë të dhënat	<i>Identifikimi dhe diagnostikimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara permanente.</i>
Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara permanente në skemën pensionale për persona me aftësi të kufizuara permanente (Caku: 100%)	Mungojnë të dhënat	<i>Identifikimi dhe diagnostikimi i personave të moshës 18-65 vjeçare me aftësi të kufizuara permanente.</i>
Numri i pjesëtarëve të komuniteteve që pranojnë shërbime nga QPS-të (Caku: 228/vit)	105 ¹³²	<i>Numri i personave të cilëve u janë ofruar shërbime sociale nga QPS-të.</i>

¹²⁴ Meqë të dhënat në nivel të vendit për gjendjen fillestare mungojnë, por të dhënat ekzistuese tregojnë dallime të mëdha në punësim në mes këtyre komuniteteve dhe pjesës tjetër të popullatës, caku është caktuar në atë mënyrë që shkalla e punësimit të jetë në nivel rreth 30% më të ulët krahasuar me atë në shkallë të vendit në vitin 2015. Agjencia e Statistikave të Kosovës, Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore 2015 në Kosovë, 2016.

¹²⁵ Në këtë rast caku është caktuar në nivel të njëjtë me atë të grave në shkallë të vendit në vitin 2015.

¹²⁶ Fondacioni CREATE dhe Qendra për Dokumentim Romë dhe Ashkali (RADK). Gratë Rome, Ashklike dhe Egjiptase në Qeverisje dhe Ekonomi.

